AKU
AUTORITETI KOMBETAR I USHQIMIT
RAPORTI I VEPRIMTARISË VJETORE
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
2022
#BASHKË
PËR SIGURINË
USHQIMORE

1 TABELA E PËRMBAJTJES

2 MISIONI, ARRITJET, SFIDAT 4
2.1 OBJEKTIVAT 4
2.2 ARRITJET 4
2.3 SFIDAT PËR VITIN 2023 7
3 DREJTORIA E MENAXHIMIT TË RISKUT DHE KOORDINIMIT TË KONTROLLIT ZYRTAR 8
3.1 SEKTORI I KOORDINIMTI TË KONTROLLIT TË USHQIMIT, USHQIMIT PËR KAFSHË DHE OBU 8
3.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 8
3.1.2 PROBLEMATIKA: 15
3.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM: 16
3.2 SEKTORI I KOORDINIMIT TË KONTROLLIT TË MBROJTJES SË BIMËVE DHE INPUTEVE BUJQËSORE 16
3.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 16
3.2.2 PROBLEMATIKA: 20
3.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 21
3.3 SEKTORI I LICENCIMIT DHE DOKUMENTACIONIT TË OBU 22
3.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TE SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 22
3.3.2 PROBLEMATIKA 27
3.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 27
3.4 SEKTORI I KOORDINIMTI TË KONTROLLIT NË PIK 27
3.4.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 28
3.4.2 PROBLEMATIKA 32
3.4.3 REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM 32
4 DREJTORIA E VLERËSIMIT TË RISKUT 33
4.1 SEKTORI I AKTIVITETIT SHKENCOR DHE KOMUNIKIMIT ME RASFF 33
4.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 33
4.1.2 PROBLEMATIKA 36
4.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM: 36
4.2 SEKTORI I KORDINIMIT TË SHËRBIMIT LABORATORIK 37
4.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 37
4.2.2 PROBLEMATIKA 43
4.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM: 43
4.3 SEKTORI I VLERËSIMIT TË RISKUT DHE STATISTIKAVE 44
4.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 44
4.3.2 PROBLEMATIKA 52
4.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM: 52
4.4 SEKTORI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE RAPORTIMIT 53
4.4.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 53
4.1.1 PROBLEMATIKA 57
4.1.2 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM: 57
5 DREJTORIA E KOMUNIKIMIT TË RISKUT DHE MONITORIMIT 57
5.1 SEKTORI I KOMUNIKIMIT TË RISKUT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË OBU- VE 57
5.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 58
5.1.2 PROBLEMATIKA 60
5.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 60
5.2 SEKTORI I INFORMIMIT TË PUBLIKUT DHE KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL 60
5.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 61
5.2.2 PROBLEMATIKA 64
5.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 64
5.3 SEKTORI I MONITORIMIT DHE HETIMIT USHQIMOR 64
5.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 65
5.3.2 PROBLEMATIKA 67
5.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 68
6 DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME 68
6.1 SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV-PROTOKOLLIT 68
6.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 69
6.1.2 PROBLEMATIKA 72
6.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 72

6.2 SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE PROKURIMIT 73
6.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 73
6.2.2 PROBLEMATIKA 75
6.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 75
6.3 SEKTORI I ANKESAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE 75
6.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 75
6.3.2 PROBLEMATIKA 79
6.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 79
6.4 SEKTORI I ASISTENCËS TEKNIKE DHE TRAJNIMEVE 79
6.4.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 79
6.4.2 PROBLEMATIKA 84
6.4.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 84
7 SEKTORI I BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR 84
7.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 85
REALIZIMI I ZËRAVE TË BUXHETIT NË VITIN 2022 ËSHTË *99.47%*, NJË REZULTAT SHUMË I MIRË 87
REALIZIM I BUXHETIT VITIT 2022 SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE DHE NJËSIVE SHPENZUESE 87
REALIZIM I BUXHETIT TË VITIT 2022 DUKE U KRAHASUAR ME REALIZIMIN E BUXHETIT VITI 2021 SIPAS LLOGARIVE 88
TË ARDHURAT 88
TË ARDHURAT E REALIZUARA SIPAS NJESIVE SHPENZUESE PER VITIN 2021 DHE VITI 2022 89
TË ARDHURAT E VITIT 2022 DUKE BËRË KRAHASIMIN SIÇ SHIKOHET DHE GRAFIKISHT TË ARDHURAT JANË NË TREND RRITËS KRAHASUAR ME VITIT 2021 89
TË ARDHURAT NGA MASAT ADMINISTRATIVE E REALIZUARA SIPAS NJËSIVE SHPENZUESE TE AKU, TË KRAHASUARA ME VITIN 2021 PARAQITEN SI MË POSHTË: 89
7.1.2 PROBLEMATIKAT 90
7.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM 91
8 SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM 91
8.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJRT KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË: 91
8.1.2 PROBLEMATIKAT 93
8.1.3 REKOMANDIME PËR PERMIRËSIM 95
9 NËNKOMITETET DHE PROJEKTET 95
9.1 NËNKOMITETI 95
9.2 PROJEKTET 97

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Në dhëna mbi mbi realizimin e planit të inspektimeve në rang vendi 10
Tabela 2. Të dhënat mbi inspektimet e kryera në rang vendi për vitin 2022 11
Tabela 3. Të dhëna mbi realizimin e planit të marrjes së mostrave në rang vendi 12
Tabela 4. Inspektimet e kryera në stabilimentet e përpunimit të peshkut dhe marrja e mostrave 12
Tabela 5. Eksportet e kryera për produktet me origjinë shtazore 13
Tabela 6. Volumet e eksporteve për produktet me origjinë shtazore dhe jo shtazore në "Open Balkan", vitet 2021-2022 13
Tabela 7. Të dhënat për planin HACCP për periudhën janar-dhjetor 2022 14
Tabela 8. Të dhënat për notifikimin e etiketave për vitin 2022 15
Tabela 9. Tabela e trajtimeve të rasteve të ardhura nga sistemi RASFF 15
Tabela 10. Nr. total i inspektimeve të planifikuara dhe realizuara sipas planit vjetor/mujor të miratuar për vitin 2022, për Sektorët e KKMBIB në rang kombëtar 18
Tabela 11. Tabela e planit të marrjes dhe analizimit të mostrave për periudhën Janar-Dhjetor 2022 19
Tabela 12. Aplikime për licencim për periudhën Janar-Dhjetor 2022 25
Tabela 13. Aplikime për licencim sipas kategorive për periudhën Janar-Dhjetor 2022 25
Tabela 14. Aplikime për pajisje me aktin e miratimit paraprak nga AKU-ja 26
Tabela 15. Tabela e inspektimeve kufitare 29
Tabela 16.Marrja e mostrave në PIK 31
Tabela 17. Struktura aktuale e laboratorëve 37
Tabela 18.Plani dhe realizimi i analizimit të mostrave në laboratorët e AKU-së për efekt kontrolli zyrtar 40
Tabela 19. Aktiviteti laboratorik Janar- Dhjetor 2022 nga sektorët e Shërbimeve Laboratorike AKU 41

Tabela 20.Përmbledhëse e realizimit të mostrave .....**Error! Bookmark not defined.**
Tabela 21. Tabela e axhustimeve 42
Tabela 22. Inspektimet e kryera në terren për vitet 2021-2022 46
Tabela 23. Inspektimet e kryera në PIK për vitet 2021-2022. 47
Tabela 24. Sasitë e importuara në PIK për produktet me origjinë-shtazore.....48
Tabela 25. Sasitë e importuara në PIK për produktet me origjinë jo-shtazore 49
Tabela 26. Sasitë e importuara në PIK për produktet bimore dhe inputet bujqësore.....50
Tabela 27. Kërkesat për licencim për vitet 2021-2022.....51
Tabela 28. Eksportet e produkteve me origjinë shtazore për vitet 2021-2022.....51
Tabela 29. Mbi numrin e inspektimeve të realizuara nga DRAKU për periudhën janar-dhjetor 2022 55
Tabela 30. Realizimi i mostrave si AKU sipas aktiviteteve dhe Laboratoreve 56
Tabela 31. Numri i rasteve sipas tipologjisë Janar-Dhjetor 2022.....58
Tabela 32. Tipologjia "Biznesi" 58
Tabela 33. Numri i rasteve sipas tipologjisë Platforma e Bashkëqeverisjes "Qytetarë".....59
Tabela 34. Numri i ankesave/denoncimeve/kërkesave sipas kanaleve të komunikimit për periudhën janar-dhjetor 2022:.....63
Tabela 36. Të dhënat e inspektimeve të kryera nga Sektori i Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor 66
Tabela 37. Procedurat e Prokurimit Publik të Realizuara gjatë vitit 2022.....74
Tabela 38. Ankimet për vitet 2021-2022 lidhur me masat administrative gjobë.....76
Tabela 39. Evidencë e procese gjyqësore 2021-2022.....77
Tabela 40. Evidencë mbi çeljen dhe ekzekutimin e urdhrave të ekzekutimit 2021-2022.....78
Tabela 41. Numri i punonjësve të trajnuar për vitin 2022 80
Tabela 42. Fondet e Akordura dhe të Realizuara gjatë vitit 2022.....86
Tabela 43. Realizimi i buxhetit sipas Njësive shpenzuese 2022.....87
Tabela 44. Realizimi i buxhetit i vitit 2021-2022.....88
Tabela 45. Realizimi i të ardhurave sipas njësive shpenzuese.....89
Tabela 46. Të ardhurat nga masat administrative e realizuara sipas njësive shpenzuese te AKU 89
Tabela 47. Realizimi i programit të auditimeve për vitin 2022 92
Tabela 48. Planifikimi dhe realizimi i fushave të audituara 93
Tabela 49. Përllogaritje të gabuara amortizimi, shkelje e disiplinës financiare e kontabilizim i gabuar 94
Tabela 50. Rekomandimet e dhëna për ç'do subjekt të audituar 95

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku. 1 Të dhëna mbi mbi realizimin e planit të inspektimeve në rang vendi 11
Grafiku. 2Të dhëna mbi realizimin e planit të marrjes së mostrave në rang vendi.....12
Grafiku. 3Të dhënat e eksporteve për vitet 2021-2022.....13
Grafiku. 4Njoftimet e ardhura nga RASFF për periudhën janar-dhjetor 2022.....34
Grafiku. 5Njoftimet nga Shqipëria drejt RASFF për periudhën janar-dhjetor 2022 35
Grafiku. 6Të dhëna mbi inspektimet e kryera në terren për vitet 2021-2022.....46
Grafiku. 7Inspektimet e kryera në PIK për vitet 2021-2022 47
Grafiku. 8Kërkesat për licensim për vitet 2021-2022.....51
Grafiku. 9Eksportet e produkteve me origjinë shtazore për vitet 2021-2022.....51
Grafiku. 10Numri i ankesave/denoncimeve sipas kanaleve të komunimimit janar-dhjetor 2022 63
Grafiku. 11Masa administrative nga Sektori i Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor.....66
Grafiku. 12Numri i emërimeve për vitet 2021 dhe 2022, për DPAKU dhe 12 Drejtoritë Rajonale.....70
Grafiku. 13Të dhëna krahasimore për vitet 2021-2022 lidhur me largimet e punonjësve të AKU, (shkaku largimit) 71
Grafiku. 14Trajnime për vitin 2022.....84
Grafiku. 15Gjetjet në vlerë me dëm ekonomik, ndarë sipas fushave 94

2 MISIONI, ARRITJET, SFIDAT

AKU është krijuar bazuar në ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar. Organizimi dhe funksionimi i institucionit është përcaktuar me V.K.M Nr. 708 datë 9.9.2020, AKU filloi funksionimin më 20.05.2010, pra një institucion me një historik aktiviteti relativisht të ri dhe në përpjekje për të realizuar misionin e tij në zbatim të kërkesave ligjore dhe legjislacionit në fuqi.

Siguria Ushqimore është parë si një e drejtë themelore njerëzore, detyrim për shtetin. Garantimi i sigurisë ushqimore është një komponent i rëndësishëm i Strategjisë për Sigurinë Kombëtare, përmbushja e të cilit realizohet nëpërmjet qasjes së integruar, që përfshin kontrollin e kultivimit, përpunimit, prodhimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore e blegtorale.

Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, duhet siguruar funksionimi efektiv i çdo hallke të zinxhirit ushqimor. Ky princip është i vlefshëm, pavarësisht nga fakti nëse produktet ushqimore prodhohen në Shqipëri apo importohen nga vende të tjera. Një politikë efikase e sigurisë ushqimore duhet të njohë natyrën komplekse të prodhimit të produkteve ushqimore si dhe vlerësimin e monitorimit të risqeve mbi shëndetin e njerëzve.

2.1 OBJEKTIVAT

- Garantimin e sigurisë ushqimore në zinxhirin ushqimor, duke bashkërenduar dhe koordinuar kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe joshtazore, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi, në shkallë vendi;
- Propozon dhe zbaton planin strategjik real për vlerësimin e riskut;
- Informon për praktikat më të mira të përpunimit, në treg dhe parandalon falsifikimet;
- Forcimi i kapaciteteve administrative, rritja e efektivitetit të laboratorëve;
- Promovon produkte të sigurta dhe parandalon cënimin e cilësisë së ushqimeve.

2.2 ARRITJET

- ***Përmirësim infrastrukturor dhe funksional në facilitete PIK & laboratorë;***
  - ❖ Në bashkëpunim me projektin SAFIAL "Forcimi institucional i Ministrisë së Bujqësisë për menaxhimin e sigurisë ushqimore" financuar nga Koperacioni Italian dhe implementohet nga CIHEAM Bari (Instituti Mediteran Agronomik i Barit) gjatë vitit 2022 kanë filluar punimet për ndërtimin e kapanonit të ri në PIK Durrës dhe lëvrimi i pajisjeve laboratorike në Laboratorin e Durrësit;
  - ❖ AKU ka qenë pjesë e negociatave që MBZHR ka zhvilluar me Bankën Botërore për një Projekt investimi në laboratorët, ku AKU në bashkëpunim me ISUV dhe me ekspertë të

Bankës Botërore ka përgatitur nevojat dhe specifikimet teknike për investime në infrastrukturën e laboratorëve të profilizuar.

- ❖ Me fondet e Buxhetit të Shtetit në kuadër të pëmirësimit të kushteve laboratorike është mundësuar blerja e pajisjeve laboratorike ftohëse (frigoriferë për ruajtjen e mostrave dhe terreneve në qarqet; Tiranë, Durrës, Fier dhe Korçë).
- ❖ Me fondet e Buxhetit të Shtetit janë kryer instalimet elektrike në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike Durrës për të siguruar funksionimin e pajisjeve që po instalohen nga Projekti SAFIAL.

- ***Ngritja e Bordit të Autoritetit Kombëtar;***

  Gjatë vitit 2022 janë realizuar 4 takime me Bordin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ku janë diskutuar, kryer vërejtjet e nevojshme dhe vlerësuar në parim projekt dokumentet e rregullores së brendshme, manuali i rekrutimit të punonjësve, plani strategjik i veprimit për rrjetin e laboratorëve të sigurisë ushqimore e veterinare, raporteve tekniko financiare 3 mujore, projekt buxheti afatmesëm;

- ***Ngritja e paneleve shkencore me Urdhër të Ministrit datë 1.06.2022;***

- ***Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional;***

- ➢ ***Bashkëpunim me Inspektoratin Qendror*** si një hallkë shumë e rëndësishme e sistemit të inspektimeve në terren. IQ i është përgjigjur në kohë kërkesës së Autoritetin Kombëtar të Ushqimit në shtimin e user-ve (përdoruesve) në sistemin e *e-inspektimit* për Sektorin e Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor dhe Sektorin e Vlerësimit të Riskut dhe Statistikave.

- ➢ ***Bashkëpunimi me ISUV jo vetëm si laborator reference zyrtare por gjatë vitit 2022 ISU,*** ka kryer paketa trajnimi të stafit për laboratorin e shëndetit të mirëqënies së kafshëve dhe laboratorin e sigurisë ushqimore. Gjithashtu, ka ofruar asistencë teknike për evidentimin e nevojave lidhur me pajisjet që nevojiten pë analizimin e mykotoksinave, metaleve të rënda, etj., në kuadër të investimeve të parashikuara nga Banka Botërore.

- ➢ ***Bashkëpunimi me Inspektoratin e Shëndetit Publik,*** ku përfaqësues të AKU-së kanë qenë pjesë aktive në grupet e përbashkëta të punës për hartimun e strategjive kombëtare që impaktojnë shëndetin publik si dhe komunikimin e rasteve ALERT të ardhura nga sistemi RASFF;

- ➢ ***Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, (MAS)*** ku u finalizua hartimi dhe miratimi i marrëveshjes 2 vjeçare me mundësi ripërsëritje për "Zhvillimin e Orëve Mësimore Sensibilizuese me Nxënësit e Arsimit Parauniversitar për elementët kryesorë të sigurisë ushqimore" me qëllim informimin dhe sensibilizimin e nxënësve, për të edukuar brezat e ardhshëm si konsumatorë të përgjegjshëm, duke dhënë kështu edhe ata kontributin e tyre në forcimin e mëtejshëm të sigurisë ushqimore.

- ➢ ***Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve*** ku me kërkesë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është bërë verifikimi i statusit të subjekteve të deklaruara të mbyllura në momentin e inspektimit.

- ***Bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Policisë Kufitare,*** funksionon grupi i punës ndërinstitucional për hartimin e rregullores për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta midis AKU-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në Pikat e Inspektimit Kufitar.

- ***Fushata digjitale e sigurisë ushqimore;***

  - Rritje me frekuencë të lartë të numrit të të informuarve, arritur nëpërmjet faqeve informuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
  - 2-fishim i numrit të denoncimeve/kërkesave për informacion/ndërgjegjësim;
  - Asnjë helmim i regjistruar për shkak të ushqimit në gjithë Shqipërinë;
  - 4.5 milionë reaches nga Fushata Digjitale e Sigurisë Ushqimore nga 600 mijë që ishte më parë;
  - Rreth 1000 ambasadorë të rinj të sigurisë ushqimore në shkollat 9- vjeçare dhe gjimnaze në Tiranë, si dhe 180 miq të vegjël të sigurisë ushqimore dhe 30 mësues të trajnuar në të gjithë vendin.

- ***Unifikimi i praktikave të kontrollit zyrtar*;**

  Janë miratuar 35 certifikata shëndetësore veterinare për importin/eksportin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, 6 certifikata shëndetësore për eksportin e produkteve me origjinë joshtazore të miratuara.

- ***Implementim i Open Balkan initiative;***

  - Rritje me 30% e angazhimit të burimeve njerëzore në çdo qark të Shqipërisë;
  - Rritje me 145% e numrit të ngarkesave të eksportuara nga marrëveshja Open Balkan (nga 117 ngarkesa në vitin 2021 në 287 ngarkesa në vitin 2022). Ndërsa në volum eksportesh rritja është me 40.8%.

- ***Transformimi rregullativ institucional;***

  - Rregullore e re për institucionin;
  - Manual i procedurave të licencimit;
  - Manual i certifikimit të produkteve me origjinë shtazore për eksport;
  - Manual dhe SOPs i njoftimeve RASSF;
  - SOPs për komunikimin e riskut.

- ***Rekrutimi i stafit dhe trajnimet;***

Plotësimi i vendeve vakante në stafin e AKU-së dhe rritja e numrit të stafit të trajnuar. Gjatë vitit 2022 janë rekrutuar 65 punonjës dhe është 5-fishuar numri i stafit të trajnuar nga 82 në vitin 2021, në vitin 2022, punojës të trajnuar janë 417.

- ***Digjitalizimi dhe standardizimi i hyrje-daljeve nga Pikat e Inspektimit Kufitar;***

Po implementohet projekti SEED+ / CEFTA TRACES NT import eksport për bimë dhe produkte bimore, projekt i cili filloi të zbatohet në korrik 2022, me qëllim lehtësimin e procedurave në PIK

duke përdorur sistemin online për lëshimin e aktit administrativ të hyrjes për vendet CEFTA. Ky sistem ka lehtësuar procedurat e subjekteve importuese në PIK në kontrollin dokumentar, mbasi ato shfaqen në sistem në momentin që lëshohen nga autoritetet e vendeve eksportuese.

- ***Aplikimi i një metodologjie bashkëkohore të vlerësimit të riskut;***

Me asistencë të Projektit "Mbështjetje për Sigurinë Ushqimore, Standardet Veterinare dhe Fitosanitare në Shqipëri", është hartuar dhe miratuar Metodologjia e Profilizimit të Riskut të Operatorëve të Bisnesit Ushqimor" e cila u përdor për hartimin e Planit Kombëtar të bazuar në risk për vitin 2023. Kjo metodologji konsiston në kategorizimin e riskut të OBU-ve me risk të ulët, të mesëm ose të lartë në varësi të riskut që lidhet me aktivitetin e tyre dhe faktorëve të tjerë ndikues duke përdorur një sistem pikëzimi për 21 292 operatorë biznesi.

2.3 SFIDAT PËR VITIN 2023

- Informatizimi i të gjitha proceseve të punës në AKU, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të informatizuar që siguron automatizimin e terrenit, pikut, laboratorëve dhe prodhimin e raporteve dhe statistikave;
- Kryerjen e inspektimeve online, inspektimit në pikat e inspektimit kufitar/dogana e brendshme, licencimit, trajtimit të masave administrative, menaxhimin e laboratorëve të analizave i cili do të ndërthuret me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe atë të inventarizimit, etiketat, mostrat, etj;
- Përmirësimi i statistikave dhe raportimeve nëpërmjet standardizimit të raportimeve nga DRAKU, Drejtoritë në AKU qendër dhe rivitalizimit të sistemit AKU net;
- Ngritja e një rrjeti kosto-eficent laboratorik të aftë për të garantuar informacion të besueshëm dhe në kohë mbi sigurinë e ushqimeve të tregtuara dhe shëndetin e kafshëve. Rritja e kapaciteteve të rrjetit laboratorik për të kryer monitorime dhe analiza të produkteve ushqimore dhe ushqim për kafshë me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnozës mikrobiologjike në ushqim dhe ushqim për kafshë, standardeve të cilësisë, sëmundjeve të kafshëve, në përputhje me standarde të përmirësuara;
- Përmirësim i infrastrukturës në pikat e inspektimit kufitar për poste pune si dhe ambiente për kryerjen e kontrollit fizik për produktet e importit;
- Krijimi i një road map për fillimin e akreditimit të Laboratorit Fitosanitar Durrës;
- Përmirësimin dhe plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me akte nënligjore në përmbushje të nevojave për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me direktivat Acquis të BE;
- Trajnimi i plotë i stafit të laboratorëve, shtimi i metodave referuar pajisjeve të reja laboratorike, rritja e eficencës dhe numrit të analizave pas lëvrimit të pajisjeve laboratorike nga Projekti Safial;
- Miratimi dhe implementimi i metodologjisë me bazë risku për eksportet e MBIB në PIK.
- Bashkëpunim më i mirë ndërinstitucional;

3 DREJTORIA E MENAXHIMIT TË RISKUT DHE KOORDINIMIT TË KONTROLLIT ZYRTAR



3.1 SEKTORI I KOORDINIMTI TË KONTROLLIT TË USHQIMIT, USHQIMIT PËR KAFSHË DHE OBU

Sektori i Koirdinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor luan një rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë ushqimore në tërë zinxhirin ushqimor, duke bashkërenduar dhe koordinuar kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi, në shkallë vendi.

3.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Koordinimin e kontrolleve zyrtare të kryera nga trupat inspektuese të DRAKU, në zbatim të "Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe plani i marrjes së mostrave në PIK, si dhe bazuar në planet e veprimit / monitorimit të miratuara nga ministri MBZHR dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, denoncimeve, ankesave të qytetarëve, apo atyre mediatike, alerteve nga sistemi RASSF, si dhe urdhrave të veçantë dhe specifikë. Inspektime nga trupat e DRAKU në lidhje me kërkesë aplikimet e aplikantëve për fondet e IPARD II;
- Përpunimin e të dhënave mbi kontrollet zyrtare, informacionet periodike mbi aktivitetin e kryer nga Sektorët e inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe OB, të Drejtorive Rajonale të AKU-së, si dhe ka përgatitur raportet në kohë;
- Monitorimin e DRAKU-ve për zbatimin e planit të mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimore, të planit të mbetjeve në produktet me origjinë shtazore, në subjektet në afërsi (apo brenda) institucioneve shkollore dhe parashkollore, që ushtrojnë aktivitet: fast-food,

byrektore, piceri, markete dhe pika tregtimi, subjektet ku përfshihen grupe të veçanta (fëmijë) si: kopshte, shkolla dhe çerdhe, në të gjithë territorin e vendit.

Detyrat:

- Është kryer monitorimi i veprimtarisë inspektuese të DRAKU-ve, nga grupi i punës (ku pjesë përbërëse ishin inspektorë të Sektorit të Koordinimit dhe Kontrollit të UUK dhe OB), të praktikave të inspektimit ku nga trupat inspektuese përkatëse ishte marrë masa urgjente me vendim të ndërmjetëm, për bllokimin e produkteve ushqimore me destinacion asgjësimin e tyre apo masa e ndërprerjes së plotë apo të pjesshme të aktivitetit për mosplotësim të kushteve dhe kritereve ligjore;
- Sektori, në bazë të kërkesave të OBU për certifikata eksporti për produkte me origjinë jo shtazore, ka përgatitur formatet e certifikatave sipas modelit të miratuar dhe i ka dërguar këto kërkesa në MBZHR. Janë miratuar nga MBZHR, sipas kërkesave të OBU, 6 certifikata për eksporte të produkteve me origjinë jo shtazore konkretisht: për verë në Belgjikë, për biskota në Libi, për prodhime brumi në Libi, kroasant në Ukrainë, vaj ulliri dhe verë në Itali, si dhe certifikatë për ushqim për kafshë në Emiratet e Bashkuara Arabe;
- Referuar modelit të miratimit të certifikatave për Eksport në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë kryer eksporte të produkteve te qumështit UHT dhe produkteve të tij;
- Përgatitje e raporteve periodike, progres raporteve dhe raporte periodike për Nënkomitetin e Bashkimit Evropian;
- Sektori ka monitoruar planin e mbetjeve në produktet me origjinë shtazore. Referuar daljes së rezultateve mbi normë të mostrave të dërguara për analizimin në kuadër të Planit Kombëtar të Mbetjeve për vitin 2022, AKU ka kryer inspektime të përbashkëta me veterinerët e AKVMB, për të verifikuar daljen e këtij rezultati pozitiv si dhe të produkteve të këtyre kafshëve;
- Pjesëmarrje në grupe pune duke dhënë dhënë kontributin në:
    - ✓ Në hartimin e planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve për vitin 2022, Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030, Metodologjinë e zhvillimit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, Për Vlerësimin e riskut biologjik dhe sëmundjet infektive në Shqipëri, Draft Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027 (SNBZHRP), në hartimin draft ligjit për "Bletarinë", draft ligjit për "Prodhimin Organik", draft ligjit për "Verën dhe vreshtarinë", në manualin e menaxhimit të krizave.
    - ✓ Në lidhje me prioritet e AKU në zbatim të VKM nr. 91, datë 09/02/2022 "Për miratimin e planit kombëtar për integrimin Evropian 2022-2024", kemi dhënë kontribut në hartimin e planit të veprimit të AKU për PKIE (për kapitullin 12 dhe kapitullin 13).
    - ✓ Sektori në bashkëpunim me personat e kontaktit (IPARD) ka përgatititur draft chek -listat dhe dokumentat shoqëruese në lidhje me sektorët në kompetencë të AKU-së në implementimin e IPARD III specifikish për: Stabilimentet e grumbullimit e përpunimit të bimëve aromatike dhe medicinale (BMA); Stabilimentet e përpunimit të peshkimit; Stabilimentet e përpunimit të ullirit, si

dhe stabilimentet e prodhimit dhe tregtimit të vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit nëpërmjet deklaratave dhe vërtetimeve përfundimtare;

- ✓ Sektori ka marrë pjesë në trajnime;
- ✓ Sektori ka në proces dhe përditësimin e listë verifikimeve përkatëse sipas grup produkteve.

Arritjet:

- Ka propozuar dhe miratuar manualin për procedurat të cilat ndiqen në kryerjen e procesit të certifikimit të produkteve me origjinë shtazore në stabilimentet të cilat eksportojnë në vendet e BE-së dhe në vendet jo të BE-së;
- Përmirësimi në njehsimin e procedurave të inspektimit të DRAKU;
- Ngritje e nivelit profesional të inspektorëve nëpërmjet trajnimeve të kryera në bashkëpunim me projektin Food Safety me lidhje me kontrollin e implementimit të planit HACCP në stabilimentet e peshkut me të drejtë eksporti në vendet e BE-së, trajnim i bërë në dy faza.

Gjatë vitit 2022 nga trupat inspektuese në rang kombëtar janë kryer gjithsej **27 454** kontrolle nga të cilat **22 430** kontrolle të planifikuara dhe **5 024** jashtë planit vjetor të kontrolleve. Realizimi i planit të kontrolleve gjatë vitit 2022 në total është në masën ***106.7%*** por kontrollet e programuara të realizuara, **ndaj atyre të Planifikuara janë në masën *87.2 %.***

Gjithashtu sektori ka kryer intesifikime të inspektimeve dhe monitorimeve të OBU-ve referuar sigurisë ushqimore dhe fluksit të rritjes së ndjeshme të tregtisë së produkteve ushqimore, kryesisht në markete dhe supermarkete, tregje ushqimore apo fruta perimesh, njësi tregtimi të mishit dhe produkteve të tij, në magazina frigoriferike, stabilimente prodhimi, pastiçeri, restorante etj., Bazuar edhe nga eksperiencat e mëparshme u hartua plani i inspektimeve të OBU që ushtrojnë aktivitet si pranë zonave turistike, qendrave të mëdha urbane, në të gjithë vendin, njoftimi i të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në këto ambiente, në lidhje me kërkesat që ata duhet të përmbushin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Gjithashtu sektori ka marrë pjesë në ndjekjen dhe monitorimin pas shfaqjes së influencës aviare, për verifikimin e të gjitha subjekteve që tregtojnë mish të bardhë si dhe të produktin vezë.

Tabela 1. Të dhëna mbi realizimin e planit të inspektimeve në rang vendi

Natyra e subjektit	Kontrolle të programuara në planin vjetor të kontrolleve 2022 (nr)	Realizimi i kontrolleve (nr)			Realizimi i Inspekimeve (%)		
		Total kontrolle të realizuara (nr)	Kontrolle të programuara (nr)	Kontrolle të pa programuara (nr)	Kontrolle te Realizuara total ndaj të Programuara (%)	Kontrolle te Programuara te realizuara, ndaj të Planifikuara (%)	Realizim kontrolle te pa programuara ndaj kontrolleve të Programuara (%)
OSH	12 328	13 963	11 320	2 643	113.3%	91.8%	21.4%
OJSH	13 392	13 491	11 110	2 381	100.7%	83.0%	17.8%
Total	**25 720**	**27 454**	**22 430**	**5 024**	**106.7%**	**87.2%**	**19.5%**

Grafiku. 1 Të dhëna mbi realizimin e planit të inspektimeve në rang vendi



Mosrealizimi kontrolleve të programuara ka ardhur si:

- Subjekte të mbyllura ose të ç'rregjistruara, mungesë burime njerëzore dhe raporte shëndetësore,
- Bllokim i përkohshëm i sistemit te inspektimeve,
- Numri i lartë inspektime të paprogramuara për licensim, denoncime, Rasff, etj.

Tabela 2. Të dhëna mbi inspektimet e kryera në rang vendi për vitin 2022

VITI 2022	Inspektime fakt	Paralajmërim	Gjoba		Bllokim					Asgjësim Produkti					Nderprej e Aktiviteti
			Nr.	Vlerë (000 lekë)	Raste *(nr)*	Sasia (ton)	Sasia (Litra)	Sasia (Kokrra veze)	Sasia cope	Raste *(nr)*	Sasia (ton)	Sasia (Litra)	Sasia (Kokrra veze)	Sasia cope (paketa)	
	32 763	4 959	471	76 370	333	412.4	961 730	2 644 152	133	185	2 456	2 671 236	569 843	231 750	67

Në Planin zyrtar me bazë risku është përcaktuar edhe matrica e marrjes së mostrave gjatë inspektimeve, realizimi i të cilës paraqitet si më poshtë:

Tabela 3. Të dhëna mbi realizimin e planit të marrjes së mostrave në rang vendi

AKU			ISUV		
Mostra të planifikuara	Mostra të marra	% e realizimit të planit	Mostra të planifikuara	Mostra të marra	% e realizimit të planit
7 075	3 703	52%	2 416	2 283	94%

Grafiku. 2 Të dhëna mbi realizimin e planit të marrjes së mostrave në rang vendi



Në zbatim të Urdhrit të Ministrit Nr.439, datë 04.10.2022 "*Për miratimin e Planit të Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve për periudhën tetor 2022-dhjetor 2023*", rezulton se është realizuar në **masën 89.3%,** nga 290 mostra të planifikuara janë realizuar 259. Drejtoritë Rajonale me realizim më të ulët janë Fieri me 52 % dhe Berati me 76%. (Tabela bashkëlidhur në aneksin nr.1).

- **Inspektimet në Stabilimentet e përpunimit të peshkut dhe marrja e mostrave**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë kryer inspektime në subjektet me aktivitet përpunim peshku me të drejtë eksporti në vendet e BE ku gjatë kësaj periudhe në këto OBU janë kryer inspektime si dhe janë marrë mostra zyrtare për analizim si më poshtë:

Tabela 4. Inspektimet e kryera në stabilimentet e përpunimit të peshkut dhe marrja e mostrave

Drejtoria Rajonale	Stabilimente Peshku	Inspektime të Realizuara *(nr)*	Inspektime të Pa-Planifikuara *(nr)*	Mostra te analizuara						
				Mikrobiologjike	Histamina	Metale te Renda	Parasite	TVBn	TMAn	PCBs
Tirane	4	48	-	41	16	18	-	11	-	-
Durres	6	70	3	79	31	13	7	8	-	56
Shkoder	2	23	-	5	12	2	-	-	-	-
Vlora	7	83	-	67	-	10	60	60	-	60
Fier	1	12	-	-	4	5	-	0	-	12
Elbasan	6	55	4	63	19	11	-	-	-	-
Lezhe	6	42	5	66	29	11	-	-	-	-
TOTAL 2022	32	333	12	321	111	70	67	79	-	128

Krahasuar me vitin 2021 gjatë vitit 2022 është rritur numri i mostrave të marra me 68%.

- **Eksportet e kryera drejt vendeve të BE nëpërmjet sistemit TRACES dhe AKU-net.**

Shqipëria është pjesë e këtij sistemi dhe e përdor me sukses këtë sistem, në të gjitha hallkat e përfshira. Ky sistem lehtëson gjurmueshmërinë e produkteve të cilat shkojnë drejt BE duke rritur besueshmërinë e produkteve shqiptare, si dhe duke dhënë një përmirësim të ndjeshëm në funksionimin e zinxhirit të kontrollit.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë kryer ***2 678*** eksporte me origjinë shtazore shqiptare në total, ku 74% e zënë eksportet me vendet e BE-së dhe 36% eksportet me vende jo të BE-së. Në vijim jepen në mënyrë të detajuar të dhënat e eksporteve për vitin 2022.

Tabela 5. Eksportet e kryera për produktet me origjinë shtazore

DRAKU	EKSPORTE VITI 2022		EKSPORTET NE VENDET E BE -se						EKSPORTET JO NE VENDET E BE-se					
	Ne vendet e BE	Jashte vendeve te BE	*Produkte peshku*	*Kembe bretkosa*	*Veze*	*Zorre derri,vici*	*Kermilli*	*Mjalti*	*Produkte peshku*	*Veze*	*Zorre derri,vici*	*Produkte qumeshti*	*Produkte mishi*	*Lende e pare pasticeri, qumesht pluhur*
Tirane	71	486	71	-	-	-	-	53	131	6	-	4	94	198
Durres	325	191	298	-	27	-	-	-	187	4	-	-	-	-
Berat	9	44	-	-	9	-	-	-	-	-	-	44	-	-
Shkoder	117	16	117	-	-	-	-	-	2	-	-	14	-	-
Vlore	448		411	37	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fier	93	40	93	-	-	-	-	-	-	-	-	34	6	-
Elbasan	448	5	448	-	-	-	-	-	5	-	-	-	-	-
Korca	5	7	-	-	-	-	5	3	-	-	-	3	1	-
Lezha	461	44	392	-	-	69	-	-	42	-	2	-	-	-
Gjirokaster		15	-	-	-	-	-	-	-	-	-	15	-	-
Total	**1 977**	**848**	**1 830**	**37**	**36**	**69**	**5**	**56**	**367**	**10**	**2**	**114**	**101**	**198**

Krahasuar me vitin 2021 gjatë vitit 2022 është rritur numri i eksporteve me 26 %, ku konstatohet rritje më e lartë e eksporteve e produkteve të peshkut.

Eksportet e produkteve me origjine shtazore dhe jo shtazore në "Open Balkan" për vitin 2021 dhe 2022.

Tabela 6. Volumet e eksporteve për produktet me origjinë shtazore dhe jo shtazore në "Open Balkan", vitet 2021-2022

Viti	Sasia ton	Sasia litra	Nr. Ngarkesa
2022	**202.7**	**2 569 306**	**287**
2021	**219.5**	**985 680**	**117**

Grafiku. 3 Të dhënat e eksporteve për vitet 2021-2022



AKU ka monitoruar zbatimin e planit të monitorimit të mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimore, miratuar me Urdhër të Ministrit, urdhër i cili planifikonte marrjen e mostrave.

Për vitin 2021 dhe 2022 (periudha Qershor 2021-Prill 2022), u veprua në zbatim Udhëzimit Nr.12 datë 01.06.2021 "Per një shtesë në Udhëzimin Nr.3 datë 18.01.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me Bazë Risku dhe të marrjes së Mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojten e Bimeve dhe Inputeve Bujqesore, si dhe Planin e Marrjes së Mostrave në PIK".

- Në total për vitin 2022 (periudha **janar 2022-dhjetor 2022)**, ju informojmë:
  - Mostra të planifikuara: 533
  - Mostra te dërguara në ISUV: 471

  Rezultate nga analizat:

  - Konforme: 69
  - Jo konforme: 54
  - Në pritje të përgjigjes: 348

Në vijim, gjeni raportimin për planin HACCP vetëm për subjektet që kërkojnë licencë për vitin 2022:

Tabela 7. Të dhënat për planin HACCP për periudhën Janar-Dhjetor 2022

Periudha	OJSH		OSH	
	Implementojnë	Në proces	Implementojnë	Në proces
Janar - Dhjetor 2022	91	35	273	88

Në vitin 2022 kanë aplikuar për licencë 487 subjekte dhe nga këto implementojnë planin HACCP 364 subjekte.

AKU ka kërkuar nga të gjitha DRAKU-t të raportojnë të gjitha subjektet që aplikojnë planin HACCP por nuk kanë nevojë për licencë.Ky informacion do të menaxhohet nga Drejtoria e Menaxhimit dhe sektori i statisitikave dhe do të përditësohet nga raportimet e koordinatorëve rajonalë.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, në rang kombëtar nga sektori i ushqimit në DRAKU respektive janë marrë në shqyrtim ***4 184*** etiketa nga të cilat ***2 388*** janë notifikuar dhe ***1 796*** nuk janë notifikuar.

Tabela 8. Të dhënat për notifikimin e etiketave për vitin 2022

Periudha Janar - Dhjetor 2022	Nr. i Subjekteve	Kërkesa Etiketa	Nr. Notifikime	Nr. Refuzime
	1 018	4 184	2 388	1 796

<u>Për periudhën raportuese informojmë se:</u>

- Sektori ka bashkëpunuar me sektorët e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar për zbatimin e masave emergjente që merr nga informacionet që vijnë nga RASFF. Konkretisht gjatë vitit 2022 janë trajtuar rastet si më poshtë:

Tabela 9. Tabela e trajtimeve të rasteve të ardhura nga sistemi RASFF

Periudha	Janar-Dhjetor 2022
RASFF	38 Njoftime nga sistemi RASFF - 10 Alerte me njoftim për Vëmendje. - 28 Alerte me njoftim për ndjekje. DRAKU në bashkëpunim me DPAKU ka ndjekur të gjitha procedurat për njoftimet e ardhura nga sistem, i RASFFdhe menjëherë ka kthyer përgjigje mbi masat e marra.

3.1.2 PROBLEMATIKA:

- DRAKU që kanë subjekte të cilat janë të pajisura me numër CE, inspektimet në këto OBU nuk kryhen nga trupa inspektuese e përcaktuar në urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm dhe për më tepër inspektorët e dytë nuk janë mjek veteriner, gjë e cila do të na penalizojë në auditimet që kryhen nga FVO, pasi kjo trupë inspektuese e përcaktuara në urdhër është përgjegjëse për kontrollin dhe certifikimin e produktit si një nga kushtet kryesor të eksporteve të produkteve.
- Mungesa e inspektorëve në DRAKU me formimin mjek veteriner, ka sjellë disa vështirësi pasi mjekët veterinerë janë:
  - Në grupet e inspektimit për kryerjen e kontrolleve zyrtare në OBU të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit e përpunimit të produkteve me origjinë shtazore, ku duhet të jetë i pranishëm mjeku veterinar në profesion.

- Si inspektorët të cilët kryejnë inspektimin e subjekteve prodhuese e përpunuese të peshkut, vezëve, me të drejtë eksporti në vendet e BE-së si dhe certifikimin e produktit, si edhe certifikimin e peshkut në tregun vendas, marrjen e mostrave të produktit midhje sipas planit te monitorimit të ardhur nga MBZHR, si dhe për kryerjen e certifikimit të këtij produkti.
- Kjo mungesë çon në vështirësi në marrjen e mostrave të monitorimit të molusqeve dhe certifikimit të produkteve të prodhuara si për eksport në vendet e BE ose dhe në Kosovë.

- Evidentimi në disa raste i mos ndjekjes së procedurës së asgjësimit nga trupat inspektuese. Të gjitha rastet janë të identifikuara dhe është përgatitur materiali për Drejtorinë e Shërbimeve të Brendëshme për ndjekje të mëtejshme administrative;
- Evidentimi i disa mangësive në listë verifikimet që përdorin trupat inspektuese;
- DRAKU janë orientuar sipas planit mujor të inspektimit, të kryejnë evidentimin e subjekteve të reja dhe atyre që kanë mbyllur aktivitetin, dhe listimin e tyre në planin e inspektimeve.

3.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM:

- Rritja e standardeve gjatë kontrolleve zyrtare për zbatimin e kërkesave të legjislacionit, në OBU që prodhojnë dhë përpunojnë produkte me bazë qumështi (baxhove dhe Stabilimenteve), si dhe produkteve të mishit;
- Hartimi i një plan veprimi për të gjithë operatorët e biznesit të ushqimit të cilët kryejnë prodhim, përpunim të peshkut dhe produkteve të tij dhe eksportojnë drejt BE me qëllim verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga grupi auditues i FVO;
- Rritja e standardeve për marrjen e mostra/ve zyrtare, garantimin e sigurisë së tyre, si dhe dërgimin e tyre në laborator;
- Plotësimi i inspektorëve me profesion mjek veteriner;
- Përditësimi i listë verifikimeve që përdorin trupat inspektuese.

ANEKSI 1 Tabela e realizimit të inspektimeve sipas DRAKU ve

3.2 SEKTORI I KOORDINIMIT TË KONTROLLIT TË MBROJTJES SË BIMËVE DHE INPUTEVE BUJQËSORE

Sektorit të Koordinimit të Kontrollit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Input-eve Bujqësore është të rrisë sigurinë në fushën e input-eve bujqësore, veprimtarive prodhuese të duhan cigareve, duke zbatuar me korrektësi kërkesat ligjore, me qëllim ruajtjen e jetës, të shëndetit të njerëzve, kafshëve, mbrojtjen e tokës dhe mjedisin.

3.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Propozon përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore, në përmbushje të nevojave për kryerjen e veprimtarisë si dhe në përputhje me legjislacionin e BE;
- Bashkëpunon në zbatimin e planit vjetor të detajuar me bazë risku, të miratuar nga MBZHR;
- Promovimi i kërkesave dhe standardeve të përditësuara që duhet të plotësojnë OB në fushën e input-eve bujqësore, veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve;
- Bashkëpunime me institucione dhe organizata ndërkombëtare që trajtojnë çështjet në fushën e mbrojtjes së bimëve, inpu-eve bujqësore dhe veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve.
- Forcimin e kapaciteteve sektoriale në drejtim të rritjes së nivelit profesional të stafit me qëllim rritjen e cilësisë së inspektimeve. Trajnimin dhe certifikimin e vazhdueshëm të inspektoreve të kontrollit të mbrojtjes së bimëve dhe input-eve bujqësore nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në seminare dhe trajnime me karakter profesional kualifikues.

Detyrat:

- Koordinon kryerjen e kontrollit zyrtar në fushën e Input-eve Bujqësore, dhe veprimtarisë prodhuese të duhan cigareve në të gjitha hallkat e zinxhirit për prodhimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin e tyre;
- Kryen monitorimin e Sektorëve të KKMBIB në Drejtoritë Rajonale të AKU-së.
- Gjatë kontrolleve zyrtare të kryera nga sektorët KKMBIB të DRAKU-ve, apo dhe në bashkëpunim me Sektorin KKMBIB në DPAKU si trupa mbështetëse e specializuar në veprimtarinë e inspektimit, si dhe referuar raportimeve periodike identifikon mangësitë e plotësimit të kërkesave ligjore ndaj OB, mungesën e bazës ligjore dhe propozon nevojën për ndryshime/përmirësime në ligje, akte ligjore e nënligjore tek DMRKKZ, unifikon praktikat e kontrolleve zyrtare për Operatoret e Biznesit, përcakton formatin dhe mënyrën e raportimeve, identifikon nevojën për trajnime të stafit, përpunon raportimet për aktivitetet e sektorëve të DRAKU dhe përgatit raporte pune mbi aktivitet dhe veprimtarinë e Sektorit në rang vendi për Drejtorin e Menaxhimit;
- Informon me shkrim SPMB-në, në bashkëpunim me Drejtorinë e Vlerësimit, brenda muajit mars të çdo viti, për sasinë dhe cilësinë e secilit PMB, që është hedhur në treg si dhe është përdorur gjatë vitit të mëparshëm kalendarik dhe për probleme të veçanta, që kanë lidhje me monitorimin e PMB-ve;
- Përgatit raporte përkatëse sipas formatit të kërkuar për Raportimet e Progres Raportit, Nën-komitetit të Bujqësisë dhe Peshkimit mbi veprimtarinë e kryer nga sektori dhe është pjesë e takimeve dhe delegacionit për raportim, në lidhje me proceset me miratim nga Drejtori i Drejtorisë;

Aktiviteti dhe arritjet:

Aktivitete: Sektori i KKMBIB në DPAKU, gjatë vitit 2022, ka kryer veprimtarinë e mëposhtme:

1. Sektori është pjesë aktive në grupe të ndryshme pune institucionale, ndërinstitucionale dhe ministrore (përfaqësuar me anëtar), të zhvilluara në AKU, MBZHR, MFE[1], MSHME[2] etj., që mbulojnë fushën e mbrojtjes së bimëve dhe input-eve bujqësore, specifikisht:

- Për permirësime të kuadrit ligjor me grupe poune në MBZHR në proces janë 5 Projekt Ligj dhe Udhëzime;
- Pjesëmarrje në grupe ndërinstitucionale për hartimin e Planeve Kombëtare të Emergjencave Civile, Menaxhimit të Sigurt të Kimikateve në Shqipëri dhe për masat kundër antibiotiko-rezistencës.
- Pjesmarrje në grupe pune të ngritura me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshmëm të AKU së.

2. Pjesëmarrje në trajnimet e organizuara nga projekti "Mbështetje për procesin e integrimit evropian", BTSF, Irlandez "Food Safety", USDA), FAO, AFCT, Invest dhe ASPA. Gjithashtu për vitin 2022 Sektori KKMBIB në DP. AKU, ka përgatitur modulet dhe ka zhvilluar programin e trajnimit nëpërmjet të cilit ka trajnuar inspektorët e Sektorëve KKMBIB në DR. AKU në lidhje me njohjen e kuadrit ligjor, procedurat e kontrollit zyrtarë dhe procedurën e marrjes së mostrave për inputet bujqësorë.

Nga raportimet e Sektorëve KKMBIB të DRAKU-ve dhe përpunimit të informacioneve periodike, bazuar në planin vjetor të kontrolleve zyrtare dhe marrjes së mostrave me bazë risku të miratuar, për vitin 2022, ***janë planifikuar*** gjithsej ***5 253 inspektime*** dhe ***janë realizuar 5 309 inspektime*** ***(***4669 inspektime të programuara/640 të pa programuara/tabela nr.1, Aneksi 1)**,** referuar planit, si dhe inspektimeve për licencim, urdhrat e veçantë apo specifikë, ankesave, njoftimeve të ndryshme, etj.

Tabela 10. Nr. total i inspektimeve të planifikuara dhe realizuara sipas planit vjetor/mujor të miratuar për vitin 2022, për sektorët e KKMBIB në rang kombëtar

Sektori KKMBIB / rang kombetar	Inspektime të planifikuara në planin vjetor të inspektimeve 2022	REALIZIMI I INSPEKTIMEVE PER VITIN 2022					% e realizimit nga inspektimet e programuara
		Inspektime të realizuara gjithsej 2022	Nga këto				
			Inspektime të programuara	Inspektime të pa programuara			
				Total inspektime të kryera jashtë programit	Ri inspektime	Denoncime/ kërkesa per licensim / urdhëra të posacme etj	
TOTALI	5253	5309	4669	640	77	563	88.88%

Gjithashtu, janë kryer gjithsej në rang kombëtar **5 309** inspektime ***sipas llojit të aktivitetit,*** përkatësisht:

- Për tregtimin e **PMB-ve** 1 171 inspektime.

[1]Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
[2]Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale

- Për tregtimin e **MMSHB-ve** 1 725 inspektime.
- Për tregtimin e **produkteve plehëruese** 1 391 inspektime.
- Për tregtimin e **duhanit dhe produkteve të tij** 1 022 inspektime.

Bazuar në Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, Sektorët KKMBIB të DRAKU në bashkëpunim me trupat mbështetëse të Sektorit KKMBIB dhe Sektorit të Hetimit në DPAKU, kanë intensifikuar kontrollet zyrtare në OB që ushtrojnë aktivitetin në fushën e tregtimit të input-eve bujqësore PMB-ve/PP/MMSHB (farmacitë bujqësore), me objekt "kontrollin/monitorimin e PMB-ve të paregjistruara në RSH, PMB-ve të skaduara dhe ndjekjen e gjurmueshmërisë së tyre, si dhe përputhshmëria e aktivitetit konform kërkesave ligjore".

Gjatë kontrolleve zyrtare të kryera në OB që ushtrojnë aktivitetin në fushën e input-eve bujqësore, veprimtarive prodhuese të duhan cigareve, për vitin 2022, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore për të cilat janë marrë gjithsej këto masa administrative (tabelën nr. 3/Aneksi 1):

- **67** Paralajmërime (53 PMB, 8 MMSHB, 3 PP, 3 duhan),
- **42** Gjoba (33 PMB, 5 MMSHB dhe 4 PP), me vlerë 5 310 000 lekë,
- **23 ton dhe 17 litra** impute bujqësore (PMB, MMSHB, PP Duhan)

Në zbatimin të planit të zyrtar të marrjes dhe analizimit të mostrave për vitin 2022 rezulton se nga Sektorët KKMBIB të DRAKU-ve janë planifikuar për t'u analizuar gjithsej **415** mostra (41 PMB, 166 fara, 144 PP, 64 fidanë) si dhe janë marrë dhe dërguar në laboratorët respektiv **398** ***mostra*** (41 PMB/36 konform, 4 në proces, 1 dëmtuar gjatë transportit; 162 fara/161 konform, 1 jokonform; 147 PP/145 konform, 2 jokonform; 48 fidanë/39 konform, 9 në proces).

Tabela 11. Tabela e planit të marrjes dhe analizimit të mostrave për periudhën Janar-Dhjetor 2022

Laboratori		**Plan**	**Fakt**	**%**	**jokonforme**
ISUV (PMB)		41	41	100%	1
Analiza per papasterti	*AKU*	32	44	137%	0
	ISUV	32	4	12%	0
ESHFF (fara)		166	162	97%	1
QTTB (P. Pleheruese)		144	147	102%	2
Total		**415**	**398**	**95%**	**4**

Arsyet e mosrealizimit të marrjes së mostrave konsistojnë:

- Mos pranim/ mungesë kapaciteti nga laboratori ISUV;
- Mungesë inspektorësh në DRAKU Dibër;
- (4 mostra), (1 mostër) dëmtuar në transport jashtë shtetit;

- Tejkalimi i mostrave (3) për produktet plehëruese kanë ardhur me kërkesë subjekti (2) dhe 1 mostër e marrë për verifikim gjatë inspektimit.

Arritjet:

Gjatë veprimtarisë së sektorit për vitin 2022 janë realizuar:

- Finalizimi dhe miratimi Plani i Veprimit *"Për përdorimin e qëndrueshëm të Produkteve të mbrojtjes së bimëve për periudhën 2022-2032"*. Plani u finalizua me mbështetje të ekspertëve të FAO/miratuar me Urdhër të Ministrit të MBZHR Nr. 578 prot., datë 2.12.2022 botuar në fletoren zyrtare Nr. 168/2022;
- Miratimi i VKM Nr. 332, datë 18.05.2022 "Përcaktimin e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importit, tregtimit, dhe përdorimit të produkteve plehëruese";
- VKM Nr. 460, datë 29.6.2022 "Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021-2022";
- Udhëzimit Nr. 2, datë 15.03.2022 "Për miratimin e rregullave specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve" i ndryshuar me urdhëzim Nr. 20, datë 2.12.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit Nr. 2, datë 15.3.2022, botuar në fletoren zyrtare Nr. 168/2022;
- Përditësimi dhe miratimi i të gjithë listë verifikimeve që operon sektori në OB që ushtrojnë aktivitetin në fushën e input-eve bujqësore dhe veprimtarisë prodhuese të duhan-cigareve sipas kërkesave të IQ dhe kërkesave të akteve ligjore/nënligjore të botuara në fletoren zyrtare gjatë vitit 2022. Listë verifikimet janë hedhur edhe në sistemin "e-inspektim;
- Si rezultat i kontrolleve periodike dhe këshillimeve te OB-ve jane konstatuar: përmirësim i kushteve të ruajtjes së input-eve bujqësore (MMSHB, PP dhe PMB) në pikat e tregtimit me shumicë dhe me pakicë, është rritur përgjegjësia për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit shoqërues të mallit, si dhe nga rikontrollet në OB që tregtojnë PMB është rritur përgjegjësia në plotësimin e regjistrave/librit të tregtimit të PMB-ve të klasifikuara si "PMB me rrezikshmëri" dhe "PMB rrezik i lartë";
- Sensibilizimi i 620 OB nëpërmjet shkresave ndërgjegjësuese me lëndë: "Kujtesë për importuesit dhe/ose ambalazhuesit e produkteve për mbrojtjen e bimëve" dhe "Kujtesë për furnizuesit që ushtrojnë veprimtarinë e importit, prodhimit dhe tregtimit të materialit mbjellës shumëzues dhe bimorë", me qëllim njohjen dhe vëmendje të shtuar ndaj ndryshimeve/kërkesave të kuadrit ligjor.

3.2.2 PROBLEMATIKA:

Gjatë veprimtarisë së sektorit për vitin 2022, referuar dhe raportimeve periodike të sektorëve KKMBIB në DRAKU janë konstatuar këto problematika:

- Mungesë e bazës ligjore për procedurën e; licencimit të OB për prodhimin dhe tregtimin e PP me rrezikshmëri; tolerancat e produkteve plehëruese; mungesa e një udhëzuesi /metodologjie për trajtimin / komunikimin e rasteve të raport provave të PMB-ve të analizuara nga laboratori ISUV; mungesa e udhëzimit për asgjësimin e PMB-ve të

papërdorshme dhe ambalazheve të tyre, si dhe mungesa e urdhrit për marrjen dhe analizimin e mostrave të MMSHB për pastërti fitosanitare;

- Gjatë inspektimeve të PP-ve, PMB-ve dhe MMSHB-ve, nga Sektorët e KKMBIB në DRAKU janë evidentuar disa mangësi në plotësimin e kërkesave ligjore, konkretisht: Tregtim i PMB-ve dhe i PP-ve të paregjistruara në Republikën e Shqipërisë; PMB me etiketë të pa miratuar dhe në gjuhë të huaj; Ri ambalazhim dhe tregtim të PMB-ve me ambalazh të pa miratuar në njësitë e tregtimit me pakicë; PMB të skaduara në njësitë e tregtimit me pakicë; Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë të vendosura nga inspektorët; Mos përditësim të librit të shitjes me pakicë të PMB-ve "të rrezikshme" dhe PMB-ve "me rrezik të lartë"; MMSHB (fara perimesh) importi pa etiketë shtesë në gjuhën shqipe/të pa certifikuara nga ESHFF; MMSHB me tregues cilësor (fuqi mbirëse) nën normën e lejuar për mbjellje (vetëm 1 rast); Mungesë në ndarjen e loteve të veçanta të bimëve dekorative dhe mungesë të mbajtjes së të dhënave për fidanët që shesin ose shpërndajnë; Mungesë të pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri në njësitë e tregtimit me pakicë të PP (vetëm 1 rast); PP të pa sistemuara në ambientet e tregtimit/magazinimit; Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar në inspektimet e mëparshme;
- Kthim përgjigja me vonesë e përgjigjeve të analizimit të mostrave të PMB-ve nga ISUV të dërguara në vitin 2021 dhe për 4 mostrat e dërguara në vitin 2022 (ende pa përgjigje). Gjithashtu, shqetësim mbetet mospranimi i mostrave të MMSHB (fidanë) nga laboratori i DMB ISUV për pastërtinë fitosanitare;
- Mungesa e mjeteve të nevojshme për marrjen, transportimin dhe garantimin e mostrave të input-eve bujqësore;
- Me rekrutimin e inspektorëve të rinj në Sektorin e KKMBIB, është rritur nevoja për trajnime;

3.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Realizimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe i marrjes së mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Input-eve Bujqësore, si dhe Plani i Marrjes së Mostrave në PIK për vitin 2023, (miratuar me Udhëzim të Ministrit Nr. 22, datë 29.12.2022);
- Përgatitja e shkresës ndërgjegjësuese për të gjithë OB që tregtojnë PMB në lidhje me plotësimin e regjistrave / librit të tregtimit të PMB-ve të klasifikuara si "PMB me rrezikshmëri" dhe "PMB rrezik i lartë";
- Intensifikimin e kontrolleve zyrtare në periudhat më intensive të kryerjes së shërbimeve agroteknike të kulturave bujqësore nëpërmjet urdhrave të DPAKU me qëllim garantimin e fermerit shqiptar me inpute bujqësore cilësore;
- Për përmirësimin e logjistikës për marrjen, kodifikimin e mostrave dhe dërgimin në laborator nga ana e sektorit KKMBIB në planin financiar për vitin 2023;
- Pjesëmarrje dhe dhënie kontributi në grupet e punës në MBZHR, për hartimin e "Për shëndetin e bimëve" sipas kërkesave të BE, etj;
- Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor me të cilën operon sektori;
- Përgatitja e programit të trajnimeve për inspektorët e sektorëve KKMBIB për vitin 2023;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimi me palët e interesit.

Në aneksin nr. 1 do të gjenden si më poshtë:

Tabela Nr. 1: *Inspektimet e planifikuara dhe realizuara sipas planit vjetor/mujor të miratuar nga MBZHR / IQ për vitin 2022, për Sektorët e KKMBIB në DRAKU.*
Grafiku Nr.1*: Inspektimet e planifikuara dhe realizuara nga Sektorët e KKMBIB të DRAKU-ve, për vitin 2022.*

Tabela Nr. 2: *Inspektimet e realizuara nga Sektorët e KKMBIB në DRAKU-u sipas llojit të aktivitetit, për vitin 2022.*

Tabela Nr. 3: *Masat administrative të marra nga Sektorët KKMBIB sipas qarqeve dhe llojit të aktivitetit për vitin 2022.*

Tabela Nr. 4: *Të dhënat statistikore krahasuese për vitin 2022 me vitin 2021 në lidhje me numrin e inspektimeve të kryera dhe masat administrative të marra nga sektorët KKMBIB, në rang vendi.*

Grafiku Nr.2*: Inspektimet e kryera per vitet 2021-2022 ne rang kombetar Sektorii KKMBIB*
Tabela Nr. 5:*Mostrat e planifikuara dhe realizuara nga Sektorët KKMBIB të DRAKU-ve, si dhe përgjigjet e analizave (konform, jo-konform dhe në proces) për vitin 2022.*

3.3 SEKTORI I LICENCIMIT DHE DOKUMENTACIONIT TË OBU

Sektori luan një rol shumë të rëndësishëm në kontrollin, verifikimin, shqyrtimin e gjithë procesit të licencimit dhe regjistrimit në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshë dhe në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, me synim zbatimin me rigorozitet të legjislacionit përkatës në të gjithë Operatorët e Biznesit.

3.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TE SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Standardizimi i dokumentacionit, ndjekja e gjithë të procesit të licencimit në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshë dhe në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore ne kompetencë të AKU-së dhe respektimi i afteve ligjore;
- Standardizimi, vlerësimi dhe përcjellja e dokumentacionit gjatë gjithë procesit të aksesimit në Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik për miratimin paraprak të njësive të tregtimit të mishit dhe thertoreve dhe mbylljen e aplikimeve brenda afateve ligjore;
- Aksesimi i sistemeve AMS/ SQDNE dhe delegimin e tyre brenda afateve të përcaktuara në Drejtoritë Rajonale të AKU-së përgjegjëse.
- Monitorimi i të gjithë kërkesë aplikimeve, identifikimi dhe zgjidhja e problematikave në sistemin Aplikativ/ SQDNE dhe AMS të aplikimeve që i përkasin operatorëve të biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore.

Detyrat:

- Mbikqyrjen dhe verifikimin e dokumentacionit të procedurës së licencimit në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshë dhe në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore në kompetencë të AKU-së, si dhe mbajtjen e dokumentacionit përkatës e dokumentet e tjera shoqëruese;
- Koordinimin dhe ndjekjen e procedurës së licencimit të operatorëve të biznesit dhe vlerësimin e procedurës së inspektimit të kryer nga sektorët e Drejtorive Rajonale sipas parashikimeve ligjore me cilesi dhe në afatet e parashikuara;

- Përcjelljen në autoritetin përkatës, të propozimit për revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rastet gjatë kryerjes së kontrolleve zyrtare rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas legjislacionit në fuqi;
- Identifikimin e problematikave në lidhje me procedurat e inspektimit, si dhe shkresat kthim përgjigje të ardhura nga DRAKU për OB të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore dhe raportimi tek Drejtori i Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar;
- Identifikimin e problematikave në sistemin aplikativ në aplikimet që i përkasin operatorëve të biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore dhe raportimi tek Drejtori i Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar, duke rekomanduar dhe zgjidhjen e tyre;
- Mbikqyrjen, verifikimin, vlerësimin dhe përcjelljen e dokumentacionit gjatë gjithë procesit të aksesimit në Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik për miratimin paraprak të njësive të tregtimit të mishit dhe thertoreve;
- Përgatitjen e raporteve periodike si dhe dhënien e informacioneve brenda afateve ligjore sipas kërkesave të operatorëve të biznesit në lidhje me hapat procedurale dhe dokumentacionin që nevojitet për t'u pajisur me licencë në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshë, të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore;
- Propozime për ndryshime apo shtesa në aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat operon sektori sipas funksioneve te tij tek Drejtori i Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar;
- Monitorimin e aplikimeve për notifikimin e etiketave sipas sistemeve AMS/ SQDNE dhe delegimin e tyre në Drejtoritë Rajonale të AKU-së përgjegjëse;
- Ndjekjen në vijim të respektimit të afateve kohore për notifikimin e etiketave, si dhe raportimin e problematikave, në mënyrë marrjen e masave të nevojshme për vazhdimësinë e punës;

Arritjet:

- Në ndihmë të procesit të licencimit, sektori i licencimit ka hartuar manuale të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së përkatësisht:

    - Manuali i procedurave të licencimit;
    - Manuali i procedurave të vlerësimit paraprak për regjistrim fillestar.

- Kontribut në hartimin e Udhëzuesit "Mbi procedurën e etiketimit të produkteve ushqimore" të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU –së me anë të urdhërit Nr. 9, datë 8.7.2022;
- Pjesëmarrje në trajnime/workshope;
- Përgatitje e raporteve periodike, progres raporteve dhe raporte periodik për Nënkomitetin e Bashkimit Evropian;
- Përgatitja e draft chek-listave dhe dokumentat shoqëruese në lidhje me sektorët në kompetencë të AKU-së në implementimin e IPARD III specifikisht për:

- Stabilimentet e grumbullimit e përpunimit të bimëve aromatike dhe medicinale (BMA);
- Stabilimentet e përpunimit të peshkimit;
- Stabilimentet e përpunimit të ullirit;
- Stabilimentet e prodhimit dhe tregtimit të vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit;
- Deklarata paraprake dhe vërtetimi përfundimtar.

- Pjesmarrje në takimin e 9 (nëntë) të Komitetit të Monitorimit të IPARD II në lidhje me
  - Pjesëmarrje në grupin e punës në lidhje me AKU-net "Përmirësimi i sistemit të inspektimit për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit" për: modulin e licencave dhe modulin e etiketave;

- Pjesëmarrje në grupe pune në bashkëpunim me MBZHR për përmirësime, shtesa apo ndryshime të bazës ligjore me të cilën operaon sektori i licencimit.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë shqyrtuar në total **609 kërkesë aplikime,** ndër të cilat **399 janë kërkesa të miratuara, 71 kërkesa të tërhequra nga vetë OBU, pa u mbyllur si procedurë nga AKU-ja** dhe **139 janë kërkesa të refuzuara,** për mosplotësim të kushteve dhe kritereve të licencimit për arsyet e mëposhtme:

- Planimetri e papërshtatshme, mungesë e ambienteve dhe hapësirave të duhura për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar për licencim;
- Mospërputhje e planimetrisë së dorëzuar në dokumentet provuese në QKB me planimetrinë reale të ambienteve të subjektit;
- Mospërputhje të vendit të ushtrimit të aktivitetit të subjektit të kërkuar për licencim me adresën e deklaruar në formularin e aplikimit dhe aktet përkatëse, apo mospërputhje të adresave të cituara në aktet përkatëse;
- Aplikime të gabuara që nuk i përkasin fushës së veprimtarisë së AKU-së, aplikime të cilat nuk kanë detyrim ligjor të pajisen me licencë, dublikimi i tyre në sistem, si dhe licenca të tjera aktive në fushën e ushqimit në të njëjtin ambient;
- Moskryerja e inspektimit për verifikimin e plotësimit të kushteve për arsye të mungesës apo prezencës së personit përgjegjës dhe të drejtuesit teknik;
- Mospërputhje të përshkrimit të veprimtarisë ndërmjet formularit të aplikimit dhe aktit të regjistrimit të subjektit;
- Mangësi të kushteve higjieno-sanitare, të ambienteve, pajisje si dhe mungesë e dokumentacionit teknik dhe ligjor *(analiza e ujit dhe librezat shëndetsore të punonjësve manuali i planit të vetëkontrollit HACCP, sistemi i gjurmueshmërisë, etj);*
- Drejtuesi teknik nuk ka njohuri dhe përvojën e duhur në fushën e sigurisë ushqimore dhe në fushën e agronomisë, apo është i punësuar në disa subjekte;
- Ambienti i magazinës së tregtimit me shumicë/pakicë të PMB-ve, nuk është i pajisur me mjetet e nevojshme dhe nuk plotëson kushtet e ruajtjes sipas kërkesave ligjore.
- Për ambientin që do të shërbejë si magazinë e tregtimit me shumicë të PMB-ve, nuk është marrë miratimi nga institucionet përkatëse për funksionimin e tyre.

Tabela 12. Aplikime për licencim për periudhën Janar-Dhjetor 2022

DRAKU	Janar -Dhjetor 2022							
	OSH (II.1A1,II.1.B)		OJSH (II.1A1,II,1.A2)		MBIB (II.5.A.2, II.5.A.3)		Total	
	Miratime	Refuzime	Miratime	Refuzime	Miratime	Refuzime	Miratime	Refuzime
Tiranë	17	13	41	7	6	4	64	24
Durrës	32	4	9	9	2	2	43	15
Berat	14	3	4	2	9	0	27	5
Shkodër	21	6	4	1	4	2	29	9
Vlorë	29	11	4	1	0	0	33	12
Fier	15	5	9	5	7	2	31	12
Dibër	15	7	0	0	1	0	16	7
Elbasan	12	11	4	2	0	2	16	15
Korçë	38	6	4	6	2	0	44	12
Lezhë	20	6	6	0	3	2	29	8
Gjirokastër	23	5	5	1	0	0	28	6
Kukës	37	11	1	1	1	2	39	14
Total	**273**	**88**	**91**	**35**	**35**	**16**	**399**	**139**

Shënim: Në tabelën e mësipërme nuk janë të përfshira tërheqjet nga sistemi (**71 kërkesa)**, duke qenë se këto aplikime nuk janë mbyllur në sistemin aplikativ të QKB nga sektori i licencimit.

Tabela 13. Aplikime për licencim sipas kategorive për periudhën Janar-Dhjetor 2022

KATEGORITE SPECIFIKE	Miratime	Refuzime	TOTAL Aplikime
Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, me kodin II.1 .A.1	233	79	312
Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren si ushqim, me kodin II.1.A.2	0	0	0
Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) me kodin II.1.B	131	44	175
Tregtim me pakicë (farmaci bujqësore), me kodin II.5.A.3	35	12	47
Tregtim me shumicë të PMB-ve, me kodin II.5.A.2	0	4	4
Periudha Janar- Dhjetor 2022	**399**	**139**	**538**

Nga analiza e tabelave të mësipërme, për periudhën raportuese tendenca në rritje apo në rënie e kërkesë aplikimeve për licencim nuk varet nga faktorë të veçantë, pasi këto aplikime bëhen me

kërkesë të vetë Operatorëve të Biznesit, por nga AKU-ja vazhdon ndërgjegjësimi, këshillimi dhe njoftimi i tyre në lidhje me ushtrimin e aktivitetit, sipas kërkesave ligjore.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 158 Prot., datë 25.11.2019 "*Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020*", Sektori i Licencimit dhe Dokumentacionit të Operatorëve të Biznesit Ushqimor ka në kompetencë të tij edhe lëshimin e dokumentit të miratimit paraprak për aplikantët të cilët para regjistrimit në QKR (QKB), si "persona fizik" pra, para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së therjes së kafshëve, si dhe të tregtimit të mishit e të nënprodukteve të tij, e kanë detyrim ligjor të pajisen me këtë dokument. (*Referuar Ligjit Nr 87/2012 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre", neni 13 "Detyrimi për regjistrim në QKR*"). Kjo procedurë kryhet përmes Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik nëpërmjet institucioneve shtetërore dhe funksionimi i këtij sistemi nga AKU, ka filluar me datë 17 Janar 2020.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë shqyrtuar në total **84 kërkesë aplikime,** ndër të cilat 49 **janë kërkesa të miratuara** dhe **35 prej tyre janë këkesa të refuzuara,** për mosplotësim të kushteve dhe kritereve ligjore.

Referuar aplikimeve nga personat fizikë të cilët përpara regjistrimit në QKR (QKB), pra përpara fillimit të veprimtarisë së therjes së kafshëve, si dhe tregtimit të mishit dhe nënprodukteve të tij, kanë detyrim ligjor të pajisen me aktin e miratimin paraprak nga AKU-ja, të dhënat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 14. Aplikime për pajisje me aktin e miratimit paraprak nga AKU-ja

DRAKU	Kërkesë aplikime SQDNE Janar - Dhjetor 2022		Total Aplikime
	Miratime	Refuzime	
Tiranë	15	17	32
Durrës	7	0	7
Berat	2	4	6
Shkodër	3	0	3
Vlorë	5	4	9
Fier	7	1	8
Dibër	2	1	3
Elbasan	4	3	7
Korçë	1	2	3
Lezhë	2	2	4
Gjirokastër	1	1	2
Kukës	0	0	0
Total	**49**	**35**	**84**

Notifikimi Etiketave

Ky shërbim ofrohet nëpërmjet sistemeve AMS/SQDNE dhe u mundëson operatorëve ushqimorë, aplikimin për notifikimin e etiketës, aplikim ky i cili delegohet në Drejtoritë Rajonale të AKU-së, përgjegjëse për shqyrtimin e konformitetit ligjor të etiketës/tave të produktit /ve ushqimor/e.

Sistemi AMS monitorohet nga Sektori i Licencimit dhe Dokumentacionit të Operatorëve të Biznesit Ushqimor, i cili ka ndjekur në vijim respektimin e afateve kohore për notifikimin e etiketave, si dhe raportimin e problematikat që janë hasur në këtë sistem për periudhën raportuese. Të gjitha problematikat i raportohen AKSHI-it në mënyrë marrjen e masave të nevojshme për vazhdimësinë dhe ecurinë e punës me qëllim moscënimin e këtij shërbimi.

3.3.2 PROBLEMATIKA

Sektori ka parashtruar disa problematika me anë të shkresave zyrtare, të cilat janë dërguar në MBZHR, por vazhdojnë të jenë në shqyrtim edhe pse janë bërë shkresa rikujtesë gjatë vitit 2022 përkatësisht:

- Propozime për disa ndryshime të *VKM-së Nr.538, datë 26. 05. 2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta",* e ndryshuar, të cilat janë në shqyrtim në lidhje me:
  - Interpretimin e dispozitave ligjore mbi përcaktimin e kategorisë së subjekteve të cilat janë të detyruar të pajisen me licencë në kategorinë II.1 "Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimit";
  - Nevojat e përdorimit të së njëjtës terminologji;
  - Specifikimin e veprimtarisë në aplikimet për licencë në fushën e ushqimit;
  - Disa shtesa dhe ndryshime në kriteret e posaçme për licencimin të nënkategorisë II.5A.
- Shfuqizimin e Urdhrit Nr. 56 datë 06.02.2006 "*Mbi Proçedurat e dhënies së lejeve teknikoteknologjike dhe profesionale për prodhimin e produkteve ushqimore*" dhe nxjerrjen e një akti të ri në përputhje me përcaktimet dhe detyrimet ligjore duke bërë të mundur që kualifikimet dhe funksionet të jenë të qarta dhe specifike sipas kategorive që i përkasin fushës së ushqimit, e cila është ende në shqyrtim dhe nuk kemi informacion për veprimet që janë ndërmarrë.

Gjithashtu një problematikë e konstatuar gjatë shqyrtimit të procedurave të licencimit është përcjellë në Sektorin e Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor, në lidhje me rishikimin e listë verifikimeve, të cilat nuk janë sipas modeleve që gjenden në sistemin e-Inspektimi përkatësisht:

- Listë verifikimi "Protokoll kontrolli mbi rezultatet e inspektimit sanitare veterinar të stabilimenteve që prodhojnë përpunojnë prodhime deti për konsum njerëzor".
- Listë verifikimi "Për Thertoret".

3.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Propozime për rishikime, ndryshime të akteve të reja ligjore/nënligjore dhe përmirësim të akteve të procedurave të inspektimit në mbështetje të punës së sektorit të licencimit, si dhe pjesëmarrje në grupe pune.

3.4 SEKTORI I KOORDINIMTI TË KONTROLLIT NË PIK

Sektori i Koordinimit të Kontrollit në PIK ka si qëllim koordinimin në kohë dhe me efikasitet raportimin e kontrolleve zyrtare të kryera si dhe evidentimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre në PIK-e. Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) janë në varësi të Drejtorive Rajonale përkatëse të AKU-së.

3.4.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Kryen koordinimin dhe unifikimin procedurave dhe praktikave të kontrolleve zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) të ngarkesave të ushqimit, të ushqimit për kafshë, të mbrojtjes së bimëve dhe të inputeve bujqësore, të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinare, duhanit dhe produktet e tij, të cilat hyjnë, dalin ose tranzitojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Bashkëpunon me sektorët e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrolleve Zyrtare dhe është përgjegjës për zbatimin e masave emergjente që merr nga informacionet që vijnë nga RASFF;
- Mbikqyr dhe monitoron të dhënat e inspektimit të produkteve ushqimore, kafshëve të gjalla, PMV, të mbrojtjes së bimëve, produkteve bimore dhe inputeve bujqësore;
- Bashkëpunon me sektorët e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrolleve Zyrtare dhe DRAKU dhe është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë problematikave të evidentuara në PIK;
- Analizon dhe unifikon mënyrën e raportimeve periodike lidhur me zbatimin e Planit të Marrjes së Mostrave në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK);
- Përgatit raportime ditore dhe informacione mbi kryerjen e aktiviteteve që mbulon PIK dhe i dorëzon në kohë tek Drejtori i Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrolleve Zyrtare dhe dërgon informacionin e përditësuar Drejtorisë përkatëse në MBZHR;
- Kryerjen e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar në lidhje më zbatimin e legjislacionit të fushës përkatëse dhe përputhshmërisë ligjore në kryerjen e veprimtarisë së inspektorëve të Kontrollit të PIK-ve,në bazë të një plan veprimi vjetor;
- Përgatit raporte përkatëse sipas formatit të kërkuar për plotësimin e rekomnadimeve të Raportit të Progresit, Nën-Komitetit BE-Shqipëri për Bujqësinë dhe Peshkimin mbi veprimtarinë e kryer nga sektori dhe është pjesë e takimeve dhe delegacionit për raportim, në lidhje me proceset me miratim nga Drejtori i Drejtorisë.

Gjatë vitit 2022

- Janë koordinuar dhe unifikuar procedurat për kontrollet zyrtare në PIK konkretisht:
    - Njohja e 35 certifikatave veterinare që shoqërojnë produktet me origjinë shtazore dhe kafshët e gjalla;
    - Është koordinuar procesi i lehtësimit të tregtisë në fushën e veterinarisë, sigurisë së ushqimit dhe fushën fitosanitare nëpërmjet marrëveshjes së Ballkanit Perëndimor midis Republikës së Maqedonisë së VeÇriut, Republikës së Serbisë dhe Republikës së Shqipërisë;
    - Koordinimi dhe unifikimi i procedurave në lidhje me importin e bimëve dhe produkteve bimore që duhet të shoqërohen me certifikatë fitosanitare.

▪ Operatorët e biznesit të cilat kryejnë import/eksport midis tre vendeve nuk ndalohen në pikën kufitare për të kryer kontrollin e identitetit dhe kontrollin fizik por vetëm dorëzojnë dokumentacionin më pas kontrolli i identitetit për kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore, jo shtazore dhe origjinë të përzier bëhet në doganën e brendshme, ku ka destinacionin ngarkesa. Kontrolli i identitetit për bimët dhe produktet bimore kryhet në doganën më të afërt me pikën kufitare të hyrjes.

▪ Vënia në funksion e marrëveshjes së "Open Balkan" ka shkurtuar orarin e qëndrimit të kamionëve në kufi nga 30 minuta në 5-10 minuta.

▪ Gjitahshtu ka patur komunikim të vazhdueshëm midis autoriteteve homologe midis këtyre 3 vendeve duke kryer unifikimin e **14** certifikatave veterinare për importin/eksportin e produkteve me origjinë shtazore dhe kafshë të gjalla për periudhën Prill-Dhjetor 2022 në krahasim me **2** certifikata veterinare për importin e produkteve me origjinë shtazore të njohura për vitin 2021.

▪ Janë propozuar nga sektori dhe miratuar nga MBZHR **18** certifikata shëndetësore veterinare për importin e produkteve me origjinë shtazore për periudhën raportuese:

- Peshkut;
- Për mjaltin dhe produktet e tjera të bletarisë të destinuar për konsum njerëzor;
- Për vezët e destinuara për konsum njerëzor
- Për qumështin të papërpunuar;
- Për mishin e freskët të llojit derra shtëpiak;
- Të zorrëve të kafshëve;
- Të vezëve klasi B të destinuara për konsum njerëzor;
- Për importin e mishit të përgatitur, etj.

▪ Me ndryshimet ligjore në fushën e mbrojtjes së bimëve "Për masat Mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve", përditësuar me rregulloren Komisionit (BE), është arritur lehtësimi i procedurave pasi jo të gjitha bimët dhe produktet bimore do të shoqërohen me Certifikatë Fitosanitare dhe si rrjedhojë nuk do ti nënshtrohen kontrollit në PIK rrjedhimisht edhe nuk do të tarifohen.

Tabela 15. Tabela e inspektimeve kufitare

PIK	Total	Produktet me Origjinë jo Shtazore	Produktet me Origjinë Shtazore	Kafshë të Gjalla	Produkte / Material Veterinar	Bimë dhe Produkte Bimore	Material Mbjellës dhe Shumëzues Bimor (MMSHB)	Produkte Plehërue se (PP)	Produkte të Mbrojtjes së Bimëve (PMB)	Makineri bujqësore të përdorura
Rinas	1 330	708	201	58	47	13	289	10	4	0
Durrës	19 251	9 926	6 392	2	17	2 138	211	361	34	170
Dogana e Brendsh me Berat	33	31	0	0	0	0	0	0	0	2
Hani i Hotit	13 158	5 318	1 998	307	90	5 074	93	220	56	2
Tuz	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vlorë	1 709	748	639	37	0	217	39	13	1	15
Qafë Botë	85	35	21	0	0	6	0	23	0	0
Dogana e Brendsh me Fier	133	129	4	0	0	0	0	0	0	0
Bllatë	132	97	0	0	0	16	19	0	0	0
Dog. Elbasan	23	3	4	0	0	16	0	0	0	0
Kapshticë	6 926	3 387	1 231	197	10	1 548	80	450	20	3
Qafë Thanë	7 536	4 312	1 740	122	24	1 045	104	157	32	0
Goricë	20	20	0	0	0	0	0	0	0	0
Shëngjin	11	2	9	0	0	0	0	0	0	0
Kakavi	8 848	3 996	1 803	1 464	5	1 373	29	166	6	6
Morinë	9 577	5 829	1 031	108	4	2 390	52	75	5	83
TOTAL	**68 772**	**34 541**	**15 073**	**2 295**	**197**	**13 836**	**916**	**1 475**	**158**	**281**

Krahasuar me vitin 2021 ka një rënie të ngarkesave me 6.1 % Produktet që kanë pësuar rritje janë: produktet me origjinë shtazore (6.5%), kafshët e gjalla (10%).

Sektori mbikqyr dhe monitoroni të dhënat që dergohen nga PIK në lidhje me ngarkesat që hyjnë dhe tranzitojnë në territorin e Shqipërisë. Janë ndjekur problematikat e evidentuara gjatë raportimeve të PIK-e konkretisht:

- Kalimi nga inspektorët e PIK Hani i Hotit, i dy subjekteve që kanë importuar kafshë të gjalla për therje në kundërshtim të urdhrit nr. 202, datë 07.04.2016 "Për koordinimin e kontrolleve në lidhje me procesin e therjes së njëhershme të kafshëve të importuara në Republikën e Shqipërisë", pika 4.
- Nga PIK Hani i Hotit, u konstatua se është kaluar një ngarkesë me "*lëkure të papërpunuar gjedhi*", me destinacion **Durrësin**, ky subjekt nuk është i pajisur me lejen për grumbullim, përpunim dhe eksportin/ importin e lëkurëve, pra nuk ka aktivitet të miratuar për eksport-import, referuar ligjit Nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Në PIK Morinë është kryer praktika për të cilën rezulton se nuk ka pasur njoftim paraprak për mbërritjen siç parashikohet në urdhrin Nr. 620, datë 28.12.2006 "*Manual mbi disa procedura teknike që duhet të ndiqen nga Pikat e Inspektimit Kufitar gjatë importit të kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore në Shqipëri*".

- PIK Durrës ka marrë një mostër me kërkesë te subjektit në kundërshtim me ligjin Ligji Nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar dhe **Urdhër Nr. 620**, datë **28.12.2006** "Manual mbi disa procedura teknike që duhet të ndiqen nga Pikat e Inspektimit Kufitar gjatë importit të kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore në Shqipëri".

Tabela 16. Marrja e mostrave në PIK

PIK	Mostra të marra (nr)		
	AKU	ISUV	TOTAL
OSH	196	46	242
OJSH	1858	39	1897
MBIB	60	6	66
Total	**2 114**	**91**	**2 205**

- Plani i Marrjes së Mostrave në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) është zbatuar në masën 89 %.

Problematikë në lidhje me mosrealizimin e marrjes së mostrave

- Mungesë stafi, në disa PIK-e Kakavije, Morinë punon vetëm një inspektor, gjë e cila e bën të pamundur realizimin e planit si dhe dërgimin e mostrave për analizim në laborator.
- Mungesë e reagentëve për kryerjen e analizave të mykotoksinave dhe aflatoksinave ne ISUV.
- Mungesë terrenesh për analiza mikrobiologjike për një periudhë 4 mujore.

- Në bashkëpunim me DRAKU janë realizuar procedurat për rastet e kthimeve në origjinë të eksporteve.
- Janë përgatitur dhe dërguar brenda afateve kthim përgjigjet për **64** kërkesat e ardhura nga operatoret e biznesit ushqimor nëpërmjet email zyrtar Info@aku.gov.al si dhe 6 kërkesa nga Koordinatori i të Drejtës së Informimit.

- Monitoron zbatimin e Projektit pilot SEED+ / CEFTA TRACES NT implementimin në sistem në korrik 2022 për import-eksport për bimë dhe produkte bimore, me qëllim lehtësimin e procedurat në PIK, duke përdorur sistemin online për lëshimin e aktit administrative të hyrjes për vendet CEFTA. Nëpërmjet përdorimit të këtij sistemi, lehtësohen edhe procedurat që kryejnë subjektet importuese pasi nuk do të dorëzojnë dokumentacionit në PIK për arsye se do të shfaqen në sistem në momentin që lëshohet nga autoriteti i vendit eksportues.
- Sektori ka hartuar program pune për verifikimin e ankesës në lidhje me futjen pa doganë të qumështit "Steriligarada" për kryerjen e kontrollit në PIK Durrës dhe Vlorë si dhe program pune në kuadër të festave të fundvitit për kryerjen e kontrollit në PIK nga ku ka rezultuar se:
- Janë miratuar **7** urdhra për kontrollin në Pikat e Inspektimit Kufitare konkretisht:

- Urdhra për kryerjen e kontrollit në PIK Durrës dhe Vlorë në lidhje me importet e kryera për qumështin Sterilgarada dhe nënproduktet e tij dhe **4** urdhra në zbatim të programit te punës në kuadër të festave të fundvitit për kryerjen e kontrollit në PIK Kapshticë, Qafë-Thanë, Hani i Hotit, Kakavije, Bllatë.
- Nga verifikimi i kryer rezultoi se **10** subjekte të cilat kishin importuar qumështin sterilgarada dhe nënprodukte të tij nuk i janë nënshtruar kontrollit veterinar në PIK, për **2** praktika certifikata veterinare në dokumentacion është fotokopje.
- Nga verifikimi i kryer në zbatim të programit te punës në kuadër të festave të fundvitit rezultoi se u kontrolluan **1 363** nga ku rezultoi se për 7 praktika certifikata veterinare në dokumentacion është fotokopje gjithashtu problematikë është mungesa e infrastrukturës lidhur me mospasjen e magazinave frigoriferike, freskuese, ambienti e cila vështirson kryerjen e kontrollit të identitetit dhe fizik të produkteve që importohen. Gjatë kohës së qëndrimit në këto PIK në prezencën e grupit të kontrollit për ngarkesat që u konstotuan problematika në lidhje me dokumentacionin që shoqëreronin ngarkesat dhe u krye bllokimi për **5** (pite, fruta, paleta druri, bersi soje, molto, bake rolls, kikirika, fara luledielli) ngarkesa deri në plotësim dokumentacioni dhe **1** (bersi soje) kthim në origjinë të ngarkesës.

Sektori ka propozuar ndryshime apo shtesa në aktet ligjore konkretisht:

- Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë",
- Ligjit nr. 105/2016 "Për Mbrojtjen e Bimëve";
- Hartimin e udhëzimit "Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së kontrollit zyrtar në doganën më të afërt jashtë PIK-ut dhe në doganën e vendit /pikës së destinacionit;
- Kërkesë për miratimin e doganave të brendshme;
- Sektori ka përgatitur raporte përkatëse sipas formatit të kërkuar për plotësimin e rekomnadimeve të Raportit të Progresit, Nën-Komitetit BE-Shqipëri për Bujqësinë dhe Peshkimin mbi veprimtarinë e kryer;
- Sektori ka qënë pjesë e takimeve dhe delegacionit për raportim për Open Balkan, CEFTA, Projekti SAFIAL, Banka Botrore.

3.4.2 PROBLEMATIKA

- Mungesa e Infrastrukturës në PIK;
- Mungesa e sistemit i cili do të automatizojë proceset e punës në PIK;
- Mungesa e reagentëve për analizimin e produkteve gjatë gjithë muajve të vitit.

3.4.3 REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM

- Fillimi i përdorimit i sistemit AKU-net i cili do të automatizojë proceset e punës së AKU-së, përfshirë këtu kryerjen e inspektimeve online, menaxhimin e gjobave, menaxhimin e laboratorëve të analizave i cili do të ndërthuret me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe atë të inventarizimit, etiketat, etj, si dhe kryerjen e kontrollit zyrtar në PIK online nëpërmjet këtij sistemi;
- Përmirësimi i infrastrukturës në PIK.

4 DREJTORIA E VLERËSIMIT TË RISKUT



4.1 SEKTORI I AKTIVITETIT SHKENCOR DHE KOMUNIKIMIT ME RASFF

Sektori i Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF, është pjesë e Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe ka në fokusin e punës Vlerësimin e Riskut nëpërmjet Komitetit Shkencor dhe Paneleve Shkencore të ngritura pranë AKU, si edhe komunikimin me sistemin e BE-së RASFF, me qëllim eleminimin e riskut të identifikuar dhe mbrojtjen e konsumatorit.

4.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Bazuar në detyrat funksionale të sektorit gjatë periudhës raportuese është menaxhuar sistemi RASFF dhe punuar për ngritjen e paneleve shkencore.

Objektivat:

- Menaxhimi i sistemit të informimit RASFF për të gjitha njoftimet apo alertet e ardhura dhe në mënyrë të ndërsjelltë për rastet e gjetura në tregun shqiptar;
- Njoftimi sipas afateve ligjore të Drejtorisë së Menaxhimit, Komunikimit dhe respektimi i komunikimeve zyrtare ndërinstitucionale;
- Adresimin e nevojave për mendim shkencor nga sektorët teknikë të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar, drejt Paneleve Shkencore, në funksion të forcimit të sigurisë ushqimore;
- Forcimin e bashkëpunimit me INFOSAN dhe shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me sigurinë ushqimore;
- Vijimin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Komunikimit të Riskut, në përgatitjen e materialeve informuese, me qëllim informimin e konsumatorit dhe OBU-ve, lidhur me sigurinë ushqimore dhe vlerat ushqyese.

Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, Shqipëria është njoftuar nga sistemi RASFF **48 (dyzetë e tetë)** herë. Këto njoftime i përkasin kategorive si vijon:

- 24 raste njoftimi ALERT;
- 7 raste Njoftim Informues për Ndjekje;
- 7 raste Njoftim Informues për Vëmendje;
- 10 raste Refuzim në Kufi.

Grafiku. 4 Njoftimet e ardhura nga RASFF për periudhën janar-dhjetor 2022



Gjithashtu 1 rast, i cili më pas është tërhequr nga Komisioni Evropian prej Dritares RASFF.

Njoftimet nga Shqipëria drejt RASFF:

Shqipëria ka njoftuar 7 (shtatë) herë me shkrim Sistemin RASFF dhe INFOSAN, për raste kur analizat e produkteve të importit kanë rezultuar jo-konforme (2 raste nga Kosova, 3 raste nga Greqia, 1 rast nga Ekuadori dhe 1 rast nga Italia).

Grafiku. 5 Njoftimet nga Shqipëria drejt RASFF për periudhën Janar-Dhjetor 2022



Nga analiza e bërë për vitin 2022, rezulton se:

32 njoftime janë me *risk Serioz* dhe i përkasin kryesisht kategorive të produkteve:

- fruta dhe perime (7 raste);
- kakao dhe preparate të kakaos, kafe dhe çaj (6 raste);
- akullore dhe ëmbëlsira (3 raste);
- qumësht dhe nënprodukte (3 raste).

11 njoftime janë me *risk të Papërcaktuar* dhe i përkasin kryesisht kategorive të produkteve:

- pije të ndryshme (alkoolike dhe jo alkoolike);
- Produkte të përpunuara, të gatshme;
- Bimë, erëza, fara, fruta të thata;
- Materiale në kontakt me ushqimin.

5 njoftime janë me *risk Jo Serioz* dhe i përkasin kryesisht kategorive të produkteve:

- Ushqime dietike, suplemente ushqimore dhe ushqime të fortifikuara;
- produkte të tjera ushqimore/ përzierje.

Për sa i takon gjendjes së produkteve, në totalin e 48 rasteve, rezultojnë:

- 17 raste produktesh të asgjësuara;
- 2 raste kthimesh në vendin e origjinës të produkteve;
- 5 raste masash administrative Gjobë, për mospërmbushje të kërkesave ligjore;
- 7 raste kur produkti është eksportuar i gjithi dhe nuk është shpërndarë në tregun vendas;
- 8 raste kur produkti është shpërndarë, përpara njoftimit nga RASFF;
- 6 raste kur produkti nuk ka hyrë në Republikën e Shqipërisë;

- 1 rast, produkti është i bllokuar dhe pritet kërkesa e kompanisë për asgjësim;
- 2 raste janë ndjekur nga ISHMT.

Referuar vitit 2022 dhe duke e krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2021, vihet re se kemi një rritje të numrit të njoftimeve të ardhura nga RASFF.

Gjatë vitit 2021, Shqipëria është njoftuar nga sistemi RASFF 43 (dyzetë e tri) herë. Këto njoftime i përkasin kategorive si vijon:

- ✓ 31 raste njoftimi ALERT;
- ✓ 7 raste Njoftim për Refuzim në Kufi;
- ✓ 3 raste Njoftim për vëmendje;
- ✓ 2 raste Njoftim Informues për Ndjekje.

Rezultatet e kontrollit zyrtar për secilin rast i janë njoftuar sistemit RASFF, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Njoftimet nga Shqipëria drejt RASFF:

Shqipëria ka njoftuar 3 (tre) herë me shkrim Sistemin RASFF dhe INFOSAN, për raste kur analizat e produkteve të importit kanë rezultuar jo-konforme. Këto 3 raste, i përkasin produkteve fruta & perime të importuara nga Greqia.

Sektori i Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF është angazhuar në rishikimin e Rregullores së Brendshme të RASFF, duke konkluduar Urdhrin e DP Nr. 1199/1, datë 11.11.2022 "Për miratimin e rregullores për procedurën e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFF". Ndryshime të cilat u panë të nevojshme për mbarëvajtjen e punës dhe për të rregulluar aspekte të punës së përditshme, të cilat nuk përfshiheshin në urdhrin e mëparshëm.

Komiteti Shkencor dhe Panelet Shkencore

Gjithashtu, në lidhje me riaktivizimin e Paneleve Shkencore, Sektori i ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm Manualin Operacional të funksionimit të Paneleve dhe ka nisur axhendën për mbledhjen e parë të Paneleve Shkencore.

4.1.2 PROBLEMATIKA

- Vonesa në procesin e hetimit dhe konkluzione pa vendimmarrje, në lidhje me njoftimet e ardhura nga Sistemi RASFF.

4.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM:

- Evidentimi i problematikave nga drejtoritë e AKU për të inicuar mbledhjen e Paneleve Shkencore në funksion të sigurinë ushqimore;

- Forcimin e bashkëpunimit me INFOSAN dhe shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me sigurinë ushqimore.

Në ***ANEKSIN nr.2*** do të gjeni:

Tabela 1- Përmbledhje e rasteve të ardhura nga RASFF 2022.

Tabela 2- Njoftimet në sitemin RASFF për periudhën Janar-Dhjetor 2022.

Tabela 3- Njoftimet e kryera nga Shqipëria në sitemin RASFF për periudhën Janar- Dhjetor 2022.

4.2 SEKTORI I KOORDINIMIT TË SHËRBIMIT LABORATORIK

Sektori i Koordinimit të shërbimit laboratorik, kontrollon, koordinon dhe mbështet aktivitetin laboratorik, si dhe kontrollon procedurat dhe dokumentacionin e Sektorëve të Shërbimeve Laboratorike të AKU-së bazuar në legjislacionin në fuqi.

4.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Tabela 17. Struktura aktuale e laboratorëve

Struktura e laboratorëve	Tiranë	Durrës	Fier	Vlorë	Gjirokastër	Korçë	Shkodër
Laboratori i sigurisë ushqimore	x	x	x	x	x	x	x
Laboratori i shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve		x	x	x	x	x	x
Laboratori i mbrojtjes së bimëve		x				x	x

Llojet e analizave që kryhen në çdo laborator janë si më poshtë:

- Laboratori Kimiko-Fizik kryhen analiza në lidhje me treguesit cilësorë të produkteve ushqimore shtazore dhe jo shtazore, tregues të etiketimit, si dhe disa tregues analitik të sigurisë ushqimore.
- Laboratori Mikrobiologjik kryhen analiza në lidhje me kriteret sigurisë së produkteve ushqimore dhe ato të proceseve të higjienës.
- Laboratori i Shëndetit dhe Mirëqënies së Kafshëve kryhen analiza për diagnostikimin e sëmundjeve dhe parazitëve të ndryshëm në kafshë.
- Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve kryhen analiza për diagnostikimin e dëmtuesve dhe parazitëve në bimë dhe produkte bimore.

Përsa i përket aktiviteteve që një laborator nuk mund të kryej, mostrat adresohen në laboratorë të tjerë të AKU, apo në laboratorë të tjerë Reference, ose laboratorë të tjerë brenda dhe jashtë vendit të akredituar.

Objektivat :

- Të rrisë nivelin profesional të punonjësve me qëllim rritjen e cilësisë së veprimtarisë së AKU-së dhe trajnim i vazhdueshëm i punonjësve;
- Të rrisë efektivitetin e punës së laboratorëve të AKU-së në fushën e sigurisë ushqimore;

- Të planifikojë dhe menaxhojë terrenet për përdorimin e tyre me efektivitet të plotë;
- Përgatitjen e Manualit të Menaxhimit të Cilësisë.

Detyrat:

- Mbajti lidhje me laboratorin e referencës ISUV në mbështetje të aktivitetit inspektues të AKU, si dhe shkëmbeu informacion të shpejtë me institucionet e linjës në rastet e jokonformitetit duke bërë të mundur identifikimin dhe marrjen e masave për produktet që cënojnë sigurinë ushqimore, po ashtu dhe për diagnozën e kafshëve;
- Komunikoi, raportoi në mënyrë të vazhdueshme dhe specifike mbi kryerjen e aktiviteve që mbulojnë të gjitha aspektet dhe veprimet e Sektorit, tek Drejtorit i Përgjithshëm i AKU, Drejtori i Vlerësimit të Riksut, MBZHR dhe çdo subjekti tjetër ligjërisht të interesuar;
- Kontribuoi në draftimin e "Planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe plani i marrjes së mostrave në PIK për vitin 2023" ku pjesë janë edhe kërkesave buxhetore per realizimin e tij nga laboratorët;
- Bashkëpunoi me projektin Irlandez "The food safety project", me ekspert të projektit SAFIAL, si dhe për aplikime për projekte të tjera;
- Përgatiti një dokument udhëzues për operatorët e biznesit mbi përputhshmërinë sa trajtuar në legjislacion -në bashkëpunim me projektin për sigurinë ushqimore;
- Raportoi në EFSA "Members and observers of the scientific network for zoonoses monitoring data" prevalencen agjentët zoonotik analizuar në laboratorët AKU;
- Koordinoi punën për kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar brenda dhe jashtë vendit;
- Kontrolloi lidhur me higjienën në laboratorë, zbatim i praktikave të mira të punës;
- Realizoi unifikimin e metodave dhe trajnim të stafit, si dhe kryerjen e testeve ndërlaboratorike nga referenca;
- Realizoi unifikimin e metodave dhe trajnim të stafit, si dhe kryerjen e testeve ndërlaboratorike nga referenca, për të cilat u realizua trajnimi në sektorin e shërbimit laboratorik mikrobiologjik, Durrës dhe në sektorin e shërbimit laboratorik shëndet dhe mirëqënie kafshësh në Korçë, nuk pati avancim për trajnim ne laboratorin fiziko kimik;
- Kontribues në grupin ndërinstitucional të punës për hartimin e "Udhëzuesit të përbashkët për hetimin e shpërthimeve me origjinë nga uji dhe ushqimi" dhe "Dokumentit strategjik për shpërthimin e informacionit në rastet e dhe shpërthimeve me natyrë hidrike dhe ushqimore";
- Aktualisht pjesë në formulimin e manualeve te procedurave inspektuese dhe të marrjes së mostrave sipas urdhrave specifikë të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Kreu trajnime në Gjirokastër në bashkëpunim me ISUV dhe Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike TC IAEA për stafin e sektorëve të Shërbimit laboratorik të AKU-së (shëndet dhe mirëqënie kafshës) për sëmundje të rëndësishme si ato zoonotike si bruceloza, infeksionet klistridiale, enteretoksemia, sëmundjet protozoale dhe parazitare;
- Organizim testesh midis Laboratorëve mikrobiologjik dhe fiziko kimik të AKU (dështim prokurimi për vitin 2022);

- Propozim për përmirësim të kuadrit ligjor (unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve), realizuar pjesërisht vetëm në ndryshimin e formateve të nënshkrimit të raport analizave.

Arritjet:

- Përmirësim infrastrukturor dhe funksional në facilitete në sektorin e shërbimit laboratorik Durrës, në bashkëpunim me projektin SAFIAL ("Forcimi institucional i Ministrisë së bujqësisë për menaxhimin e sigurisë ushqimore" financuar nga Korperacini Italian dhe implementohet nga CIHEAM Bari);
- Ka përgatitur materiale serioze për Projeketin e Bankës Botërore ku AKU do të jetë përfitues i fondeve për rikonstruksionin dhe blerjen e pajisjeve të nevojshme për laboratorët bazuar në profilizimin e tyre;
- Funksionaliteti i labortorit të mbrojtjes së bimëvë në sektorin e shërbimit laboratorik Korçë dhe Durrës;
- Bashkëpunim me komaninë dhe AKLSH-in për futjen e sistemit LIMS - Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik në sistemin AKU-net;
- Koordinimin e punës mes DRAKU-ve dhe stafit të laboratorit për mbajtjen në aktivitet të veprimtarisë së laboratorëve duke ezauruar në kohë dhe brënda afatit terrenet dhe reagentët;
- Menaxhimi i lëvizjeve të stafit të laboratorëve sipas nevojës duke siguruar vazhdimësinë e punës.

Për vitit 2022 në total kanë qenë të planifikuara për efekt kontrolli zyrtar 12 478 mostra janë analizuar 8 672 mostra (69% të planifikimit) sipas tabeles me poshte:

Tabela 18. Përmbledhëse e realizimit të mostrave

Laboratorët	Terren		PIK		MBIB		TOTAL	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
AKU	7,075	3,703	2,278	2,162	32	44	9,385	5,909
ISUV	2,416	2,283	209	91	73	45	2,698	2,419
ESHFF					166	162	166	162
QTTB					144	147	144	147
DSHP	85	35					85	35
TOTALI	**9,576**	**6,021**	**2,487**	**2,253**	**415**	**398**	**12,478**	**8,672**
Realizimi në %	**63%**		**89%**		**96%**		**69%**	

Për vitit 2022 në total kanë qenë të planifikuara për efekt kontrolli zyrtar 9 385 mostra për analizim në Laboratorët e AKU, dhe janë analizuar 5 909 mostra (63% të planifikimit).

Tabela 199. Plani dhe realizimi i analizimit të mostrave në laboratorët e AKU-së për efekt kontrolli zyrtar

Laboratoret AKU viti 2022	Terren								PIK								terren		PIK		Plani ne total	Fakti ke realizuar ne total	% realizuar
	Sek. OSH Fiziko-kimike		Sek. OSH mikrobiologjike		Sek. OJSH Fiziko-kimike		Sek.OJSH mikrobiologjike		Sek.OSH Fiziko-kimike		Sek.OSH mikrobiologjike		Sek. OJSH Fiziko-kimike		Sek.OJSH mikrobiologjike		Sek. MBIB		Sek. MBIB				
	P	F	P	F	P	F	P	F	P	F	P	F	P	F	P	F	P	F	P	F			
Tiranë	193	269	832	174	373	503	176	47	0	0	0	0	0	0	0	0	4	6	0	0	**1578**	**999**	**63**
Durrës	29	9	113	40	225	198	40	11	0	0	6	4	847	854	12	4	3	5	12	21	**1287**	**1146**	**89**
Berat	209	59	375	82	207	108	84	4	0	0	0	0	0	0	0	0	3	5	0	0	**878**	**258**	**29**
Shkodër	51	48	273	109	130	140	20	0	0	0	56	10	138	102	0	0	0	2	0	13	**668**	**424**	**63.5**
Vlorë	24	21	110	23	99	74	14	0	2	2	10	7	54	46	0	0	1	1	1	2	**315**	**176**	**55**
Fier	124	51	404	86	161	142	65	26	0	0	0	0	0	0	0	0	3	3	0	0	**757**	**308**	**40**
Dibër*	25	33	54	9	60	49	5	0	1	0	0	0	9	7	0	0	2	0		3	**156**	**101**	**65**
Elbasan*	68	4	231	64	88	75	17	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	7	0	0	**409**	**150**	**36**
Korçë	102	159	568	145	257	249	7	0	79	125	58	4	597	588	1	0	5	11	12	17	**1686**	**1298**	**77**
Lezhë*	102	24	201	43	159	135	27	4	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	**491**	**206**	**42**
Gjirokastër	37	11	431	151	240	300	21	0	0	0	74	35	268	292	0	0	2	4	0	0	**1073**	**793**	**73**
Kukës*	0	0	20	0	24	24	0	0	0	0	0	0	37	22	0	0	2	0	4	4	**87**	**50**	**57**
TOTALI	**964**	**688**	**3612**	**926**	**2023**	**1997**	**476**	**92**	**82**	**127**	**204**	**60**	**1950**	**1911**	**13**	**4**	**32**	**44**	**29**	**60**	**9385**	**5909**	**63**

Shënim: Plani= P, Fakti=F

Nga të dhënat e raportuara nga Sektorët e Shërbimeve laboratorike për mostra të dërguara nga DRAKU gjatë vitit 2022, vlerësojmë se:

- me performancën më të mirë në zbatimin e planit mbi 80 - 90% paraqitet DRAKU Durrës;

- me performancë mesatare në zbatimin e planit në masën 55-70 % paraqiten DRAKU Dibër, Korçë, Tiranë, Shkodër, Gjirokastër, Kukës, Vlorë;

- me performancë më të ulët në zbatimin e planit nën 50% paraqiten DRAKU Elbasan, Fier, Berat, Lezhë.

Nga analiza e mosrealizimit të marrjes së mostrave ka arsye objektive por edhe subjektive.

Si arsye ***objektive*** vlerësojmë se laboratorët kanë qëndruar pa terrene gati 4-5 muaj si rezultat i procedurave të tejzgjatura të prokurimit. I gjithë procesi ka ndjekur rregullat e prokurimit ku ankimimet e subjekteve kanë zgjatur procesin e shpalljes së fituesit

Si arsye ***subjektive*** vlerësojmë se megjithëse se ka pasur terrene të trashëguara nga plani i vitit 2021 për qumësht lëndë të parë, qarqet nuk kanë marrë mostra. Gjithashtu, mbas furnizimit me terrene qarqet nuk marrin mostrat e muajve të mëparshëm të parealizuar, megjithëse laboratorët

njoftojnë me email zyrtare. Për këtë DRAKU nuk ka asnjë pengesë objektive për marrjen e mostrave të prapambetura, mbasi në planin zyrtar të miratuar marrja e mostrave në terren nuk përcakton emrin e subjektit ku merret mostra por vetëm matricën dhe treguesit analitik për produkte që janë në treg gjatë gjithë vitit.

Tabela 20. Aktiviteti laboratorik Janar- Dhjetor 2022 nga sektorët e Shërbimeve Laboratorike AKU

Laboratori Viti 2022	Sherbimet Laboratorike								Origjina e Mostrave			Total		Jokonformiteti	Problematika
	Fiziko-Kimike		Mikrobiologjike		Shendeti i Kafsheve		Mbrojtje e Bimeve		Kontroll Zyrtar ne:		Autokontroll				
	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	PIK	Terren		Mostra	Analiza		
Tiranë	907	1852	230	230	0	0	0	0	29	1108	0	1137	2082	3	Përmbajtja e nitriteve në prodhim mishi "suxhuk", në kremviçe, Insekte e dëmtues në "Miell gruri"
Durrës	1140	3300	123	147	0	0	154	154	901	516	0	1417	3601	3	NPM enterobaktere, E.Coli, kalbezimi I qafes se kercelli ne laker
Shkodër	450	1291	165	208	0	0	0	0	112	503	0	615	1499	2	2 mostra qumësht i papërpunuar (NPM)
Vlore	143	418	30	36	0	0	0	0	55	118	0	173	454	3	3 E.Coli
Fier	360	847	198	249	0	0	0	0	0	558	0	558	1096	4	4 mostër qumësht i papërpunuar (NPM)
Korcë	1117	1932	151	172	63	63	42	42	734	564	61	1359	2195	72	61 Mastit Stafilokok, 1 Enterotoksemi, 7 analiza qumësht i papërpunuar (NPM), 3 analiza qumësht i papërpunuar (QS)
Gjirokastër	603	1627	186	282	0	0	0	0	329	460	0	789	1909	0	
TOTAL	**4720**	**11267**	**1083**	**1324**	**63**	**63**	**196**	**196**	**2160**	**3827**	**61**	**6062**	**12850**	**87**	

Për vitin 2022 në Sektorët e Shërbimeve laboratorike janë pranuar në total 6 062 mostra dhe analizuar për 12 850 tregues analitikë (fiziko-kimik,mikrobiologjik, shëndet dhe mirëqënie kafshës dhe mbrojtje bimësh).

Shënim: në aktivitetin e përgjithshëm laboratorik janë përfshirë 153 mostra të cilat kanë ardhur nga AKVM, autokontrolli në shëndetin dhe mirëqënien e kafshëve si dhe mostra të planifikuara për analizim në ISUV për pastërti fitosanitare por për arsye mos realizimi në ISUV janë analizuar në Laboratorët e AKU.

Për vitin 2022, nga mostrat e marra në terren nga inspektorët tanë në total rezultojnë 173 jokonformitete:

- 62 në Sektorin e Shërbimit Laboratorik Korçë (diagnoza)
- 25 nga Sektorët e Shërbimeve Laboratorike AKU (siguria usqhimore)
- 86 nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (54 mbetje pesticide)

Statusi i pajisjeve Loti 1, të përfituara nga Projekti IPA "Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri" (Contract No. AL/IPA2013/04) për **Sektorët e Shërbimeve Laboratorike Korçë, Shkodër dhe Gjirokastër**, me qëllim adresimin e çështjes së axhustimit të pajisjeve kreu rigrupin e pajisjeve duke parashtruar sa më poshtë:

Në Gjirokastër ndodhen t**ë tre pajisjet NIR SpectraAlyzer Grain,** të cilat analizojnë miellin dhe drithin kokërr, janë skanuar respektivisht 125 mostra për çdo aparature, prej të cilave 28 grure kokërr dhe 97 miell.

- **Në Korcë Spectra Analyzer Wine and Spirits,** ka vijuar puna me procedurën e axhustimit e aparaturave për rritjen e saktesisë në matje, për produktet; Birrë, Verë, Uthull dhe Raki (Rakia-Kalibrim i ri). Në total janë 362 skanime në të tre aparaturat. Vlen të përmendet fakti se kemi një afërsi të rezultatit me atë të metodës klasike, për të cilën nevojiten mostra reference me qëllim përfundimin e procesit të axhustimit. Kërkesa për blerjen e mostrave të referencës u adresua për Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme e cila për arsye objektive nuk u realizua në vitin 2022, dhe kjo kërkesë do të prësëritet për vitin 2023.
- **Shkodër ndodhen** t**ë tre pajisjet NIR Multiparametric Food,** të cilat analizojnë ushqim për fëmijë, vaj ulliri, miell, etj., ku janë skanuar respektivisht 168 mostra për Shkodrën, 179 mostra për Korçën dhe 238 mostra për Gjirokastrën.

Tabela 21. Tabela e axhustimeve

Spectra Alyzer Wine& spirits e:	KORCE skanime per axhustim/matje per tre aparatura Ko, Shk, Gjr (Prill - Maj-Qesrhor-vijim 2022)							Totali
	Birre axhustuar	Vera axhustuar	Uthull axhustuar	Brandi	Konjak	Rakia (kailbrim i ri)	Liker (kalibrim i ri)	
Korces	42	46	33	21	1	39	20	202
Shkodres	20	20	21	0	0	20	0	81
Gjirokastres	18	21	21	0	0	19	0	79
Totali	**80**	**87**	**75**	**21**	**1**	**78**	**20**	**362**

Investime 2022 dhe në vazhdim:

Krahas Projektit SAFIAL, AKU parashikohet të përfitoj fonde investimi nga Projekti i Bankës Botërore. Për këtë qëllim sektori ka qenë pjesë aktive e diskutimeve dhe materialeve të përgatitura. Nën asistencën e ekspertit të bankës botërore kemi përgatitur nevojat e AKU-së për profilizimin e laboratorëve, pajisje laboratorike, metodat referuese dhe fonde për rikonstruksionin e 7 laboratorëve.

Ligjërisht referuar përmbushjes së kushteve të përcaktuara në praktikat e mira laboratorike, sipas parimeve të përcaktuara nga OECD-ja dhe legjislacioni i BE-së, rëndësisë së zhvillimit që duhet të ndërmarrin laboratorët e AKU për të qenë eficentë dhe kompetentë, vendosjes në ndërtesa moderne që kërkojnë modifikim, hapësirave të mjaftueshme për të rritur kapacitetin e testimit dhe për të akomoduar më shumë pajisje dhe personel, investimi do të japë frutet e tij.

Me profilizimin e laboratorëve dhe me investimet synohet:

- ❖ Rritje e nivelit të kontrollit të sigurisë ushqimore, e kapaciteteve laboratorike dhe zgjerim të gamës së analizave për mostrat e marra gjatë kontrolleve zyrtare;
- ❖ Të jetë i akredituar sipas ISO 17025 për testet individuale ose grupin e testeve që do të përdorë për qëllime kontrolli zyrtar. Fushëveprimi i akreditimit duhet të jetë i përshtatshëm për funksionimin e tij si laborator zyrtar;
- ❖ Të përdorin metoda zyrtare të analizës në përputhje me direktivat e BE-së.

Të gjitha kontrollet zyrtare do të ofrohen gradualisht nga Sektorët e Shërbimeve Laboratorike të AKU, si dhe do të shërbehet në zbatim të praktikave të vetëkontrollit nga Operatorët e Biznesit Ushqimor.

4.2.2 PROBLEMATIKA

- Plotësimi i vendeve vakante në laboratorë sipas profesioneve të kërkuara;
- Problematikë në infrastrukturën e rrjetit laboratoriksi dhe buxhet financiar jo i plotë me kërkesat;
- Procedura e prokurimit për terrene dhe reagentë e tejzgjatur, duke bllokuar punën në laboratorë për 3- 6 muaj për rrjedhojë DRAKU nuk i përgjigjet kërkeses në kohë duke mos mbartur nga muaji në muaj dërgimin e mostrave për analizimi, dhe duhet që sektorët e shërbimeve laboratorike të bëjnë rikujtesa për skadencat e terreneve me qëllim ezaurimin e tyre në kohë.
- Mos kryerja e testeve ndërlaboratorike dhe trajnim i stafit të AKU, detyrë kjo funksionale e ISUV si dhe nevoja për rishikimin e metodikave STASH me ato ISO (laboratori Fiziko kimik)
- Mosfunksionim i plotë i laboratorëve të shëndetit të kafshëve (Mungesa e mostrave diagnozës nga Agjencitë Rajonale të AKVMB, si dhe mungesë informacioni rreth planifikimit të mostrave për laboratorët e Shëndetit dhe Mirëqënies së Kafshëve të AKU) dhe mbrojtjes së bimëve (ky i fundit në sektorin e shërbimit laboratorik Shkodër)
- Sektori i shërbimit Shkodër dhe Gjirokastër nuk kanë mundur të vijojnë me procedurën e axhustimit të pajisjeve NIR për arsye së në Gjirokaster ka vështirësi me instalimin e programit përkatës pasi është djegur kompjuteri dhe Shkodra ka nevojë për asistencë sa lidhet me mënyrën e axhustimit.

4.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM:

- Të menaxhohen më mirë burimet njerëzore në laboratorë dhe të plotësohen në kohë reale sipas profesioneve të kërkuar për realizimin e misionit;
- Furnizimi me terrene dhe mostra të bëhet me marrëveshje kuadër, dy apo tri vjeçare për të siguruar vazhdimësinë e punës;
- Monitorim mujor i planit dhe më shumë kërkesë llogarie për DRAKU që nuk marrin mostra;

- Sektori i financës të parashikojë fond për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe fond emergjence për problematika në laboratore, ku ky i fundit të jetë në dispozicion të AKU qendër.
- Për të gjitha analizat e veçanta sipas parashikimit në plan, të cilat nuk mund të kryhen në laboratorët e kontrollit zyrtar AKU, ISUV apo tjetër të akredituar brenda vendit, mostrat duhet të dërgohen jashtë. Rast pas rasti, përpara se të marrë mostër DRAKU duhet të rakordojë me Drejtorinë e Përgjithshme për të siguruar kryerjen në laborator të akredituar.

Në ANEKSIN nr.2 do të gjeni:

Tabela 1- Jokonformite nga Sektorët e Shërbimeve Laboratorike AKU (Siguria usqhimore)

Tabela 2- Jokonformite nga Sektorët e Shërbimeve Laboratorike AKU (Diagnoza).

Tabela 3- Jokonformitet nga Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarisë.

Tabela 4-Tabela aktiviteti laboratoreve Janar- Dhjetor 2022.

4.3 SEKTORI I VLERËSIMIT TË RISKUT DHE STATISTIKAVE

Sektori organizon punën për hartimin e planit vjetor kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, në terren dhe PIK si dhe përgatit raporte periodike statistikore.

4.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Harton planin vjetor kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqhmin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK;
- Kryen procesin e vlerësimit të riskut nëpërmjet analizimit të të dhënave të inspektimeve nga DRAKU, monitorimit të risqeve në zhvillim, kryerjes së vlerësimeve të shpejta të riskut për të mbështetur menaxhimin e incidenteve;
- Krijon dhe mban regjistrin e riskut që përfshin llojet e riskut me origjinë ushqimore, të cilat mund të rrezikojnë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, shëndetin e njerëzve e që nuk mund të eliminohen apo reduktohen deri në një nivel të pranueshëm, procedurat praktike thelbësore për trajtimin e riskut, si dhe masat përkatëse për menaxhimin e tij;
- Gjeneron statistika të reja periodike tre-mujore, gjashtë-mujore dhe vjetore, si dhe analiza të statistikave krahasimore me bazë periudhash një-vjeçare, tre-vjeçare dhe pesë-vjeçare;
- Bashkëpunon me të gjithë sektorët, drejtoritë dhe drejtoritë rajonale për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të nevojshme për procesin e vlerësimit të riskut;
- Përgatit raporte periodike mujore ose të veçanta për të dhënat statistikore të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të AKU, problematikat e evidentuara dhe duke informuar eprorët për treguesit statistikore.

Detyrat:

Në zbatim të detyrave funksionale që ka sektori i Vlerësimit te Riskut dhe Statistikave gjatë vitit 2022 ka realizuar:

- Hartimin e Planit Vjetor të Kontrolleve Zyrtare me Bazë Risku dhe marrjes së mostrave për vitin 2023. Me qëllim përmirësimin e metodologjisë për përcaktimin e frekuencës së kontrolleve për secilin subjekt me asistencë të projektit "Mbështjetje për Sigurinë Ushqimore, Standardet Veterinare dhe Fitosanitare në Shqipëri", është hartuar dhe miratuar Metodologjia e Profilizimit të Riskut të Operatorëve të Bisnesit Ushqimorë e cila po përdoret për hartimin e Planit Kombëtar të bazuar në risk për vitin 2023. Në bazë të kësaj metodologjie, ka përfunduar procesi i vlerësimit të riskut për operatorët e biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, si dhe planifikimi i tyre për kryerjen e kontrolleve zyrtare të bazuara në risk për vitin 2023. Frekuenca vjetore e inspektimeve për çdo OBU, do të llogaritet në bazë të kategorizimit të riskut;
- Përgatitjen e raporteve statistikore periodike (ditore, javore, mujore) në lidhje me të gjithë aktivitetin e kontrolleve zyrtare të realizuara nga AKU. Këto raporte janë përgatitur nga përpunimi i informacioneve frekuente të derguara elektronikisht nga çdo DRAKU. Raportet periodike statistikore japin të dhëna të detajuara në lidhje me kontrollet zyrtare të ushtruara në terren, PIK si dhe aktivitetin laboratorik; Krijuar regjistrin e riskut.
- Është kryer unifikimi i tabelave për raportimin e informacioneve nga ana e Drejtorive Rajonale. Janë dërguar formatet dhe janë trajnuar në vazhdimësi koordinatorët që kryejnë raportimet ditore. Është planifikuar të kryhet trajnim online në fillim Janarit i të gjithë koordinatorëvë që raportojnë informacionet e terrenit dhe inspektorët e PIK-ve;
- Në muajin Tetor janë kryer akt-rakordimet me çdo DRAKU me qëllim saktësimin e të dhënave të dërguara për periudhën Janar-Tetor, e më pas në muajt në vazhdim është ndjekur e njëjta procedurë;
- Në lidhje me të dhënat e dërguara për inspektimet në PIK, nga ana sektorit janë kodifikuar produktet, janë ndarë sipas kategorive e njësive përkatëse dhe janë nxjerrë sasitë totale të importuara për vitin 2022;
- Janë përgatitur raporte mujore ose të veçanta për të dhënat statistikore të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të AKU-së, problematikat e evidentuara janë kthyer për saktësim koordinatorëve që kanë raportuar;
- Është monitoruar realizimi i Planit të Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve për periudhën tetor 2022-dhjetor 2023, janë evidentuar problematikat në realizim, janë përgatitur memot përkatëse dhe janë njoftuar eprorët;
- Është krijuar një database me të dhëna statistikore dhe është kryer shpërndarja e tyre sipas kërkesave specicifike që kanë pasur sektorët e tjerë;
- Në kuadër të bashkpunimit ndërinstitucional sektori gjatë vitit 2022 si dhe hartimit te Planit Vjetor të kontrolleve me bazë risku ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Duhanit dhe Cigareve në lidhje me saktësimin e listës së operatorëve të biznesit që operojnë në fushën e ushqimit si dhe prodhimit e përpunimit të duhanit dhe produkteve të tij.

Viti 2022 u karakterizua nga një ulje e numrit të inspektimeve në rang kombëtar krahasuar me inspektimet e realizuara ne vitin 2021 me 1.5% por ka rritje të numrit të inspektimeve në terren

me 9 %. AKU gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 realizoi **gjithsej 101 535 inspektime** nga të cilat 32 763 inspektime në terren si dhe **68 772 inspektime në Pikat e Inspektimit Kufitar**. Kontrollet zyrtare të realizuara në terren konsistojnë në 27 009 të programuara sipas planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe 5 664 të paprogramuara . Në nivel kombëtar rezulton që **plani vjetor i inspektimeve eshtë realizuar në masën 83 %.**

Inspektimet e paprogramuara janë realizuar në kuadër ri kontrolleve për detyrat e lëna, pjesëmarrjes aktive të qytetarëve për të raportuar raste të shkeljes së normave të sigurisë ushqimore nga operatorë të ndryshëm, kërkesat për licencim, planet e monitorimit për produkte apo grup produktesh që kanë rezultuar me risk te lartë, Urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm, njoftimet e RASFF, etj.

Për OBU të cilët nuk kanë plotësuar standardet ushqimore të parashikuara në legjislacionin në fuqi janë vendosur masat administrative përkatëse përkatësisht:

- Paralajmërime 4 959
- Gjoba në nr. 471 me vlerë 76 170 000 lekë.
- Ndërprerje aktiviteti 67.
- Bllokim produkti janë 333 raste me sasi: 413tonë, 961 730 litra, 2 644 152 kokrra vezë dhe 133 copë suplemente.
- Asgjësim produkti janë 185 raste me sasi: 2 456tonë, 2 671 236 litra, 569 843 kokrra vezë dhe 231 750 copë paketa.
- Kthim në vendin e origjinës 32 ngarkesa me sasi 442 tonë.

Vlen për t'u theksuar fakti që gjatë vitit 2022 ka rritje të vlerave të masave administrative dhe kryesisht të numrit të gjobave krahasuar me vitin 2021 nga 246 në 471.

Tabela 22. Inspektimet e kryera në terren për vitet 2021-2022

Periudha	Inspektime te realizuara	Paralajmërim	Gjoba		Bllokim					Asgjësim Produkti					Nderpreje Aktiviteti
			Nr.	Vlerë('000 lekë)	Raste *(nr)*	Sasia (ton)	Sasia (Litra)	Sasia (Kokrra veze)	Sasia cope	Raste *(nr)*	Sasia (ton)	Sasia (Litra)	Sasia (Kokrra veze)	Sasia cope (paketa)	
Janar-Dhjetor 2021	30 056	6 368	246	35 770	284	369.7	41 581.8	824	0	168	6 385.9	11 557.8	570	0	29
Janar-Dhjetor 2022	32 763	4 959	471	76 170	333	412.4	961 730	2 644 152	133	185	2 456.15	2 671 236	569 843	231 750	67

Grafiku. 6 Të dhëna mbi inspektimet e kryera në terren për vitet 2021-2022



Vihet re se inspektimet në PIK janë ulur në krahasim me vitin 2021 me 6% por ka rritje te inspektimeve në terren me 9 %. Ulja e numrit të inspektimeve ka ardhur si rezultat i uljes me 6% të importeve krahasuar me vitin 2021.

Tabela 23. Inspektimet e kryera në PIK për vitet 2021-2022.

Viti	Nr.Inspektimeve në total	Produktet me origjinë joshtazore	Produktet me origjinë shtazore	Kafshë të gjalla	Produkt/ Material veterinar	Bimë dhe produkte bimore	Material Mbjellës dhe Shumëzues Bimor	Plehra për Përdorim për Bimësinë	Produkte të mbrojtjes së bimëve	Makineri bujqësore të përdorura
Janar-Dhjetor 2021	73 912	35 921	14 153	2 083	204	18 636	929	1 789	197	0
Janar-Dhjetor 2022	68 772	34 541	15 073	2 295	197	13 836	916	1 475	158	281

Grafiku. 7 I nspektimet e kryera në PIK për vitet 2021-2022



Sektori i statistikave gjatë 3 mujorit të fundit të vitit ka punuar me përkushtim dhe me një ngarkesë të lartë pune në drejtim të:

- Standardizimit të regjistrave OSH, OJSH, MBIB të inspektimeve në PIK, duke krijuar raporte të standardizuara sipas produkteve, volumeve të hyra me njësi matëse të veçanta;
- Standardizimi i regjistarve të inspektimeve, gjobave, asgjësimeve, masave administrative në terren;
- Standardizimi i raporteve ditore të koordinatorëve rajonalë dhe inspektorëve në PIK;
- Përpilimi i akt rakordimeve mujore, çdo datë 2 të muajit pasardhës midis koordinatorëve në DRAKU, sektorit të statistikave dhe sektorëve të Drejtorisë së Menaxhimit;

Si rezultat i përmirësimeve të mësipërme, gjeni në vijim detajime të importeve sipas grup produkteve.

Tabela 24. Sasitë e importuara në PIK për produktet me origjinë-shtazore

Kategoritë specifike	Sasia (tonë)	Sasia (Copë)	Sasia (Krerë Shpendë)	Sasia (Krerë Kafshë e Gjallë)	Sasia (Kokrra)	Sasia (Dozë)
Kafshë të Gjalla	0	4	0	203 495	0	0
Lëkurë	679	0	0	0	0	0
Amfibe Bretkosa te gjalla, kembe bretkose	62	0	0	0	0	0
Shpendë/ Zogj	0	0	9 388 101	0	0	0
Kokrra Vezë (konsum dhe inkubim) si dhe nr i vezëve të marra nga supermarketet	0	0	0	0	33 719 406	0
Rasat Peshku/vezë peshku/ushqim peshku /insekte të gjalla/ krimba/ peshq dekorativ/ kërmij	15 408	39 642 710	0	0	0	0
PMV/ vaksina (LENDE E PARE PER PRODH.E MED.VET.)	205	0	0	0	0	0
Peshk dhe Nënproduktet e tij (Prodhime Deti/fruta deti)	32 836	0	0	0	0	0
Mish dhe Nënproduktet e tij	47 903	0	0	0	0	0
Qumësht dhe Nënproduktet e tij	28 324	0	0	0	0	0
Ushqim për Kafshë (Koncentrat)/ nënprodukte kafshësh për përpunim/ produkte me origjinë shtazore për kafshë	19 369	0	0	0	0	0
Ushqim për beba/ Pregatitje Ushqimore **për fëmijë**	334	0	0	0	0	0
Pregatitje Ushqimore/ produktet e përbëra/ vezë e lëngshme/ krem pasticerie/ produkte fastfoodi/ pije e homogjenizuar	4 309	0	0	0	0	0
Mjaltë/ Bletë/ ushqim për bletë/ fletë dylli/ premixe për bletë	898	208 580	0	0	0	0
Produkte Supermarketi/ produkte të ndryshme për konsum (majonez, pana, supra, produkte me origjin shtazore.)	7 803	0	0	0	0	0
Zorrë/ Produkte për Sallameri/ nënprodukte shtazore për përpunim	4 367	0	0	0	0	0
Aditivë/ Suplemente/ enzima/ proteina/ kazein qumështi/ yndyrë qumështi, protein qumeshti, xhelatine vici **për njerëz**	504	0	0	0	0	0
Aditivë/ Suplemente/ enzima/ proteina/ material biologjik (doze)/ insekte biologjike/ premix /dezifektant për kafshë/ kolagjen **për kafshë**	1 337	0	0	0	0	263 488
Protein Shtazore /xhelatine	117	0	0	0	0	0
Total:	**164 455**	**39 851 294**	**9 388 101**	**203 495**	**33 719 406**	**263 488**

Tabela 25. Sasitë e importuara në PIK për produktet me origjinë jo-shtazore

Kategorite specifike	Sasia (ton)
Artikuj Ushqimor etj.	212 594
Pije Alkoolike	69 297
Pije Freskuese	118 153
Fruta perime	131 648
Suplemente Ushqimore/konservant/aditiv/erza/integrator/ngjyrus/l/yndyrna/etj	24 753
Drithera (elb, miser, grure)	20 3752
Kafe	8 391
Vaj Rifuxho (vaj misri, vaj ulliri, margarine, yndyre bimore, palme)	33 758
Lende e pare (malto, bersi)	29 700
Miell	21 518
Lende e pare per pasticeri	12 808
Ushqim per kafshe shtepiake	31 016
Ullinj (hudhra, speca, bajame etj per mbushje)	10 964
Fruta ,perime të thara dhe fara	17 230
Total	**925 582**

Tabela 26. Sasitë e importuara në PIK për produktet bimore dhe inputet bujqësore

Kategorite specifike	Sasia (tonë)	Sasia (kg)	Sasia (litra)	Sasia (copë)	Sasia (vazo)	Sasia (m3)
Fruta Perime	377	95 747 754				
Fruta te Thata		2 533 244				
Bime Medicinale	8	611 789.3				
Ushqim per kafshe	1 360	36 813 435				
FARA per mbjellje		8 876 245		10 947		
FIDAN per mbjellje		2 031 168		25 494 175		
Lende Drusore/ Trungje		201 819		1 706		156 923
Plehra për Përdorim për Bimësinë	63	231 640 540	117 548			44 486
Produkte të Mbrojtjes së Bimëve (P.M.B)		1 055 922	96 600			
Bime dhe Produkte Bimore	2 851	173 441 482	41 882	7 939 674	313 317	159
Makineri Bujqesore				20926		
Duhan (cigare)		10 056 754				
Total	**4 659**	**563 010 152**	**256 030**	**8 831 644**	**313 317**	**201 568**

Referuar kërkesave të Operatorëve të Biznesit Ushqimor për t'u pajisur me licencë në fushën e ushqimit dhe mbrojtjes së bimëve në lidhje me vlerësimin e dokumenteve të paraqitura dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e kërkesave të rregullave e standardeve të detyrueshme tekniko-teknologjike të pajisjeve, kushteve higjieno-sanitare dhe mjedisit ku zhvillohet

veprimtaria AKU, gjatë periudhës ***Janar -Dhjetor 2022*** janë shqyrtuar ***gjithsej 538 kërkesa për licencim***, nga të cilat ***399*** janë miratime dhe ***139*** prej tyre janë refuzime.

Tabela 27. Kërkesat për licencim për vitet 2021-2022

Periudha	Nr. Total	Miratime	Refuzime
Viti 2021	648	480	168
Viti 2022	538	399	139

Grafiku. 8 Kërkesat për licensim për vitet 2021-2022



-

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 kemi një rritje të eksporteve të produkteve shtazore prej 11% krahasuar me vitin paraardhës dhe konkretisht: ***2 825 eksporte në vitin 2022*** kundrejt ***2 549 eksporte në vitin 2021.***

Tabela 28. Eksportet e produkteve me origjinë shtazore për vitet 2021-2022

Periudha	Nr.i Eksporteve ne BE	Nr. i Eksporteve Jo BE	Nr. Eksporteve produkte peshku ne BE	Nr. Eksporteve produkte peshku Jo ne BE	Nr. Eksporteve kembe bretkose ne BE	Nr. Eksporte Veze ne BE	Nr. Eksporte Veze Jo ne BE	Nr. Eksporteve Zorre derri, vici ne BE	Nr. Eksporteve Zorre derri, vici ne Jo BE	Nr. eksporteve guacke kermilli dhe mish kermilli ne BE	Nr. Eksporteve produkte qumeshti Jo ne BE	Nr. Eksporteve produkte mishi Jo ne BE	Nr. Eksporteve produkti mjalt Jo ne BE	Nr. Eksporteve produkteve lende e pare pasticerie; proteine qumështi, qumësht pluhur; konserva peshku Jo ne BE
Viti 2021	1 895	654	1 724	288	73	18	31	71	8	9	43	91	37	156
Viti 2022	1 977	848	1 830	367	37	36	10	69	2	5	114	101	56	198

Grafiku. 9 Eksportet e produkteve me origjinë shtazore për vitet 2021-2022



- Lidhur me raportimin për mostrat e realizuara për periudhën tetor-dhjetor 2022 referuar Urdhrit të Ministrit Nr.439, datë 04.10.2022 *"Për miratimin e Planit të Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve për periudhën tetor 2022-dhjetor 2023"*, rezulton se është realizuar në masën 89.3%, nga 290 mostra të planifikuara janë realizuar 259. Drejtoritë Rajonale me realizim më të ulët janë Fieri me 52 % dhe Berati me 76%. Detajimi i realizimit për cdo DRAKU dhe sipas produkteve paraqitet në Aneksin 2, tabela nr.4.

4.3.2 PROBLEMATIKA

- Mungesa e sistemeve elektronike në menaxhimin e të dhënave. Mbajtja e gjithë informacioneve tekniko financiare në tabela exceli rrit shumë mundësinë e gabimeve;
- Mosrakordim i të dhënave statistikore të dërguara nga DRAKU në njësi të ndryshme të AKU;
- Mungesa e një sistemi për hedhjen e të dhënave në pronësi të AKU ka sjellë të dhëna statistikore të cunguara dhe të diskutueshme në lidhje me saktësinë e tyre;
- Mungesa e eksperiencës, ngarkesa e lartë e raportimeve dhe mungesa e trajnimit të koordinatorëve të raportimit dhe inspektorëve në PIK;
- Mosdërgimi i bazës ligjore me ndryshimet në sektor nga Sektori Juridik apo sektorët e tjerë teknik ka sjellë vështirësi në pasqyrimin e saj në planin vjetor të inspektimeve.

4.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM:

- Trajnimi i koordinatotëve dhe inspektorëve në PIK prioritet menjëhershëm
- Në vazhdimësi pas trajnimit të inspektorëve të gjithë sektorët në Drejtorinë e Përgjithshme duhet të rakordojmë të dhënat e dërguara nga DRAKU-të, si për të dhënat në terrenit dhe PIK-ut çdo muaj.
- Të rakordohen të dhënat për tabelat e certifikatave të eksportit me sektorin e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut;

- Të përmirësohen të dhënat e eksporteve nga sektori përkatës duke raportuar jo vetëm ngarkesat por edhe produktet në sasi;
- Për çdo problematik që evidentohet duhen përmisuar formatet e raportimit dhe trajnuar koordinatorët me qëllim saktësimin e informacioneve.

Në ANEKSIN 2 do të gjeni:

Tabela 1- Të dhëna për konrollin zyrtar për periudhën Janar-Dhjetor 2022 sipas DRAKU-ve, për produktet me origjinë shtazore.

Tabela 1.1- Të dhëna për konrollin zyrtar për periudhën Janar-Dhjetor 2022 sipas DRAKU-ve, për produktet me origjinë jo-shtazore.

Tabela 2- Të dhëna për konrollin zyrtar për periudhën Janar- Dhjetor 2022 sipas DRAKU-ve, për bimët.

Tabela3 - Të dhëna për konrollin zyrtar për periudhën Janar- Dhjetor 2022 sipas DRAKU-ve, për PIK.

Tabela 4- Eksporte të produkteve me origjinë shtazore në vendet BE dhe JO BE

Tabela Nr. 5: Tabela me kthimet në origjinë për vitin 2022.

4.4 SEKTORI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE RAPORTIMIT

Sektori i Planifikimit të Strategjisë dhe Raportimit, mbështetur në Strategjinë e MBZHRsë për bujqësinë, propozon objektiva dhe dokumente strategjike, ndjekjen e zbatimin e tyre si dhe analizimin e statistikave krahasimore me bazë periudhash; një-vjeçare, tri-vjeçare dhe pesë-vjeçare, me qëllim dhënien e rekomandimeve për një menaxhim më të mirë.

4.4.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Sektori i Planifikimit të Strategjisë dhe Raportimit ka si objektiv monitorimin e zbatimit të procesit të Planit Vjetor Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me Bazë Risku dhe të Marrjes së Mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore, si dhe Planin e Marrjes së Mostrave në PIK, për të dhënë më pas rekomandime/sugjerime përkatëse për përmirësime në hartimin e planit vjetor me bazë risku për vitin pasardhës.

- Mbledhja e më pas përpunimi i informacioneve në bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si dhe Drejtoritë Rajonale të AKU-së, mbi zbatimin e metodologjive të miratuara për të krijuar më pas një format raportimi tekniko-analitik ku të evidentohen problematika dhe propozime konkrete mbi bazën e analizave periodike për krijimin e strategjive të reja në lidhje me rritjen dhe garantimin e sigurisë ushqimore përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor.

Detyrat:

- Është përgatitur dokumentin përfundimtar të raportit vjetor mbi aktivitetin e kryer nga Drejtoria e Vlerësimit të Riskut, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së për periudhën Janar-Dhjetor 2021;
- Ka draftuar formatin unik të raportimit mujor mbi aktivitetitn e kryer nga DRAKU si dhe Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut;
- Ka realizuar vlerësimin e raportimeve të dërguara nga DRAKU, sipas formatit të dërguar krahasuar me të dhënat statistikore të Sektorit të Vlerësimit të Riskut dhe Statistikave dhe ato të dërguara pranë sektorit të Planifikimit të Strategjisë dhe Raportimit;
- Ka përgatitur formatin për raportimin vjetor mbi aktivitetin e kryer nga Drejtoria e Vlerësimit të Riskut, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së për periudhën Janar-Dhjetor 2022;
- Sektori ka kontribuar me komente për çështjet takuese mbi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030;
- Sektori gjithashtu ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për hartimin e strategjisë se mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut;
- Sektori ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e draftit të strategjisë në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021 "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë";
- Sektori ka qenë pjesë e grupit të punës për skemat e cilësisë Gl, për kryerjen e kontrolleve zyrtare për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Arritjet:

- Ka përgatitur manualin mbi procedurat operacionale të veprimtarisë të Sektorit të Planifikimit të Strategjisë dhe Raportimit;
- Sektori ka draftuar një format unik për krijimin database-s statistikore krahasimore për Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për periudhën 2010-2021;
- Ka bashkëpunuar me kompaninë që po vitalizon sistemin AKUnet me format e raportimit;
- Ka përpunuar raportet periodike nga DRAKU dhe ka zhvilluar analiza të detajuara;
- Monitorimi i zbatimit të planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë risku i miratuar nga Ministri. Monitorimi i planit do të shërbejë jo vetëm thjesht si statistikë për përqindjen e zbatimit te planit, por në të njëjtën kohë edhe për të analizuar arsyet e moszbatimit te tij, analizë e cila do të shërbejë edhe për dhënien e rekomandimeve adekuate për hartimin e planit vjetor me bazë risku për vitin pasardhës. Për këtë arsye të 12 DRAKU-ve, ju është dërguar një template (tabele tip) nëpërmjet së cilës është kërkuar informacion në lidhje me kontrollet zyrtare të realizuara e ndarë sipas muajve dhe sektorëve përkatës.

Pas përpunimit të të dhënave të dërguara nga të 12 DRAKU për periudhën ***janar- dhjetor*** rezulton se në rang kombëtar janë realizuar ***gjithsej 32 764 inspektime*** (kundrejt ***30 998 inspektime të planifikuara të deklaruar nga DRAKU***) nga të cilat ***27 351*** inspektime janë realizuar në kuadër të planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë risku miratuar nga Ministri dhe ***5413 inspektime***

jashtë programit në kuadër të licencimeve, miratimin e subjekteve të reja, indiciet, njoftimin nga sistemi RASFF, ri kontrollet mbi verifikimin e detyrave të lëna, etj. Po të thellojmë analizën muaj pas muaji rezulton se muaji më i dobët në realizimin e planit eshte muaji Janar me një përqindje realizimi në rang kombëtar në vlerën 69.1%, rezultat i cili ka ardhur duke u përmirësuar në muajt në vazhdim dhe për periudhën mujore janar- dhjetor përqindja e realizimit ka shkuar në ***88.2%,*** pra një rritje prej ***19.1%*** .

Muajt që kanë përqindjen më të lartë të zbatimit të planit janë përkatësisht muajt ***prill-maj*** me një përqindje realizimi të planit prej ***95-96 %*** si dhe muajt ***gusht*** dhe ***dhjetor*** me një përqindje realizimi në masën ***90%*** dhe muaji ***tetor*** në masën ***92%***, muaj këta në të cilët DRAKU kanë realizuar planin në masën mbi ***90%.***

Në harkun kohor të një viti plani vjetor i kontrolleve zyrtare është realizuar në masën ***88.2%,*** por nga DRAKU të ndryshme kemi rezultate të ndryshme dhe konkretisht:

DRAKU që ka performancën më të mirë në zbatim të realizimit të planit vjetor të kontrollit të inspektimeve me bazë risku është ***Lezha*** e cila e ka realizuar në masën ***114%.***

DRAKU që kanë realizuar planin ***(mbi 90 %)*** janë: DRAKU ***Kukës 94.1 %, Tiranë 94.86 %, Durrës 95.1%, Elbasan 98.2% , Dibër 99.5%***

Ndërsa DRAKU që ka rezultuar me dobët eshte DRAKU ***Korçë në masën 69.3%,*** ndërsa 5 DRAKU e tjera rezultojnë nga ***74.8- 89%***.

Për të pasur një panoramë më të saktë për arsyet e moszbatimit të planit si dhe për të eliminuar një problematikë të mbartur nga vitet paraardhëse (mungesë e inspektorëve) sektori komunikoi me sektorin e burimeve njerëzore për të verifikuar nëse moszbatimi i planit ka ardhur si rezultat i vakancave të inspektoreve në DRAKU, por sektori i burimeve njerëzore konfirmoi se nuk ka mungesa të inspektoreve në qarqe.

Tabela 29. Mbi numrin e inspektimeve të realizuara nga DRAKU për periudhën janar-dhjetor 2022

QARKU -	Inspektime te planifikuara në planin vjetor të inspektimeve	Realizimi i Inspektimeve Janar-Dhjetor 2022			% Realizimit nga Inspektimet e programuara	% Realizimit të inspektimeve të paprogramuara
		Inspektime të Realizuara	Nga këto			
			Inspektime të programuara	Inspektime të paprogramuara		
TIRANE	6537	7720	6201	1519	95%	23%
DURRES	3415	3893	3248	645	95%	19%
BERAT	2005	1963	1525	438	76%	22%
SHKODER	1847	1762	1571	191	85%	10%
VLORE	2745	2444	2054	390	75%	14%
FIER	3069	2725	2464	261	80%	9%
DIBER	898	1026	894	132	100%	15%
ELBASAN	2671	3015	2625	390	98%	15%
KORCA	3379	2840	2344	496	69%	15%
LEZHA	1658	2251	1903	348	115%	21%
GJIROKASTER	1722	1831	1533	298	89%	17%
KUKES	1052	1294	989	305	94%	29%
TOTALI	30998	32764	27351	5413	88%	17%

Nga analiza e mos realizimeve të inspektimeve në terren në masën 88%, për çdo DRAKU në bashkëpunim me sektorët e menaxhimit evidentohen disa arsye në mosrealizim si:

Janë gjendur subjekte të mbyllura ose të ç'rregjistruara, mungesë e burime njerëzore dhe raporte shendetësore, bllokim i përkohshëm i sistemit të inspektimeve, numri i lartë inspektime të paprogramuara për licencim, denoncime, Rasff etj.

Si pjesë e rëndësishme e planit zyrtar për vitin 2022 është edhe marrja e mostrave në terren. Për periudhën raportuese plani i marrjes së mostrave është realizuar 69% si më poshtë:

Tabela 30. Realizimi i mostrave si AKU sipas aktiviteteve dhe Laboratoreve

Laboratorët	Terren		PIK		MBIB		TOTAL	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
AKU	7,075	3,703	2,278	2,162	32	44	9,385	5,909
ISUV	2,416	2,283	209	91	73	45	2,698	2,419
ESHFF					166	162	166	162
QTTB					144	147	144	147
DSHP	85	35					85	35
TOTALI	**9,576**	**6,021**	**2,487**	**2,253**	**415**	**398**	**12,478**	**8,672**
Realizimi në %	**63%**		**89%**		**96%**		**69%**	

Për vitin 2022, nga mostrat e marra në terren nga inspektorët tanë në total rezultojnë jokonformitete janë 1.3 % e mostrave të marra:

- 62 në Sektorin e Shërbimit Laboratorik Korçë (diagnoza)
- 25 nga Sektorët e Shërbimeve Laboratorike AKU (Siguria ushqimore)
- 86 nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (54 mbetje pesticide)

4.1.1 PROBLEMATIKA

- Mungesa e sistemeve elektronikë në menaxhimin e të dhënave. Mbajtja e gjithë informacioneve tekniko financiare në tabela exceli rrit shumë mundësinë e gabimeve;
- Performancë e nivelit mesatar të koordinatorëve në dhënie të raportimeve të pasakta;
- Mungesa e akt rakordimeve mujore midis sektorëve në AKU, koordinatorëve rajonalë dhe inspektorëve në PIK.

4.1.2 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM:

- Përmirësim i formateve rapotuese të sektorit të Planifikimit Strategjik dhe Raportimit në bashkëpunim me Sektorin e Vlerësimit të Riskut dhe Statistikave me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale;
- Në kuadër të realizimit të planit vjetor të inspektimeve me bazë risku, të rivlerësohet planifikimi i inspektimeve të shtuara përgjatë sezonit turistik, fillimit të vitit të ri shkollor si dhe festave të fundvitit në mënyrë që inspektimet e realizuara të mos konsiderohen si inspektime jashtë programit duke rritur artificialisht edhe numrin e inspektimeve që realizohen në një OBU në harkun kohor të një viti;
- Trajnimi i koordinatotëve dhe inspektorëve në PIK prioritet dhe rakordimet mujore.

5 DREJTORIA E KOMUNIKIMIT TË RISKUT DHE MONITORIMIT



5.1 SEKTORI I KOMUNIKIMIT TË RISKUT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË OBU- VE

Sektori i Komunikimit të Riskut dhe Ndërgjegjësimit të Operatorëve të Biznesit Ushqimor luan rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e Operatorëve të Biznesit Ushqimor në përmbushjen e kërkesave ligjore nga ana e tyre, komunikimin e riskut, si dhe marrjen e masave korrigjuese dhe riparuese.

5.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Sektori i Komunikimit të Riskut dhe Ndërgjegjësimit të OBU-ve në vijim të plotësimit të detyrave funksionale parashikon shtrirjen e mëtejshme të sensibilizimit/ndërgjegjësimit të OBU-ve në varësi të problematikave të evidentuara gjatë këtij viti.

Obektivat:

- Zhvillimi i fushatës informuese për subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin në qytetet e vogla apo në zonat rurale;
- Sektori do të vijojë me zhvillimin e fushatave informuese aktuale si dhe komunikimin e riskut dhe rëndësinë e tij nëpërmjet fushatave të reja në të gjithë vendin;

Detyrat:

Në funksion të komunikimin të riskut dhe ndërgjegjësimit të OBU-ve në përmbushjen e kërkesave ligjore, gjatë periudhës vitit 2022, janë realizuar këto aktivitete:

- Koordinatori për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit në Platformën e Bashkëqeverisjes, gjatë vitit 2022 ka hedhur në sistem dhe ka trajtuar ***51*** raste, ankesat/kërkesat e biznesit dhe ***16*** raste të ardhura nga qytetarët që vijnë në protokoll apo edhe ato të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes e që delegohen për t'u trajtuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Koordinatori për Institucionin në mënyrë periodike ka raportuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtoreshës së Platformës, Koordinatores në Kryeministri si dhe asaj në Ministri, ecurinë javore, mujore dhe vjetore. Ka nxjerr në pah problematikat e konstatuara si dhe ka përfaqësuar institucionin në takimet periodike javore të zhvilluara me ministrin e Mbrojtjes së Sipërmarrjes dhe Drejtoreshën e Përgjithshme të Platformës së Bashkëqeverisjes ku është trajtuar edhe puna e AKU-së si institucion me rëndësi të veçantë.

Tabela 31. Numri i rasteve sipas tipologjisë Janar-Dhjetor 2022

Ankesa nga Bashkëqeverisja në numër		
Ankesa total	Përfunduar dhe kthyer përgjigje	Në proces
51	**44**	**7**

Tabela 32. Tipologjia "Biznesi"

Masa administrative "Gjobë/Bllokim"	Kërkesa	Ankesa
36-raste	**8-raste**	**7-raste**

Tabela 33. Numri i rasteve sipas tipologjisë Platforma e Bashkëqeverisjes "Qytetarë"

Ankesa nga Bashkëqeverisja "Qytetarët" në numër		
Ankesa total	Përfunduar dhe kthyer përgjigje	Në proces
16	**16**	**0**

- Është mbajtur komunikimi me projektin e sigurisë ushqimore për ndërtimin e faqes Web, zhvillimin e fushatave informuese/ndërgjegjësuese për OBU-të në të gjithë vendin. Si dhe është asistuar nga ana e sektorit në takimet e zhvilluara me operatorët e biznesit ushqimor;
- U përgatitën materialet ndërgjegjësuese për Operatorët e Biznesit Ushqimor të cilat u shpërndanë dhe u diskutuan nga përfaqësuesit e sektorit të cilët morën pjesë në panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë, e cila u zhvillua në qytetin e Lushnjës në datat 19-21 Maj 2022;
- Janë bërë komunikime për ndërgjegjësimin e OBU-ve, pas njoftimit të ardhur nga Komisioni Evropian lidhur me nivelin e lejuar të Oksidit të Etilenit tek produktet Ushqimore, komunikime me MBZHR, DRAKU-t apo me operatorët e biznesit ushqimor si dhe përfaqësuesve të mediave mbi çështje të veçanta që lidhen me kthim përgjigje, informacion, kërkesë etj;
- Në bashkëpunim me projektin për sigurinë ushqimore, u hartuan SOP (Procedurat Standarde të Operimit) për Drejtorinë e Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit;
- Janë përgatitur materialet ndërgjegjësuese për OBU-të në rrjetet sociale për:

  - ✓ Kushtet e ruajtjes së produkteve të ndryshme ushqimore;
  - ✓ Kushtet e transportit të produkteve të ndryshme ushqimore;
  - ✓ Arsyet pse duhet të kenë kujdes OBU-të kur të bashkëngjitin dokumentacionin për aplikimin për licencë;
  - ✓ Alergjia dhe Alergjenët;
  - ✓ Përfitimet nga produktet e ndryshme ushqimore.

- Në bashkëpunim me sektorët e tjerë brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit u finalizua "Udhëzuesi numër 3 për Sigurinë Ushqimore", material i cili do të shërbejë për ndërgjegjësimin e Operatorëve të Biznesit Ushqimor.
- U hartua draft Programi Kombëtar i Edukimit, i cili ka në fokus të tij informimin, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e të gjitha grup moshave kur bëhet fjalë për konsumatorët (kopshte, shkolla, universitete, si dhe fasha tjetër e konsumatorëve), ashtu si edhe ndërgjegjësimi dhe komunikimi i riskut me operatorët e biznesit ushqimor;
- Është përmbyllur fushata digjitale e reels me objekt: "Siguria ushqimore për biznesin ushqimor në ndihmë të informacionit sa më të gjerë, bashkëpunimit dhe arritjeve të praktikave të punës." Fillimi i fushatës digjitale përkoi edhe me nisjen e sezonit turistik (qershor 2022),

ku konsumi i produkteve ushqimore, tradicionalisht rritet ndjeshëm, dhe për këtë arsye u propozua që të promovohen praktika sa më të mira të punës dhe higjienës në stabilimente të prodhimit dhe përpunimit të produkteve të ndryshme ushqimore.

Arritje:

- Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, filloi zbatimi i projektit "Të ushqehemi Shëndetshëm" me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin e nxënësve të klasave 7, 8, 9 të shkollave 9-vjeçare dhe të shkollave të mesme. Projekt i cili filloi me nisjen e vitit të ri shkollor 2022-2023, fillimisht në qarkun e Tiranës, Beratit, Dibrës, Lezhës, Durrësit dhe më pas do të shtrihet edhe në qytete të tjera në të gjithë vendin. Deri më tani në këtë fushatë janë angazhuar rreth ***1000*** nxënës dhe ***30*** mësues, për të cilët janë shpërndarë fletëpalosje informuese, është prezantuar materiali si dhe janë zhvilluar diskutime konstruktive mbi kujdesin që duhet ë tregojnë për shëndetin e tyre duke zgjedhur ushqimin e sigurt;

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me mbështetjen e The Food Safety Project zhvilloi fushatën ndërgjegjësuese "Bashkë me Fëmijët për Sigurinë Ushqimore" në qarkun e Vlorës në datat 5.8.2022: 9.8.2022 dhe 12.8.2022 (Zvërnec, Pylli i Sodës dhe Orikum), qarku Durrës në datat 16 dhe 17.8.2022 (Golem) dhe qarku Lezhë në datat 23 dhe 24.8.2022 (Shëngjin dhe Tale) ku morën pjesë rreth ***180*** fëmijë.
  Fokusi i kësaj u vendos tek fëmijët për të cilët duhet treguar kujdes i shtuar për rritjen e shëndetshme të tyre duke konsumuar shëndetshëm (sipas stinës, produktet slow etj.), vendosjen e rëndësisë tek elementet bazë të sigurisë ushqimore si p.sh. data e skadencës, kushtet e ruajtjes, vlerat ushqyese, alergjenët, mënyra e blerjes së produkteve dhe shmangien e blerjes tek shitësit ambulantë të cilët nuk janë objekt kontrolli.

5.1.2 PROBLEMATIKA

- Për nevoja të komunikimit nevojitet lista e operatorëve të biznesit ushqimor, qoftë sipas kategorisë apo nënkategorisë së proceseve të aktivitetit (prodhues, përpunues, magazinues, shpërndarës, tregetues), qoftë sipas kategorisë apo nënkategorisë së llojit të produktit ushqimor (produkte bimë, produkte mish, produkte deti, etj.), me të dhëna të aksesueshme.

5.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Shtimi i fushatave ndërgjegjësuese/sensibilizuese për Operatorët e Biznesit Ushqimor pas evidentimit të problematikave në zbatimin e kërkesave ligjore;
- Forcimi i bashkëpunimit brenda dhe jashtë institucional me qëllim komunikimin e shpejtë të riskut.

5.2 SEKTORI I INFORMIMIT TË PUBLIKUT DHE KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL

Sektori i Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional ka në fokus afatgjatë komunikimin në mënyrë transparente dhe të besueshme me konsumatorin në lidhje me sigurinë ushqimore. Sektori administron të dhënat mbi strategjinë e komunikimit të

institucionit dhe informon publikun mbi riskun për sa u përket rreziqeve dhe sigurisë së ushqimit e të ushqimit për kafshë, për të përmirësuar besimin e konsumatorit.

5.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e konsumatorëve në bashkëpunimin me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit për të qenë pjesë e sfidave për garantimin e sigurisë ushqimore në vend;
- Publikimin në të gjtha platformat komunikuese e informuese të AKU-së, Web-in aku.gov.al dhe rrjetet sociale për masat e marra nga të gjitha trupat inspektuese të AKU-së;
- Ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe këshilliminin e tyre, nëpërmjet mjeteve të komunikimit, si broshura, fletëpalosje në fasha të ndryshme ndarë sipas grupmoshave të konsumatorëve;
- Vendosjen online në rrjetet sociale të AKU-së të pyetësorëve në lidhje me perceptimin e konsumatorëve për sigurinë ushqimore;
- Bashkëpunimin me institucionet e tjera analoge dhe forcimin e mëtejshëm ndërinsitucional në raste krizash ushqimore, për një komunikin të shpejtë, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm tek konsumatori.

Detyrat:

- Ka informuar publikun mbi riskun, sa i përket rreziqeve dhe sigurisë së ushqimit, të ushqimit për kafshë dhe mbrojtejn e bimëve, për të përmirësuar besimin e konsumatorëve dhe masat që duhet të marrë;
- Ka bashkëpunuar me strukturat analoge të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare, dhe institucionet brenda vendit që trajtojnë çështjet e sigurisë ushqimore dhe praktikave më të mira që lidhen me sigurinë ushqimore;
- Ka përditësuar dhe mbajtur në mënyrë konstante vizibilitetin dhe publikimin e punës dhe veprimtarisë së Autoriitetit Kombëtar të Ushqimit, nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar, faqes zyrtare të internetit dhe çdo rrjeti tjetër të nevojshëm për arritjen e këtij qëllimi;
- Sektori ka informuar periodikisht konsumatorin mbi të gjitha rastet e ardhura nga Sistemi i Informimit të Shpejtë (RASFF), duke reaguar shpejt dhe në mënyrë transparente për të gjitha masat që merr hap pas hapi Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si dhe këshillimin ndaj konsumatorëve, për të mos i konsumuar këto produkte, por për t'i kthyer pranë vendeve ku i kanë blerë;
- Ka ndërgjegjësuar konsumatorin për rreziqet që vijnë nga blerja, ruajtja, trajtimi dhe konsumimi i ushqimit në kushte të papërshtatshme higjienike, për leximin e etiketës së produktit përpara blerjes së produktit dhe vlerave ushqyese të produkteve ushqimore;
- Në llogaritë e rrjeteve sociale të AKU-së, facebook dhe Instagram kryhet sistematikisht raportim ditor, javor dhe mujor për të gjitha inspektimet dhe monitorimet në rang vendi, masat e marra dhe të gjitha detyrat e lëna për OBU-të;

- Është pasqyruar raportimi me informacion javor nga Kontrolli i Inputeve Bujqësore dhe Veprimtarisë së Duhan Cigares të Bimëve, raportim javor mbi Licencimin e Operatorëve të Biznesit Ushqimor dhe raportim mujor mbi Etiketimin e Produkteve;
- Janë përgatitur gjatë periudhës 1 vjeçare për publikim **213 njoftime** në llogaritë e rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram;
- Menaxhon adresën zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit info@aku.gov.al si dhe numrin e gjelbër 08007575.

Informimi dhe Transparenca

Ankesa/denoncime/kërkesa për informacion. Trajtimi i ankesave, denoncimeve, kërkesave për informacion të qytetarëve, OBU-ve apo nga media është detyrë e zbatuar në vazhdimësi nga Sektori i Informimit të Publikut dhe Koordinimit Ndërinstitucional.

Kanalet zyrtare të komunikimit me qytetarët për rastet e ankesave dhe/ose kërkesave për informacion janë:

- Faqja zyrtare web
- Email-i Zyrtar Info@aku.gov.al
- Numri i Gjelbër: 08007575
- Rrjeti social Facebook,
- Rrjeti social Instagram,

Faqja e re Zyrtare e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit aku.gov.al gjatë kësaj periudhe ka qenë në ndërtim dhe përfundoi në muajin **tetor 2022**, bazuar modeleve më të mira evropiane të kategorizimit dhe informacioneve për sigurinë ushqimore, bashkëpunim ky ndërmjet Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Projektit për Sigurinë Ushqimore "Food Safety Project".

Faqja e re ka një qasje më të moderuar informuese, këshilluese, të qartë dhe transparente, duke krijuar bashkëpunimin e munguar me të gjithë përdoruesit e saj, konsumatorë, OBU dhe studiues të fushës. Ndërkohë është vijuar gjatë periudhës së munguar vjetore, në çdo moment në informacion për qytetarët dhe operatorët e biznesit ushqimor me ëeb AKU të mëparshëm, me njoftimet e fundit në lidhje me inspektimet dhe monitorimet e trupave inspektuese në të gjitha qarqet e vendit.

- Në llogaritë e rrjeteve sociale të AKU-së, facebook dhe Instagram kryhet sistematikisht raportim ditor, javor dhe mujor për të gjitha inspektimet dhe monitorimet në rang vendi, masat e marra dhe të gjitha detyrat e lëna për OBU-të. Po ashtu kryhet raportimi me informacion javor nga Kontrolli i Inputeve Bujqësore dhe Veprimtarisë së Duhan Cigares të Bimëve, raportim javor mbi Licencimin e Operatorëve të Biznesit Ushqimor dhe raportim mujor mbi Etiketimin e Produkteve;
- Janë përgatitur gjatë periudhës 1 vjeçare për publikim **213 njoftime** në llogaritë e rrjeteve sociale facebook dhe Instagram.

Arritje:

- Në momentin e shfaqjes së Influencës Aviare në vendin tonë, Informimi Publik si pjesë e grupit të Komunikimit në bashkëpunim edhe Komunikimin e MBZHR, realizuan video, foto

dhe këshilla praktike për konsumatorin për sëmundjen e gripit të shpendëve. Pas realizimit, këto materiale informuese u publikuan në kanalet e komunikimit të AKU, faqen zyrtare, rrjetet sociale facebook dhe instagram;

- U realizua video sensibilizuese për konsumatorët dhe OBU-të nën moton "Ushqim i sigurt, shëndet i mirë, sfida jonë sot për një të ardhme më të mirë nesër" në bashkëpunim me blogeren e ushqimit Kristi Janku në 7 qershor, 2022, Dita Botërore e Sigurisë së Ushqimit.

Informimi dhe Transparenca

Tabela 34. Numri i ankesave/denoncimeve/kërkesave sipas kanaleve të komunikimit për periudhën janar-dhjetor 2022:

Kanalet e Komunikimit	Numri i ankesave
Email-i Zyrtar info@aku.gov.al	541 - 59%
Numri i Gjelbër 08007575	268 - 29%
Rrjeti social Facebook,	58 - 6.3%
Instagram	47 - 5.1%
Totali	**914**

Krahasimisht me vitin 2021 ***vërehet një rritje me 2 herë më shumë*** të kërkesave për informacion dhe shqetësimeve të qytetarëve, tregues në rritje i ndërgjegjësimit të konsumatorit dhe rritje e besueshmërisë ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Tregues i lartë marrëdhies së krijuar ndërmjet AKU dhe konsumatorëve vërehet edhe numrin e lartë të klikimeve të faqes gjatë vitit 2022 ***4. 5 milion reaches.***

Grafiku. 10 Numri i ankesave/denoncimeve sipas kanaleve të komunimimit janar-dhjetor 2022



Krahasimisht duke marrë të dyja periudhat ***vërehet një rritje me 2 herë më shumë*** të kërkesave për informacion dhe shqetësimeve të qytetarëve, tregues në rritje i ndërgjegjësimit të konsumatorit dhe rritje e besueshmërisë ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Tregues i lartë marrëdhënies së krijuar ndërmjet AKU dhe konsumatorëve vërehet edhe numrin e lartë të klikimeve të faqes gjatë vitit 2022 ***4. 5 milion reaches.***

Informimi i Publikut

Gjithashtu kemi informuar periodikisht konsumatorin gjatë kësaj periudhe mbi tematika të ndryshme ushqimore si:

- ✓ Gripi i shpendëve;

- ✓ Vlerat ushqyese të mishit të pulës;
- ✓ Si kryhet inspektimi i mishit të pulës;
- ✓ Vlerat ushqyese të çokollatës së zezë;
- ✓ Spinaqi dhe vlerat e tij;
- ✓ Alergjia dhe pasojat që shkakton në organizëm;
- ✓ Informacion mbi etiketimin e produkteve ushqimore;
- ✓ Si të njohim bostanin dhe vlerat ushqyese të tij;
- ✓ Boronicat dhe përfitimet prej saj;
- ✓ Arrorët dhe vetitë e tyre ushqyese;
- ✓ Këshilla për përdorimin e frutave dhe perimeve;
- ✓ Salmonella Spp.;
- ✓ Vlerat ushqimore të qumështit;
- ✓ Mishi pulës vlerat ushqimore;
- ✓ Këshilla për sigurinë ushqimore.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe marrëdhëniet me Mediat

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duke qenë institucioni kompetent që garanton me ligj sigurinë ushqimore në vend dhe si i tillë kërkesa për informacion nga mediat është relativisht shumë e lartë.

Gjatë periudhës Janar Dhjetor 2022 janë realizuar në total **120 kërkesa mediatike**, të lidhura përgjithësisht me kërkesa e shqetësime për sektorët e ushqimit. Gjithashtu një fluks kërkesash ka pasur gjatë sezonit veror, në statistikë dhe këshillim, në rastet e komunikimit e alerteve nga RASSF si psh: Rasti çokollatës "Kinder", patatinat "Tortilla Chips" dhe sallameve "ëudy",si edhe gjatë festave të fund vitit në lidhje me blerjet e sigurta të konsumatorëve të përfaqësuara mediatikisht nga Drejtoresha e Përgjithshme e AKU-së, Drejtorë Rajonalë dhe inspektorë dhe specialistë të ushqimit. Në të gjitha rastet janë pasqyruar në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të AKU-së (Facebook dhe Instagram).

5.2.2 PROBLEMATIKA

- Mbulimi i numrit të gjelbër **08007575** jashtë orarit zyrtar për shkak të numrit të madh të denoncimeve dhe kërkesave për informacion nga qytetarët;
- Bashkëpunim më të zgjeruar me sektorë të ndryshëm të AKU në lidhje me kërkesat mediatike ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për përfaqësi në studio nga specialistë dhe inspektorë të ushqimit, ashtu edhe për Drejtoritë Rajonale;

5.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Trajnimi i stafit për mirëmbajtjen e faqes së Webit (bashkëpunim me projektin Irlandez për Sigurinë Ushqimore).

5.3 SEKTORI I MONITORIMIT DHE HETIMIT USHQIMOR

Sektori i Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

5.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Sektori zbulon, heton dhe dokumenton praktika të falsifikimit dhe mashtrimit ushqimor në fushën e ushqimit si dhe vlerëson të gjitha rrethanat që janë të nevojshme për përfundimin e hetimit në funksion të garantimit të sigurisë ushqimore.

Detyrat:

- Ka filluar procedura hetimi në rastet kur është marrë informacion nga mediat vizive, online dhe të shkruar apo institucione shtetërore apo private, subjekte tregtare apo individë të ndryshëm, pas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë;
- Ka përgatitur relacionin për Drejtorin e Përgjithshëm në përfundim të procedurës së hetimit administrativ të praktikave të inspektimit në lidhje me rezultatet e përfundimit të hetimit, pas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë;
- Ka kryer menjëherë referim të rastit në organet e ndjekjes penale, kur në përfundim të procedurës së hetimit administrativ të praktikave të inspektimit është vlerësuar se shkeljet e identifikuara klasifikohen si vepër penale në fushën e mashtrimit ushqimor;
- Janë kryer bashkëpunime me institucionet e tjera ligjzbatuese për hetimin e falsifikimeve dhe mashtrimeve ushqimore, prodhimin e kundërligjshëm të produkteve ushqimore, etj;

Janë kryer 267 monitorime/inspektime, nga këto:

- 178 inspektime referuar urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm si dhe denoncimeve të ardhura pranë Drejtorisë së Përgjithshme;
- 87 monitorime referuar urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm si dhe denoncimeve të ardhura pranë Drejtorisë së Përgjithshme;
- 2 inspektime në kuadër të njoftimeve të RASFF;
- Sektori i Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor ka qënë pjesë e programit të punës në zbatim të tre Urdhrave të DP (Nr. 6890 Prot. Dt. 21.11.2022, Nr. 7038 Prot. Dt. 30.11.2022 dhe Nr. 7039 Prot. Dt. 30.11.2022) në kuadër të festave të fundvitit për kryerjen e kontrollit në PIK Kapshticë, Qafë-Thanë, Kakavije, Hani i Hotit;

Nga verifikimi i kryer rezultoi se u kontrolluan ***1348 praktika***, nga ku rezultoi se për ***7 (shtatë)*** praktika, certifikata veterinare në dokumentacion është fotokopje. Gjithashtu gjatë kohës së qëndrimit në këto Pika Inspektimi Kufitare (PIK) në prezencë të grupit të kontrollit për ngarkesat u konstatuan problematika në lidhje me dokumentacionin që shoqëronin ngarkesat dhe u krye bllokimi për 5 (pesë) ngarkesa deri në plotësimin e dokumentacionit përkatës si dhe 1 (një) kthim në origjinë të ngarkesës.

Nga inspektimet e kryera janë marrë masat e mëposhtme:

- 224 masa administrative me gjobë, në vlerën 40,470,000 lekë;
- 66 masa administrative me Paralajmërim;

- 22 masa urgjente të ndërprerjes së aktivitetit;
- 527.707 tonë produkte ushqimore të bllokuara;
- 3,041,693 kokrra vezë të bllokuara;
- 13 çështje i janë kaluar prokurorisë së qarkut përkatës për shqyrtim.

Tabela 35. Të dhënat e inspektimeve të kryera nga Sektori i Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor

MONITORIME/ INSPEKTIME	*GJOBA*	*VLERA ne leke*	*NDËRPRERJE AKTIVITETI*	*PARALAJMËRIM*	*BLLOKIM PRODUKTI SASIA*	*KALLZIME PENALE*
267	**224**	**40,470,000**	**22**	**66**	**527.707 Ton** **3,041,693 kokrra vezë**	**13 OBU**

Grafiku. 11 Masa administrative nga Sektori i Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor



Janë marrë ***224 masa administrative me gjobë***, me vlerë **40,470,000 (dyzetmilionekatërqindeshtatëdhjetëmijë) lekë**. Nga këto:

- 13 masa administrative me gjobë, me vlerë **13,000,000 (Trembëdhjetëmilion)** lekë, për "Zhvillim të biznesit në një stabiliment të paregjistruar", në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në *nenin 19 të ligjit nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar*.
- 22 masa administrative me gjobë, me vlerë **6,700,000 (gjashtëmilioneshtatëqindmijë)** lekë, për " Nxjerrjen në treg të ushqimeve", në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në *pikën 2 të nenit 10 të ligjit nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar*.
- 9 masa administrative me gjobë, me vlerë **3,100,000 (tremilionenjëqindmijë)** lekë, për "Veprim në kundërshtim me kushtet e higjenës së ushqimeve" të percaktuara në pikën 1, germa (h) e nenit 23, *të ligjit nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar*.

- 63 masa administrative me gjobë, me vlerë **6,600,000** lekë, për mungesë të sistemit të gjurmueshmërisë, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në *nenin 25 të ligjit nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar*.
- 46 masa administrative gjobë, me vlerë **2,950,000** lekë, për etiketim në kundërshtim me *nenin 36, të ligjit nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar*.
- 21 masa administrative gjobë me vlerë **2,200,000** lekë, për veprim në kundërshtim me kërkesat e vetëkontrollit të përcaktuar në *nenin 26, të ligjit nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin"* i ndryshuar.
- 2 masa administrative gjobë me vlerë **200,000** lekë, për mos lejim të kryerjes së inspektimit referuar *nenit 54, të ligjit nr 10433 datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në RSh"*.
- 9 masa administrative gjobë me vlerë **960,000** lekë, bazuar në Ligjit 87/2012 "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre".
- 1 masë administrative gjobë me vlerë **50,000 lekë**, për "Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve si edhe çdo shenje tjetër të vendosur nga inspektorët", bazuar në nenin 54, të ligjit nr 10433 datë 16.6.2011 *"Për Inspektimin në RSh"*.
- 2 masë administrative gjobë me vlerë **70,000 lekë**, për "Moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar", bazuar në nenin 48 pika 6, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 *"Për Inspektimin në RSh"*.
- 11 masa administrative gjobë me vlerë **2,200,000 lekë**, bazuar në nenin 28, pika 1, germa (ç), të ligjit nr. 105, datë 14.10.2016, "Për Mbrojtjen e Bimëve", për veprime në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 28 të këtij ligji, "Lejohet tregtimi me shumicë dhe me pakicë i PMB-ve të regjistruara".
- 9 masa administrative gjobë me vlerë **900,000** lekë, bazuar në nenin 28, pika 1, germa (c), të ligjit nr. 105, datë 14.10.2016, "Për Mbrojtjen e Bimëve", për veprime në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 20, pikën 6, germën(c), të këtij ligji, ku ndalohet mbajtja dhe tregtimi i PMB-ve me ambalazhe të pamiratuara;
- 12 masa administrative gjobë me vlerë **1,200,000** lekë, bazuar në nenin 28, pika 1, germa (c), të ligjit nr. 105 datë 14.10.2016, "Për Mbrojtjen e Bimëve", për veprime në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 20, pikën 6, germën (dh) të këtij ligji, ku ndalohet riambalazhimi i PMB-ve.
- 2 masa administrative gjobë me vlerë **140,000** lekë, bazuar në nenin 54 "Sanksionet", pika 9, për shkeljet e parashikuara në pikën 10, te nenit 53, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011 "Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor", i ndryshuar, për veprime në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 27.
- 2 masa administrative me gjobë, me vlerë **200,000** lekë, për përgjegjësitë e Operatorit të biznesit ushqimor të përcaktuara në *nenin 24 të ligjit nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar*.

5.3.2 PROBLEMATIKA

- Problematikë është mungesa e infrastrukturës ne Pikat e Inspektimit Kufitar lidhur me mospasjen e magazinave frigoriferike, freskuese, ambient i cili vështirëson kryerjen e kontrollit të identitetit dhe fizik të produkteve që importohen;
- Mungesa e trajnimeve për këtë sektor në lidhje me evidentimin, hetimin, për çështjet e mashtrimeve ushqimore në fushën e sigurisë ushqimore, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste.

5.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Inspektorët e Drejtorive Rajonale të AKU në qarqe duhet ti kushtojnë vëmendje të shtuar konrollit të sistemit të gjurmueshmërisë në Operatorët e Biznesit Ushqimor;
- Inspektorët e Drejtorive Rajonale të AKU në qarqe duhet ti kushtojnë vëmendje të shtuar konrollit të etiketimit të produkteve ushqimore gjatë proçedurës së inspektimit;
- Inspektorët e Drejtorive Rajonale të AKU ti kushtojnë vëmendje të shtuar tregtimit të PMB;
- Inspektorët e Drejtorive Rajonale të AKU, gjatë procedurës së inspektimit të jenë më të vëmendshëm në verifikimin e drejtuesit teknik në subjektet prodhuese, përpunuese, ambalazhuese;
- Drejtorët e AKU në qarqe në rastet kur evidentojnë se nga kontrolli i ushtruar në subjekte, dyshojnë se janë konsumuar elementëve të veprës penale, të bëhet referimi në prokurorinë të qarkut përkatëse;
- Trajnime specifike për çështjet që lidhen me hetimin ushqimor.

6 DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME



6.1 SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV-PROTOKOLLIT

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit siguron menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimet e arkiv-protokollit me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit dhe orientimet e politikave për menaxhimin e burimeve njerëzore.

6.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Menaxhimi (planifikim, organizim, drejtim dhe kontroll) i burimeve njerëzore të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe shërbimet e arkiv-protokollit;
- Miratimi i Manualit të Rekrutimeve për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit;
- Miratimi i formularëve të përshkrimit të punës për secilin punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- Përgatitja e Rregullores për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit;
- Kryerja e përpunimit tekniko-shkencor të dokumenteve për vitet 2010 dhe 2011 dhe dorëzimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave i dokumenteve me afat ruajtje RHK.

Detyrat:

- Ka menaxhuar burimet njerëzore dhe shërbimet e arkiv-protokollit me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit dhe orientimet e politikave për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Është ndjekur procesi i planifikimit të nevojave për burime njerëzore të institucionit dhe kualifikimin e tyre;
- Është ndjekur zbatimi i procedurave mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me rekrutimet transferimet e përkohshme dhe të përhershme, pezullimet, lirimin dhe vlerësimin e rezultateve në punë;
- Janë përgatitur, ruajtur, administruar dhe përditësuar dosjet personale të punonjësve të AKU-së me të gjithë dokumentacionin përkatës;
- Në bashkëpunim me strukturat e tjera të AKU-së janë realizuar procedurat lidhur me hartimin e përshkrimeve të punës;
- Ka menaxhuar dosjet personale të punonjësve të AKU dhe popullimin e sistemit HRMIS për DP. AKU;
- Ka ndjekur procedurat për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës dhe janë ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi;
- Nga Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore, të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, janë organizuar dhe zhvilluar procedurat disiplinore ndaj punonjësve të AKU;
- Ka zbatuar masa të veçanta për ruajtjen dhe miradministrimin e dokumenteve konfidenciale dhe të dhënave personale të punonjësve sipas parashikimeve ligjore për ruajtjen dhe përpunimin e dokumentacionit;

- Ka administruar dokumentet justifikuese mbi mos prezencën në punë (raportet mjekësore), si dhe ka koordinuar punën për hartimin e planit vjetor të pushimeve vjetore të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme;
- Janë analizuar dokumentet për të përcaktuar afatet e mbajtjes sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse sipas ligjit, "Për Arkivat";
- Është mbikëqyrur puna për çështjet e arkiv/protokollit;
- Është ndjekur procedurën e përpunimit tekniko-shkencor dhe ekspertizën e vlerës së ruajtjes së dokumenteve;
- Ka bashkëpunuar me Arkivin e Shtetit, me qëllim arkivimin e dokumenteve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi;
- Janë organizuar dhe ndjekur veprimet zyrtare lidhur me pranimin, evidentimin, shpërndarjen dhe kthimin e korrespodencës zyrtare;
- Ka mbikëqyrur përgatitjen e databazave të personelit për aspekte të ndryshme të përdorimit të të dhënave, brenda dhe jashtë institucionit;

Për vitin 2022, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM Nr. 708 datë 9.9.2020 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit"; Urdhri Nr.128 datë 26.10.2020 për "Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit" dhe Rregullores së Brendshme "Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit" e miratuar me Urdhër Nr. 297 datë 23.6.2022 të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, janë emëruar në total **65 punonjës**, nga të cilët **52 punonjës** janë emëruar me kontratë me afat të pacaktuar, **11 punonjës** të emëruar si zëvendësues (me kontratë me afat të caktuar) dhe **2 punonjës** të emëruar si Këshilltar të Jashtëm të Drejtorit të Përgjithshëm, ndërsa në vitin 2021 janë emëruar në total **27 punonjës** në total.

Grafiku. 12 Numri i emërimeve për vitet 2021 dhe 2022, për DPAKU dhe 12 Drejtoritë Rajonale



Gjithashtu, gjatë vitit 2022 janë larguar në total **63 punonjës**, nga të cilët:

- 33 punonjës me dorëheqje;
- 14 punonjës për shkak të daljes në pension;
- 16 punonjës me zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës/përfundim i kontratës me afat të caktuar.

Grafiku. 13 Të dhëna krahasimore për vitet 2021-2022 lidhur me largimet e punonjësve të AKU, (shkaku largimit)



Për vitin 2022, nga Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore/ Punëdhënësi/ eprori direkt janë dhënë 118 masa disiplinore, të ndara si më poshtë:

- 18 vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna;
- 55 vërejtje;
- 45 tërheqje vëmendje.

Krahasuar me vitin 2021 janë dhënë **16 masa disiplinore, ne vitin 2022 masat disiplinore janë 7 fishuar.**

Bazuar në Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 1, datë 25.2.2020, "Për procedurën e trajnimit, testimit fillestar dhe periodik, si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë", në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror **për vitin 2022 janë testuar në total 10 inspektorë dhe 2 Kryeinspektorë në periudhë prove, ndërsa për vitin 2021 janë testuar në total 57 inspektorë dhe 3 Kryeinspektorë.**

Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror **u realizua testimi periodik i inspektorëve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara nga Udhëzimi Nr. 1, datë 25.2.2020 "Për procedurën e trajnimit, testimit fillestar dhe periodik, si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë".

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit Nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar, Ligjit Nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 708, datë 9.9.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", Urdhrit Nr. 432, datë 28.9.2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin Nr. 15, datë7.5.2015 Për miratimin e rregullave "Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik "e-Inspektimi", **është realizuar hapja e aksesit në portalin unik "e-Inspektimi" për strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së**, i cili u mundëson gjenerimin e të dhënave mbi praktikat e inspektimit të kryera nga inspektorët e drejtorive rajonale.

Gjatë vitit 2022 është kryer sistemimi i dosjeve, duke ndarë sipas viteve përkatëse 2010-2020. Ndarja e dosjeve është evidentuar sipas sektorëve përkatës. Ka filluar kryerja e përpunimit teknik-shkencor të dokumenteve për vitet 2010 dhe 2011 dhe dorëzimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave i dokumenteve me afat ruajtje RHK.

Arritjet:

- Miratimi i rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit" me Urdhër të Ministrit përgjegjës për ushqimin Nr. 297 datë 23.6.2022;
- Miratimi i rregullores "Mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line" në zbatim të pikës 30 të VKM nr. 252 datë 29.4.2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre";
- Kryerja e vlerësimit të performancës të secilit punonjës të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për çdo muaj dhe krijimi i një database ku janë evidentuar për secilën periudhë vlerësimet për punonjësit të ndarë sipas sektorëve/ drejtorive përkatëse;
- Krijimi e një praktike të unifikuar për të gjithë sektorët/drejtoritë për raportimin e prezencës ditore, lejeve, raporteve mjekësore, si dhe lëvizjeve të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të AKU-së;
- Krijimi i një regjistri në excel për të gjitha aplikimet për punë drejtuar Autoritetit Kombëtar të Ushqimit me shkresë zyrtare dhe/ ose nëpërmjet email zyrtar dhe përditësimi i tyre;
- Inventarizimi i dosjeve të personelit në përputhje me VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit";

6.1.2 PROBLEMATIKA

- Mungesa e database-ve të trashëguara para vitit 2022, ku të jenë të pasqyruara të dhëna për emërimet dhe largimet e punonjësve, masat disiplinore, pensione dhe leje lindje, vlerësimet e punonjësve, kërkesat për punësim, duke lehtësuar në këtë mënyrë krahasimin midis viteve;
- Mungesa e një sistemi, ku mund të hidhen dhe të përditësohen të dhëna të automatizuara për burimet njerëzore (emërime, largime, masa disiplinore, pensione, leje lindje, vlerësime të performancës në punë) dhe mund të gjenerohen raporte.

6.1.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Krijimi i database-ve në excel, ku të jenë të pasqyruara dhe të përditësuara të dhëna për burimet njerëzore, duke lehtësuar në këtë mënyrë krahasimin midis viteve dhe nxjerrjen e rezultateve;
- Krijimi e një sistemi të automatizuar, ku mund të hidhen dhe të përditësohen të dhëna për burimet njerëzore dhe mund të gjenerohen raporte.
- Krijimi i sharefolder-ave të përbashkëta, të cilët mund të aksesohen nga punonjësit e sektorit.

6.2 SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE PROKURIMIT

Sektori i Shërbimeve të Brendshme dhe Prokurimeve siguron menaxhimin dhe mirë administrimin e burimeve dhe aseteve të institucionit, për përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike nga enti prokurues, për mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe për funksionimin normal të infrastrukturës mbështetëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

6.2.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

- Hartimi dhe monitorimi i rregjistrit të prokurimeve dhe raportimi i realizimit të tij.
- Realizimi i procedurave të prokurimeve të fondeve të vëna në dispozicion;
- Menaxhimi dhe administrimi i automjeteve në inventar të AKU-së dhe dokumentacionit të tyre konform rregullores së miratuar me Urdhër Nr. 724 datë 20.3.2019 "Për miratimin e rregullores "Për përdorimin, mirëmbajtjen dhe drejtimin e automjeteve në AKU";
- Administrimi, mirëmbajtja, mbrojtja dhe përdorimi eficient i të gjitha vlerave materiale që hyjnë në magazinë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Detyrat:

- Janë zbatuar në kohë dhe në mënyrë profesionale të gjitha procedurat ligjore për prokurimet publike në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe me të gjitha aktet e tjera nënligjore të nxjerra në mbështetje të ligjit;
- Janë përgatitur urdhrat e prokurimit dhe ngritjet e komisioneve të testimit të tregut dhe komisionet e vlerësimit të ofertave për procedurat përkatëse të Prokurimit, si dhe janë hartuar dhe dërguar njoftimet për botim në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik;
- Është ndjekur parimi i barazisë/drejtësisë gjatë të gjithë procedurave të prokurimeve (kthim përgjigjet e ankesave/kërkesave për informacion në kohën e duhur si dhe zgjedhjen e paanshme të fituesit);
- Është bashkëpunuar me të gjitha strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së dhe drejtoritë rajonale për sigurimin e të dhënave të nevojshme për përgatitjen e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimeve Publike, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në Udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik;
- Janë ndjekur në vazhdimësi dhe mbajtur në gatishmëri automjetet e DP.AKU, duke evidentuar në kohë difektet dhe riparimin e tyre, kujdesur për lëvizjen e automjeteve si dhe janë hartuar planet e lëvizjes në përputhje me kërkesat e drejtorive të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU;
- Është ndjekur dhe mbikëqyrur përgatitja e kërkesave mbi furnizimin me bazë materiale dhe karburant brenda normativave të miratuara për punonjësit e shërbimit;

- Janë mbikëqyrur procedurat e hyrje-daljeve të vlerave materiale, si dhe janë administruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Tabela 36. Procedurat e Prokurimit Publik të Realizuara gjatë vitit 2022

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Loji i Procedurës së Prokurimit	Vlera e kontratës	Statusi i kontratës shërbimit
1	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme	666,600.00	Blerje me vlerë të vogël	588,000.00	E realizuar
2	Kancelari	750,000.00	Blerje me vlerë të vogël	637,000.00	E realizuar
3	Materiale dhe paisje laboratorike te sherbimit publik	16,700,000.00	E hapur	8,938,430.00	E realizuar
4	Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale	660,000.00	Blerje me vlerë të vogël	249,000.00	E realizuar
5	Materiale per pastrim dhe dezifektim	666,600.00	Blerje me vlerë të vogël	549,200.00	E realizuar
6	Sherbime te printimit dhe te publikimit	800,000.00	Blerje me vlerë të vogël	722,000.00	E realizuar
7	Shpenzime Siguracion mjete transporti	750,000.00	Blerje me vlerë të vogël	749,500.00	E realizuar
8	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	750,000.00	Blerje me vlerë të vogël	719,000.00	E realizuar
9	Materiale konsumi per laboratoret e AKU (ene laboratorike, qelqurina)	1,000,000.00	Blerje me vlerë të vogël	890,000.00	E realizuar
10	Kosto te trajnimeve dhe seminare	600,000.00	Blerje me vlerë të vogël	575,000.00	E realizuar
11	Blerje Bexha	100,000.00	Blerje me vlerë të vogël	98,210.00	E realizuar
12	Shpenzime per mirembajtjen e rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike,ngrohje etj	100,000.00	Blerje me vlerë të vogël	72,500.00	E realizuar
13	Vleresim Automjeti	100,000.00	Blerje me vlerë të vogël	98,000.00	E realizuar
14	Blerje pajisje laboratorike ftohëse	3,000,000.00	E hapur, e thjeshtuar	1,880,000.00	E realizuar
15	Riparim pajisje laboratorike	800,000.00	Blerje me vlerë të vogël	653,095.00	E realizuar
16	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	375,000.00	Blerje me vlerë të vogël	296,000.00	E realizuar
17	Blerje Bileta Avioni	300,000.00	Blerje dinamike	15,340.00	E realizuar
				19,685.00	
				166,725.00	
				53,192.00	

Arritje:

- Është realizuar në kohë, brenda afateve regjistri i parashikimeve;
- Janë realizuar kontratat për furnizimin e mallrave apo ofrimit të shërbimeve;
- Është rakorduar me sektorin e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në DP. AKU, të vlerave materiale të magazinës si dhe të hyrjeve dhe daljeve të magazinës brenda datës 10 të muajit pasardhës;

6.2.2 PROBLEMATIKA

- Mungesa e database-ve/regjistrave me të dhëna të viteve të mëparshme të cilat i shërbejnë sektorit;
- Mungesa e pajisjeve informatike (kompjutera) për punonjësit e ri.

6.2.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Zgjerim/përditësim/përmirësim i njohurive të stafit lidhur me mbarëvajtjen e punës së sektorit (trajnime të punonjësve të sektorit)
- Koordinim më i mirë i punës me sektorët e tjerë (sektorë që aplikohen procedura prokurimi, plotësimi i ditarëve të automjeteve si dhe nga sektori i financës rakordimi i të dhënave lidhur me asete të veçanta si psh: karburanti);
- Rivlersimi i gjendjes dhe riparimi i pajisjeve informatike që kemi dhe të shikohet mundësia e blerjeve të pajisjeve të reja;
- Mbajtja në excel e informacioneve me bazë javore dhe mujore, të cilat më pas të jenë të aksesueshme për të gjithë nëpërmjet share folderit.

6.3 SEKTORI I ANKESAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore është pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, raporton para Drejtorit të Drejtorisë për përmbushjen e detyrave të ngarkuara në zbatim të planit vjetor të punës së AKU-se, përmbushjen e afateve në hartimin e project akteve normative, për ndjekjen e procedurave ligjore pranë Gjykatave të territorit të Republikës së Shqipërisë, ku si palë është AKU, si dhe sigurimin e asistencës jurike, me qëllim që të mund të përmbushet misioni i sektorit. Siguron ligjshmërinë e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në funksion të misionit të Autoritetit Kombetar të Ushqimit. Përfaqëson me miratimin e Drejtorit të Përgjithshem proceset gjyqësore, edhe ato ku institucioni është palë në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, si dhe në grupe pune ndërinstitucionale. Bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Sektorin e Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve dhe drejtoritë rajonale për realizimin e objektivave të sektorit si dhe me drejtorinë juridike në ministrinë e linjës për zbatimin e legjislacionit përkatës.

6.3.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Përfaqësimi i AKU në të gjitha shkallët e gjyqësorit për çështje ku ajo është palë apo palë e interesuar me qëllim mbrojten e interesave të institucionit, me të gjithë të drejtat procedurale të njohura nga ligji;
- Dhënia e asistencës ligjore në nismat dhe propozimet e Autoriteti Kombëtar të Ushqimit për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për fushën ku ushtron funksionet dhe veprimtarinë institucioni;
- Monitorimi për trajtimin e ankimeve administrative;
- Përditësimi me ndryshimet e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht në fushën e ushqimit;
- Dhënie e konsulencës juridike dhe interpretimi i akteve ligjore në fuqi, mbi bazë të kërkesës së strukturave përkatëse pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- Marrja e masave dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të cilat i njohin institucionit të drejta, si dhe ato të cilat e ngarkojnë atë me detyrime; si dhe ndjekja dhe monitorimi nëpërmjet korrespendecës me Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor, vënien në ekzekutim të titujve ekzekutiv.

Detyrat:

Referuar veprimtarisë të kryer nga sektori, ju informojmë si më poshtë mbi:

- Masat administrative të shqyrtuara nga Komisioni i Shqyrtimit të Masave Administrative;
- Proceset gjyqësore (aktive, të përfunduara, të ankimuara) gjatë periudhës janar-dhjetor 2022;
- Kërkesat për Lëshim Urdhri Ekzekutimi të depozituara pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, tërheqja dhe statusi aktual i tyre;
- Masat administrative "gjobë" të arkëtuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Funksionet në kuadër të Komisionit të Ankimit dhe Vlerësimit të Masave Administrative Gjobë

Referuar të dhënave shkresore të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit rezulton se gjatë vitit 2022 janë paraqitur 121 ankime administrative lidhur me masat administrative gjobë.

(Janë për shqyrtim në Ministri 45 ankim).
Janë zbardhur vendimet për **121 ankime.**

- 103 vendime lënie në fuqi;
- 18 shfuqizuar.

Tabela 37. Ankimet për vitet 2021-2022 lidhur me masat administrative gjobë

Viti	Ankime	Vendime
2021	18	32
2022	76	121

Drejtoria e Përgjithshme e AKU ka ndjekur 65 (gjashtedhjetë e pesë) procese gjyqësore:

Gjyq fituese (rrëzim padie) 18 procese gjyqësore;
Pranim padie, 4 procese gjyqësore;
Pranim i pjesshëm, 3 procese gjyqësore;
Vijon procesi për 36 çështje gjyqësore;
Kalim për kompetencë 4 çështje gjyqësore.

Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për periudhën janar-dhjetor 2022 kanë ndjekur në total **133** procese gjyqësore.

Gjyq fituese (rrëzim padie) në 47 procese gjyqësore;
Pranim padie në 37 procese gjyqesore;
Kalim për kompetencë 2 procese gjyqësore;
Vijon procesi për 47 çështje gjyqësore.

Total
Për vitin 2022 janë ndjekur 198 procese gjyqësore;
Gjyq fituese (rrëzim padie) në 65 procese gjyqësore;
Pranim padie në 41 procese gjyqesore;
Pranim i pjesshëm 3 procese gjyqësore;
Kalim për kompetencë 6 çështje gjyqësore.

Vijon procesi për 83 çështje gjyqësore

Tabela 38. Evidencë e procese gjyqësore 2021-2022

Viti	Fituar	Humbur	Në proces	Total
2021	35	20	13	68
2022	65	41	83	198

Kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi

Gjatë vitit 2022 janë përgatitur **251** kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi, pasi është marrë konfirmim për ezaurimin e ankimit administrativ dhe për marrjen dijeni nga ana e subjekteve lidhur me vendimarrjen e Komisionit. Prej tyre **314** janë me vendim pranimi për lëshim urdhër ekzekutimi.

Prej të cilave janë vënë në ekzekutim 264 tituj ekzekutivë pranë zyrave përmbarimore.

Tabela 39. Evidencë mbi çeljen dhe ekzekutimin e urdhrave të ekzekutimit 2021-2022

Viti	Kërkesa për lëshim urdhri	Vendim për lëshim Urdhri Ekzekutimi	Kërkesa për vënie në ezkzekutim	**Arketuar**	Arkëtime gjobash në vlerë monetare
2021	171	118	258	365	40.507.804 lekë
2022	171	242	147	453	49677245 lekë

Likuidimet

Referuar rakordimeve me thesarin komunikuar nga zyra e financës deri me 31 dhjetor rezulton se: Nga zyrat përmbarimore janë ekzekutuar 453 masa administrative në vlerën 49677245 lekë.

Arritjet:

- Drejtoritë Rajonale kanë në strukturë specialist të ngarkuar me ndjekjen e çështjeve gjyqësore;
- Krijimi i database-ve me ankime/vendime 2022;
- Informacion mujor nga zyrat përmbarimore (3-6 mujor) 2022;
- Përgatitja e muanualit të metodologjisë së masave administrative;
- Kontribut në miratimin e Rregullores së re të RASFF;
- Përgatitja e draft-marrëveshjeve të bashkëpunimit me DP-Tatime, QKB, Policinë e Shtetit, QKB;
- Njekja në kohë dhe zbardhja e ankimeve nga KSHA;
- Ndjekja në kohë dhe krijimi i regjistrit nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit;
- Ndjekjen e zbatimit të kontratës së lidhur me AKSH-in për Aku-net;
- Draft-Manualit për Procedurat e Asgjësimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë, Inputeve Bujqësore, Produkte Duhani që nuk plotësojne kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- Draft-Manualit të Inspektimeve në terren dhe në PIK;
- Draft-Manualit të marrjes së mostrave gjatë inspektimeve në terren dhe PIK;
- Draft-Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet AKU dhe AKVMB për Planin e Monitorimit të Qumështit të papërpunuar në fermë;
- Draft-Manuali i Aktit të Vlerësimit të Aktivitetit për Operatorët e Biznesit.
- Gjatë kësaj periudhe sektori është angazhuar në trajtimin dhe dhënien e asistencës juridike sipas kërkesave të drejtorive dhe sektorëve përkatës. Gjithashtu ka kontribuar në hartimin e drafteve ligjore si dhe hartime të dokumenteve të ndryshme manuale/relacione/shkresa për interpretim. Pjesëmarrje në Komisionin e Shqyrtimit të Masave Administrative pranë MBZHR-së, për masa administrative mbi 300.000 lekë, për të cilat janë marrë dhe vendimet përkatëse;
- Ndjek deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit. (ILDKPKI).
- Ndjek, krijon, mban regjistrin e kërkesave dhe kthim përgjigjeve të Kooordinatorit për të Drejtën e Informiomit.

6.3.2 PROBLEMATIKA

- Mbledhja e informacionit nga 2010-2022;
- Mungesa e një database për sa i përket kërkesave të subjekteve (ankimimeve) dhe përgjigjeve nga Komisioni i Ankimimit (për periudhën 2016-2019);
- Mungesa e informacionit në lidhje më ekzekutimin e masave administrative (gjobë) nga zyrat e përmbarimit të cilat kanë sjellë konfuzion në lidhje me informacionin se cila zyrë përmbarimore ndjek arkëtimin e këtyre masave administrative;
- Mosdorëzimi i regjistrit të ankesave nga subjektet ndaj të cilave janë aplikuar masa administrative gjobë (për periudhën 2016-2019). Kjo ka sjellë si pasojë marrjen e vendimit nga ana e Komisionit të Ankimimit përtej afateve të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

6.3.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Rekrutimi i një specialist jurist pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme në çdo drejtori rajonale, për ndjekjen e çështjeve juridike;
- Dhënia e asistencës ligjore në nismat dhe propozimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për fushën ku ushtron funksionet dhe veprimtarinë institucioni;
- Përditësimi me ndryshimet e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht në fushën e ushqimit. Shpërndarja në të gjitha drejtoritë të akteve që dalin në Fletoren Zyrtare që impaktojnë punën e AKU-së;
- Marrja e masave dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të cilat i njohin institucionit të drejta, si dhe ato të cilat e ngarkojnë atë me detyrime;

6.4 SEKTORI I ASISTENCËS TEKNIKE DHE TRAJNIMEVE

Sektori i Asistencës Teknike dhe Trajnimeve siguron identifikimin e nevojave për asistencë teknike dhe nevojave për trajnim të nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si dhe trajnimin e tyre.

6.4.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Zhvillimi profesional i punonjësve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nëpërmjet organizimit të trajnimeve në fusha të ndryshme, në bashkëpunim me organizma të ndryshme si Projekti për Sigurinë Ushqimore, ASPA, BTSF, Inspektorati Qendror etj.;
- Identifikimi i punonjësve të cilët kanë përfituar njohuri profesionale nga pjesëmarrja në trajnime dhe shpërndarja e këtyre njohurive tek punonjësit e tjerë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nëpërmjet organizimit të programit “të trajnuarit trajnojnë”;

Detyrat:

- Janë identifikuar nevojat për asistencë teknike nëpërmjet raportimit nga strukturat përkatëse, të problematikave të evidentuara gjatë shqyrtimit të procedurave të inspektimit;
- Janë ndjekur dhe analizuar nevojat për trajnim në bashkëpunim me strukturat përkatëse, duke përfituar trajnimet e nevojshme për të gjithë punonjësit në Drejtori të Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale;
- Sektori ka shërbyer si pikë kontakti për trajtimet, rritjen e kapacitetit tekniko-profesional të stafit të AKU-së të ardhura nga organizma kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Janë propozuar drejtorive përkatëse, pjesë e stafit të AKU-së, zhvillimin e trajnimeve referuar nevojave të identifikuara për trajnim të trupës inspektuese si edhe trajnimeve/workshop informuese të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU për Operatoret të Biznesit;
- Është hartuar plani vjetor për vitin pasardhës të trajnimeve për stafin e AKU-së.

Sektori i Asistencës Teknike dhe Trajnimeve (ATT) koordinon punën për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve për punonjësit e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Në kuadër të realizimit të objektivave të sektorit, Sektori ATT ka asistuar në krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), The Food Safety Project, BTSF, ISUV, Safial, etj dhe koordinimin e punës më struktura të tjera brenda dhe jashtë AKU-së për organizimin e trajnimeve për punonjësit.

Arritje:
Gjatë vitit **2022** janë trajnuar në total **416 punonjës**, me një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin **2021**, ku janë trajnuar në total **82 punonjës**. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i punonjësve të trajnuar për vitin 2022.

Tabela 40. Numri i punonjësve të trajnuar për vitin 2022

	Numri i punonjësve të trajnuar
BTSF	34
EFSA	1
The Food Safety Project	116
INNVEST	54
FAO	5
Food Safety 4EU	1
SAFIAL	11
ASPA	39
ISUV	35
ISHP	6
AKU	77
Inspektorati Qendror	11
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	9
Të tjera Trajnime	17

Total	416

Në përmbushje të detyrimeve të parashikuara nga rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, një risi për vitin 2022 është **realizimi për herë të parë i programit "të trajnuarit trajnojnë"**, ku janë trajnuar në total **61 punonjës** të AKU-së, për **3 (tri) tema trajnimi**.

I. TRAJNIME NGA BTSF

1. Auditimin i Brendshëm, Bratislavë, Sllovaki, 7- 11 nëntor 2022 (**1 punonjës**);
2. "Gadishmëria ndaj krizave ushqimore", Beograd, Serbi, 27 qershor - 1 korrik (**2 punonjës);**
3. "Higjiena e ushqimit dhe fleksibiliteti" online, 21-25 mars 2022 (**7 punonjës**);
4. "Higjiena e Ushqimit dhe Fleksibilitet" Turin, Itali, 17-21 tetor 2022 **(1 punonjës**);
5. "Kontrolli i materialeve në kontakt me ushqimin, përdorimi i tyre dhe marketing" online 13-17 qershor 2022 (**1 punonjës**);
6. "Kontrolli i materialeve në kontakt me ushqimin, përdorimi i tyre dhe marketing", online 4 - 8 qershor 2022 (**1 punonjës**);
7. "Kontrolli i materialeve në kontakt me ushqimin, përdorimi i tyre dhe marketing", Milan, Itali 26 - 29 shtator 2022 (**1 punonjës**);
8. "Legjislacioni mbi Kontrollin zyrtar" online, 4-8 prill 2022 (**2 punonjës**);
9. "Higjiena e ushqimit në prodhimin primar, Molusqet e gjalla bivalvore" Vigo, Spanjë 30 maj - 3 qershor 2022 (**1 punonjës**);
10. "Vlerësimi i riskut, Sesioni 8", Valencia, Spanjë, 14-18 nentor 2022 (**1 punonjës**);
11. "Përbërja ushqimore dhe informacioni" Valencia, Spanjë,4-8 korrik 2022 (**1 punonjës**);
12. "Përbërja ushqimore dhe informacion", Bratislavë, Sllovaki, 31 tetor - 4 nëntor 2022 (**1 punonjës**);
13. "Rregulloret e kontrollit zyrtar" online, 31 maj - 3 qershor 2022 (**2 punonjës**);
14. "Rregullat e BE në lidhje me kriteret mikrobiologjike dhe monitorimi e kontrolli i zoonozave dhe agjentëve zoonotikë" online, 25 – 28 prill 2022 (**1 punonjës**);
15. "Rregulloret e kontrollit zyrtar" online, 30 maj - 3 qershor 2022 (**1 punonjës**);
16. "Vlerësimi i Riskut Mjedisor", 6-10 Qershor (**1 punonjës**);
17. "Vlerësimi i rrezikut të mikroorganizmave të përdorur si pesticide ose biocide" online, 30 maj -3 qershor 2022 dhe 4 -8 korrik 2022 (**2 punonjës**);
18. "Sistemet e auditit dhe auditimit të brendshëm" online, 4-8 prill 2022 (**1 punonjës**);
19. "Mbështetje për Procesin e Integrimit Evropian Kapitulli 11, 12, 13", 22 shkurt 2022 (**3 punonjës);**
20. "Shpërthimet ushqimore" Bolonja, Itali, 14 -17 qershor 2022 (**2 punonjës**);
21. "Vlerësimii Riskut, Sesioni 8", 12- 16 dhjetor 2022, (**1 punonjës).**

II. TRAJNIME NGA EFSA

1. Edicioni i 3 i Shkollës së Vjeshtës, Osijek, Kroaci, 12-14 tetor 2022 (**1 punonjës**).

III. TRAJNIME NGA PROJEKTI PËR SIGURONË USHQIMORE

1. "Etiketimi i ushqimeve dhe Informimi i Konsumatorit", 11 shkurt 2022, 25 shkurt 2022 dhe 11 mars 2022 (**62 punonjës**);
2. "HACCP training for fish inspectors", 28 dhe 29 shtator 2022 (**22 punonjës**);
3. "Menaxhimi i krizës në lidhje me ushqimin e njerëzve dhe kafshëve", 22 nëntor 2022 (**11 punonjës**);
4. "Vlerësimi dhe përmirësimi i Stabilimente ushqimore (Faza e parë)", 21 shtator 2022 (**13 punonjës**);
5. "Vlerësimi i Sigurisë Ushqimore. Sistemet e Menaxhimit në Stabilimentet e Peshkut", 22 dhe 23 nëntor 2022 (**8 punonjës).**

IV. TRAJNIME NGA INNVEST

1. "Aplikimi i Sigurisë Ushqimore nga Operatorët Ushqimorë, përshtatja e konceptit ligjor në praktikën operacionale", 26 tetor 2022 (**18 punonjës**);
2. "Menaxhimi i Lidershipit për rritje performance dhe manaxhimi në periudha sfidë në nivel lokal dhe kombëtar", 27 tetor 2022 (**18 punonjës**);
3. "Procesi i transformimit dhe komunikimit inovativ per rritjen e performances se organizatës", 28 tetor 2022 (**18 punonjës**).

V. TRAJNIME NGA FAO

1. "Njohuri dhe koncepte për produktet me indikacion gjeografik", 5 tetor 2022 **(5 punonjës).**

VI. TRAJNIME NGA Food Safety 4EU

1. FSO Lab 3rd Workshop, online, 15 nëntor 2022 (**1 punonjës**).

VII. TRAJNIME NGA SAFIAL

1. "Vizitë Studimore e Delegacionit Shqiptar për çështjet e sigurisë ushqimore" CIHEAM, Bari, Puglia, Naples, 27 qershor - 1 korrik 2022 dhe 4 -7 korrik 2022 (**11 punonjës**).

VIII. TRAJNIME NGA ASPA

1. "Regjistri i Përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB-ve) në fermë", online, 14 shtator 2022 (**37 punonjës**);
2. "Siguria Ushqimore, veterinaria, mbrojtja e bimëve dhe sfidat e shtetit Shqiptar në kuadër të procesit të integrimit evropian", 13- 15 janar 2022 (**2 punonjës**).

IX. TRAJNIME NGA ISUV

1. "Numërimi i E. coli B-glukonidaze pozitive, teknika e numërimit në pjatë", "Numërim i Enterobakterve në ushqime dhe ushqime për kafshë, teknika e numërimit në pjatë", "Numërim

i mikroorganizmave në ushqime dhe ushqime për kafshë, teknika e numërimit të kolonive në 30 gradë", 24-26 tetor 2022 (**14 punonjës**);
2. "Teknika e numërimit të Staphylococcus kosgulaze pozitive, numërimit me pjatë", 24-26 tetor 2022 (**14 punonjës**);
3. "Programi i Trajnimit për laboratorët e Shëndetit dhe Mirëqënies së Kafshëve", 8-10 nëntor 2022 (**7 punonjës**).

X. TRAJNIME NGA ISHP

1. "Përgjigja dhe përgatitja ndaj shpërthimeve zoonotike", 13-15 tetor 2022 (**4 punonjës**);
2. "Workshop mbi Vlerësimin Strategjik të Riskut në Shqipëri", 15-16 nëntor 2022 (**2 punonjës**).

XI. TRAJNIME NGA AKU

1. Rritja e efikasitetit të kontrolleve zyrtare në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të imputeve bujqësore dhe veprimtarisë prodhuese të duhan-cigareve", i organizuar nga Sektori i Koordinimit të Kontrollit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore në DPAKU në datat 21 qershor, 22 qershor dhe 28 qershor 2022 (**16 punonjës**);
2. Moduli "të trajnuarit trajnojnë" mbi temën "Sistemi TRACES - Përdorimi i TRACES për kontrollin e importit të bimëve të gjalla" online, 7 nëntor 2022 (**19 punonjës**);
3. Moduli "të trajnuarit trajnojnë" mbi temën "Menaxhimi i lidershipit për rritjen e performancës dhe menaxhimi në periudha sfidën në nivel lokal dhe kombëtar", 21 dhjetor 2022 (**37 punonjës**);
4. Moduli "të trajnuarit trajnojnë" mbi temën "Shpërthimet Ushqimore", 1 gusht 2022 (**5 punonjës**).

XII. TRAJNIME NGA INSPEKTORATI QENDROR

1. Trajnimi i inspektorëve në periudhë prove mbi modulin e përdorimit të sistemit e-Inspektimi dhe modulin e AKU-së (**11 punonjës**).

XIII. TRAJNIME NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

1. "Standardet IPSAS nga MFE", 9 nëntor 2022, 8-11 nëntor 2022, 14-17 nëntor 2022, 21-24 nëntor 2022 (**9 punonjës**).

XIV. TË TJERA TRAJNIME

1. "Pajtueshmëria me SPS në prodhimet e freskëta" SHBA, 14 - 17 shtator 2022 (**1 punonjës**);
2. "Workshop për Rritjen e Efikasitetit të Zbatimit të OAE duke rritur pjesëmarrjen e agjencive të tjera kufitare", Shkup Maqedoni, 23-24 nëntor 2022 (**2 punonjës**);
3. "Metodat laboratorike për sëmundjet që lidhen me programet e kontrollit në vend", IAEA TC Project 21-25 nëntor 2022 (**9 punonjës**);

4. “Fuqizimi i kapacitetit të vendeve te Ballkanit Perëndimor për përgatitjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave nukleare dhe radiologjike: Mbështetje Teknike për vendimmarrjen"(6-7 dhjetor 2022), organizuar nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile (AKMC) dhe Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ) **(2 punonjës**);
5. Workshopi mbi “Sëmundjen e Murtajës Afrikane të Derrave” ASF, 13 dhe 16 qershor 2022, organizuar nga AKU, AKVMB, ISHP (**3 punonjës**).

Grafiku. 14 Trajnime për vitin 2022



6.4.2 PROBLEMATIKA

- Mungesa e një database të trashëguar para vitit 2022, ku të jenë të pasqyruara të dhëna për trajnimet e kryera për punonjësit e AKU-së, duke lehtësuar në këtë mënyrë krahasimin midis viteve;
- Mungesa e një sistemi, ku mund të hidhen dhe të përditësohen të dhëna të automatizuara për trajnimet e punonjësve dhe mund të gjenerohen raporte.

6.4.3 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Identifikimi ë bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të nevojave për trajnim;
- Realizim trajnimesh nëpërmjet platformave online, ëebex, zoom, etj.;
- Realizimin e programit “Të trajnuarit trajnojnë”, për të gjitha trajnimet e kryera nga BTSF kryesisht por edhe të tjera;
- Përmirësimin e infrastrukturës teknike për realizim trajnimesh.

7 SEKTORI I BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar siguron përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore dhe të gjithë burimeve financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

7.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJET KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Hartimi i pasqyrave të detajuara të Projekt Buxhetit Afatmesëm (PBA) 2024-2026;
- Monitorimi i likuidimeve të debitorëve, arkëtimet nga masat administrative (gjobat);
- Monitorimi i vlerave material;
- Realizimi i buxhetit vjetor. Organizimi dhe koordinimi i punës për të siguruar përdorimin me efektivitet të lartë të burimeve financiare dhe buxhetit të akorduar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Realizimi i raporteve vjetore dhe periodike financiare që lidhen me çështje të zbatimit të buxhetit apo të menaxhimit të burimeve financiare;
- Monitorimi i vlerave materiale. Zbatimi i rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtorive Rajonale, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave.
- Hartimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor;
- Rritja e kapaciteteve tekniko - profesionale të punonjësve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.

Detyrat:

Në kuadër të gjithë aktivitetit te Autoritetit Kombëtar te Ushqimit, Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ka realizuar detyra të tilla si:

- Ka organizuar punën për përgatitjen, hartimin dhe monitorimin e Projekt Buxhetit afat-mesëm si dhe hartimin dhe zbatimin e Buxhetit Vjetor në përputhje me kërkesat e Ligjit Organik të Buxhetit dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit" në nivel qendror dhe rajonal;
- Ka siguruar menaxhimin e shpenzimeve, duke ofruar menaxhim efektiv dhe ka mbështetur punën e sektorëve/zyrave të financës në Drejtoritë Rajonale AKU-së për çështje që lidhen me menaxhimin buxhetor dhe të shpenzimeve të paguara;
- Përgjigjet për administrimin dhe shpenzimin e fondeve buxhetore në funksion të misionit dhe të përmbushjes së objektivave për Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, ndjekjen dhe realizimin e tyre në bashkëpunim me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit në ministrinë e linjës;
- Ka menaxhuar shpenzimet e alokuara për Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, përfshirë dhe rialokimet sipas kërkesave të Drejtorive Rajonale të AKU-së apo ndryshimeve të ndodhura me akte ligjore e nënligjore që kanë kosto financiare duke zbatuar rigorozisht udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit vjetor;
- Ka përgatitur raportet vjetore dhe periodike financiare që lidhen me çështje të zbatimit të buxhetit apo të menaxhimit të burimeve financiare sipas kërkesave të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit drejtues të AKU-së;
- Ka organizuar punën për hartimin e regjistrit të aktive në nivel qendror dhe rajonal, bazuar në kriteret e vendosura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

- Ka përpunuar pasqyrat përmbledhëse financiare të shpenzimeve dhe të ardhura buxhetore si AKU dhe në nivel qendror dhe rajonal;

Arritjet:

Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si njësi bazë mbështetëse e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ka punuar për vënien në jetë të gjithë angazhimeve përkatëse funksionale për realizimin sa më mirë të objektivave të këtij institucioni.

- Në mbështetje të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit "Për Buxhetin e Vitit 2022", në fillim të vitit 2022, u krye përgatitja e buxhetit të detajuar sipas zërave të shpenzimeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme si dhe u ndihmuan Drejtoritë Rajonale për detajimin e këtij buxheti. Kjo shpërndarje u bë në përputhje me objektivat e AKU-së dhe mundësitë e fondeve të akorduara nga MBZHR, me qëllim realizimin sa më mirë të objektivave;
- Brenda afateve ligjore të përcaktuara u krye mbyllja e llogarisë vjetore të vitit 2021, (Pasqyrave Financiare), të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të AKU. Mbi këtë bazë u krye dhe mbyllja e pasqyrave të konsoliduara të gjendjes financiare të gjithë AKU;
- Në mbështetje të tavaneve të miratuara nga MFE dhe MBZHR, bazuar në kërkesat e sektorëve përkatës për fonde buxhetore si dhe në prioritetet për realizimin e objektivave të AKU-së si pjesë e programit të "Sigurisë ushqimore" të MBZHR, në periudhën mars-prill 2022 u hartuan pasqyrat e detajuara të projekt-buxhetit 2023-2025 për Drejtorinë e Përgjithshme dhe për Drejtoritë Rajonale të AKU-së (faza e parë), të cilat u raportuan brenda afateve ligjore në MBZHR. Në periudhën korrik-gusht 2022, u hartuan pasqyrat e detajuara të projekt-buxhetit 2023-2025 (faza e dytë) për Drejtorinë e Përgjithshme dhe për Drejtoritë Rajonale të AKU-së, te cilat u raportuan ne MBZHR Brenda afateve. Në muajin nëntor 2022, u hartuan pasqyrat e detajuara të projekt-buxhetit 2023-2025 (faza e tretë) për Drejtorinë e Përgjithshme dhe për Drejtoritë Rajonale të AKU-së, te cilat u raportuan në MBZHR;
- Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kuadrin normativ si edhe nevojat e institucionit, janë menaxhuar me efikasitet fondet buxhetore të akorduara për AKU.

Tabela 41. Fondet e Akordura dhe të Realizuara gjatë vitit 2022

Llogaria Ekonomike	***Buxheti fillestar***	***Ndryshimet gjate vitit***		***Buxheti total plan viti 2022***	***Realizimi i Buxhetit (2022)***	***Realizimi (%)***
		Shtesa	Pakësim			
600	349,500,000	5,730,000	30,291,233	324,938,767	324,869,028	99.98%
601	59,500,000	859,000	6,072,000	54,287,000	54,144,412	99.74%
602	117,800,000	7,600,000	12,828,000	112,572,000	111,926,157	99.43%
606	1,400,000	6,683,000	1,079,000	7,004,000	6,544,000	93.43%
231	104,755,000		101,155,000	3,600,000	2,256,000	62.67%
Totali	**632,955,000**	**20,872,000**	**151,425,233**	**502,401,767**	**499,739,597**	**99.47%**

Realizimi i zërave të buxhetit në vitin 2022 është ***99.47%,*** një rezultat shumë i mirë.

Tabela 42. Realizimi i buxhetit sipas Njësive shpenzuese 2022

NR	*Emri institucionit*	*TOTALI I BUXHETIT*		*% e realizimit*
		Plan	**Fakt**	
1	AKU Qendrore	**172,522,000**	**170,681,744**	**98.93**
2	Drejtoria Rajonale Berat	**18,328,300**	**18,311,224**	**99.91**
3	Drejtoria Rajonale Diber	**15,425,380**	**15,405,039**	**99.87**
4	Drejtoria Rajoanle Durres	**34,912,200**	**34,846,691**	**99.81**
5	Drejtoria Rajonale Elbasan	**24,030,500**	**23,880,194**	**99.37**
6	Drejtoria Rajonale Fier	**21,941,700**	**21,891,370**	**99.77**
7	Drejtoria Rajonale Gjirokaster	**26,753,100**	**26,747,798**	**99.98**
8	DrejtoriaRajonale Korce	**35,640,232**	**35,521,860**	**99.67**
9	Drejtoria Rajonale Kukes	**19,085,005**	**19,040,365**	**99.77**
10	Drejtoria Rajonale Lezhe	**17,761,400**	**17,683,789**	**99.56**
11	Drejtoria Rajonale Shkoder	**26,527,650**	**26,447,780**	**99.70**
12	Drejtoria Rajonale Tirane	**60,048,600**	**60,043,534**	**99.99**
13	Drejtoria Rajonale Vlore	**29,425,700**	**29,238,209**	**99.36**
TOTALI		**502,401,767**	**499,739,597**	**99.47**

REALIZIM I BUXHETIT VITIT 2022 SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE DHE NJËSIVE SHPENZUESE

- **Realizimi i buxhetit për vitin 2022 në llogarinë 600 dhe 601** është në masën 99.98% dhe 99.74% , fondi i shfrytëzuar është përdorur për 418 punonjës nga 433 punonjes me strukturë të AKU-së, si dhe janë paguar 4 punonjës me kontratë të miratuar për periudhën Shkurt - Dhjetor 2022, gjatë vitit 2022 janë bërë rialokime të fondeve në këto llogari.

- **Realizimi i buxhetit për vitin 2022 në llogarinë 602** është në masën 99.43 %, dhe vlerë **111.926.157lekë.** Janë realizuar kontratat e lidhura gjatë vitit 2022 nga Autoriteti kombëtar i Ushqimit

  - **Realizimi i buxhetit në vitin 2022 në llogarinë 231**, është në masën 62.67%

    Realizimi i Investimeve të brendshme për vitin 2022 sipas projekteve paraqitet si më poshtë:

- Pajisje specifike për grupin e inspektimit Vlerë (45,000,000 lekë),
- Blerje pajisje laboratorike Vlerë (56,155,000 lekë),
- Pajisje ftohëse dhe ngrirës (frigorifer), (Sektorët e Lab. dhe PIK) Vlerë (3,600,000 lekë)

Gjatë vitit 2022 eshte realizuar investimi "Pajisje ftohëse dhe ngrirës (frigorifer)", (Sektorët e Lab. dhe PIK), dy projektet e investimeve të tjera do të realizohen gjatë vitit 2023.

REALIZIM I BUXHETIT TË VITIT 2022 DUKE U KRAHASUAR ME REALIZIMIN E BUXHETIT VITI 2021 SIPAS LLOGARIVE

Realizimi i zërave buxhetor sipas llogarive për vitin 2022 dhe krahasuar me vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Tabela 43. Realizimi i buxhetit i vitit 2021-2022

Llogaria Ekonomike	*VITI 2021*			*VITI 2022*		
	Plan Buxheti	*Realizimi*	*Realizimi (%)*	*Plan Buxheti*	*Realizimi*	*Realizimi (%)*
600	340,491,354	335,978,978	98.67%	324,938,767	324,869,028	99.98%
601	56,937,138	56,073,123	98.48%	54,287,000	54,144,412	99.74%
602	124,470,000	118,949,764	95.57%	112,572,000	111,926,157	99.43%
606	1,540,000	897,524	58.28%	7,004,000	6,544,000	93.43%
231	2,496,000	2,496,000	100.00%	3,600,000	2,256,000	62.67%
Totali	**525,934,492**	**514,395,389**	**97.81%**	**502,401,767**	**499,739,597**	**99.47%**

Grafiku nr.17: Realizimi i buxhetit i vitit 2021-2022



TË ARDHURAT

Në aktivitetin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit një zë me vete janë dhe arkëtimi i të ardhurave në buxhetin e shtetit nga aktiviteti i Drejtorive Rajonale në lidhje me kontrollet e kryera pranë pikave të kalimit kufitar, gjobat (masat administrative), analizat laboratorike, etj.

Të ardhurat nga aktiviteti i AKU shkojnë 100 % në buxhetin e shtetit. Arkëtimet e të ardhurave ndryshojnë sipas rajoneve. Në drejtoritë rajonale të Shkodrës, Tiranës, Durrësit, Korçës, Gjirokastrës dhe Kukës niveli i të ardhura është i lartë, kjo si rezultat nga specifikës se pikat e kalimit kufitar janë me fluks të lartë të hyrjeve e daljeve të mallrave nga subjektet ekonomike të vendit.

TË ARDHURAT E REALIZUARA SIPAS NJËSIVE SHPENZUESE PËR VITIN 2021 DHE VITI 2022

Tabela 44. Realizimi i të ardhurave sipas njësive shpenzuese

Institucioni	2021	2022
AKU Qendrore	36,240	59,800
Drejtoria Rajonale Berat	3,823,401	3,360,075
Drejtoria Rajonale Diber	1,272,508	1,063,720
Drejtoria Rajoanle Durres	29,443,902	28,805,455
Drejtoria Rajonale Elbasan	2,669,421	4,091,725
Drejtoria Rajonale Fier	3,687,981	7,672,920
Dr. Rajonale Gjirokaster	15,161,753	16,402,320
DrejtoriaRajonale Korce	16,286,568	17,968,610
Drejtoria Rajonale Kukes	9,886,929	7,649,149
Drejtoria Rajonale Lezhe	1,340,000	1,442,000
Drejtoria Rajonale Shkoder	23,673,327	20,820,228
Drejtoria Rajonale Tirane	17,517,086	12,650,597
Drejtoria Rajonale Vlore	4,505,993	8,008,060
TOTALI	**129,305,109**	**129,994,659**

Të ardhurat e vitit 2022 duke bërë krahasimin siç shikohet dhe grafikisht të ardhurat janë në trend rritës krahasuar me vitit 2021

Për efekt të impaktit që kanë në veprimtarinë e AKU po ju paraqesim një analizë të shkurtër të te ardhurave nga Gjobat (masat administrative te AKU).

TË ARDHURAT NGA MASAT ADMINISTRATIVE E REALIZUARA SPAS NJËSIVE SHPENZUESE TË AKU TË KRAHASUARA ME VITIN 2021 PARAQITEN SI MË POSHTË:

Tabela 45. Të ardhurat nga masat administrative e realizuara sipas njësive shpenzuese te AKU

VITI 2021-2022					
NR	Institucionet	Gjoba te arketuara		Vlera e gjobave te arketuara	
		2021	2022	2021	2022
1	Drejtoria Rajonale Berat	43	70	3,807,401	3,258,620

2	Drejtoria Rajonale Elbasan	15	20	1,850,000	3,036,750
3	Drejtoria Rajonale Lezhe	18	22	603,000	534,000
4	Drejtoria Rajonale Diber	7	6	980,108	812,100
5	Drejtoria Rajonaleu Shkoder	23	13	2,395,000	3,572,300
6	Drejtoria Rajonale Tirane	99	116	15,744,635	10,917,740
7	Drejtoria Rajonale Korce	42	62	3,449,105	5,802,620
8	Drejtoria Rajonale Gjirokaster	3	18	170,000	2,409,500
9	Drejtoria Rajonale Vlore	21	43	2,068,200	5,415,000
10	Drejtoria Rajonale Durres	42	27	5,149,955	6,024,815
11	Drejtoria Rajonale Kukes	9	5	760,000	480,000
12	Drejtoria Rajonale Fier	41	51	3,530,400	7,413,800
Totali		**363**	**453**	**40,507,804**	**49,677,245**

Nga informacioni i mësipërm arkëtimet nga masat administrative në vitin 2022 duke u krahasuar me viti 2021 kanë një rritje si në numër të masave administrative (gjoba) si në vlere.

- Gjatë gjatë vitit 2021 janë arkëtuar nga gjobat **363 gjoba** në vlerë **40.507.804lekë**
- Gjatë gjatë vitit 2022 janë arkëtuar nga gjobat **453 gjoba** në vlerë **49.677.245 lekë**

7.1.2 PROBLEMATIKAT

Në mbyllje të llogarive vjetore u konstatuon dis amangasi në llogaritë inventariale si më poshtë:

- Klasa 3, "Aktivet afatshkurtra jo financiare (inventarët)", nga gjendjet ne inventar shikohen disa artikuj të trashëguar nga vitet e kaluara ne zbatim të udhëzimit nr 8 date 09.03.2018 i Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë, *Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit, si rregull në datën e mbylljes së bilancit. Kërkesa e vlerësimit me vlerë më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme detyron njësinë ta regjistrojë në kontabilitet si humbje nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh. Inventari çregjistrohet atëherë kur shitet, kur dhurohet, por ai çregjistrohet edhe kur nuk ka vlera ekonomike për të ardhmen (p.sh., inventari i vjetruar)",* referuar kësaj pike të bëhet sistemin i ë dy llogarive inventariale Llogaria 31, "Materiale", Llogaria 32, "Inventar i imët"; duke respektuar te gjitha procedurat ne zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011," Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- Klasa 2," Aktive Afatgjata materiale", nga analiza e regjistrit të aktiveve disa llogari dalin me vlere te mbetur 0, nisur nga ky fakt te behet rivlerësimi duke respektuar te gjitha procedurat ne zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, respektivisht ne Llogarite 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe Llogarinë 215 "Mjete Transporti" Për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" të behet evidentimi për pajisjet "Pajisje kompjuteri" & Fotokopje (printer, skaner) të bëhet vlerësim i

pajisjeve të cilat janë gjendje në magazinë dhe informacioni i detajuar të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme.

- Mungesa e hartimit të regjistrit të riskut mbi realizimin e objektivave për vitin 2022, nga një pjesë e drejtorive në DP.AKU, ato janë të hartura nga Sektori i Buxhetit dhe menaxhimit Financiar si dhe Sektori i Auditit.

7.1.3 REKOMANDIME PER PERMIRESIM

- Hartimi i një procedure të shkruar për inventarizimin, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përfshirë dhe informacionin që duhet ti paraqitet vendimarrësit për aprovim;
- Hartimi i regjistrit të riskut per vitin 2023.

8 SEKTORI I AUDITIMIT TE BRENDSHËM

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm si veprimtari e pavarur mbështet menaxhimin e Lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së dhe të Drejtorive Rajonale të AKU-së, për arritjen e objektivave të tyre, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

8.1.1 OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE ARRITJRT KRYESORE TË SEKTORIT KONSISTOJNË NË:

Objektivat:

- Angazhim për zbatimin e planit;
- Vlerësimi i ngritjes dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm sipas sistemeve;
- Kualifikimi i vijueshëm i stafit;
- Zbatimi i standardeve të auditimit;
- Rritjen e besueshmërisë, objektivitetit, pavarësisë në veprimtarinë e saj audituese;
- Këshillimet e specializuara dhe profesionale gjatë gjithë procesit të auditimit.

Detyrat:

Të japë siguri të arsyeshme nëse:

- Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- Burimet financiare janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Aktivet janë ruajtur dhe mirëmbajtur;
- Veprimtaritë e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale të AKU-së janë në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe udhëzimet e miratuara;
- Objektivat kryesore të përcaktuara në programet dhe planet e punës janë arritur;
- Rekomandimet e dhëna kanë qenë cilësore dhe eficiente për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së strukturave të audituara.

Arritjet:

Gjatë vitit 2022, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka kryer gjithsej **8 (tetë)** misione auditimi, nga të cilat **7** (**shtatë**) prej tyre janë sipas planit vjetor, ndërsa **1 (një)** auditim është me urdhër të Menaxhimit të Lartë:

1) **Auditime të Kombinuar (Përputhshmërisë dhe Financiare)**

   a. Drejtoria Rajonale e AKU-së Shkodër;
   b. Drejtoria Rajonale e AKU-së Kukës;
   c. Drejtoria Rajonale e AKU-së Durrës;
   d. Drejtoria Rajonale e AKU-së Dibër;
   e. Drejtoria Rajonale e AKU-së Lezhë;

2) **Auditime të Pëputhshmërisë**
   a) Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së (***me urdhër të Menaxhimit të Lartë,*** për "Shpenzime për udhëtime dhe dieta, për periudhën Janar 2019-Dhjetor 2021");
   b) Drejtoria e Vlerësimit të Riskut, Laboratorët pranë Drejtorive Rajonale të AKU Gjirokastër, Shkodër, Korçë;
   c) Zbatimi i rekomandimeve.

Më poshtë në mënyrë tabelare ndodhet "Realizimi i programit të auditimeve për vitin 2022" si dhe "Planifikimi dhe realizimi i fushave të audituara".

Tabela 46. Realizimi i programit të auditimeve për vitin 2022

Viti	Auditime të realizuara gjithsej	Auditime të realizuara sipas programit	Auditime me kërkesë të Menaxhimit të Lartë	Auditime të programuara
2022	8	7	1	8

Tabela 47. Planifikimi dhe realizimi i fushave të audituara

Subjekti audituar	Planifikuar		Realizimi	
	Lloji auditimit	Sisteme / fusha për auditim	Lloji auditimit	Sisteme / fusha të auditara
Zbatimi i rekomandimeve për vitet 2020-2021	I përputhshmërisë	1	I përputhshmërisë	1
DR AKU Shkodër	I kombinuar	12	I kombinuar	12
DR AKU Kukës	I kombinuar	12	I kombinuar	12
DR AKU Durrës	I kombinuar	12	I kombinuar	12
DRAKU Dibër	I kombinuar	12	I kombinuar	12
DR AKU Lezhë	I kombinuar	12	I kombinuar	12
DRAKU Berat	I kombinuar	5	I kombinuar	5
Laboratorët Korçë, Shkodër, Gjirokastër	I përputhshmërisë	1	I përputhshmërisë	1
Drejtoria e Përgjithshme	I përputhshmërisë	1	I parealizuar	
Total sisteme / fusha		**68**		**67**

8.1.2 PROBLEMATIKAT

Gjatë veprimtarisë së tij audituese stafi i njësisë së AB ka evidentuar elementet e dobët dhe jo funksional të sistemit të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, frytshmëri të fondeve publike, mbledhjes së të ardhurave si dhe proceseve. Nga kjo veprimtari gjetjet kryesore të rezultuara sipas sistemeve fushave janë:

- Në fushën e procedurave të inspektimit, në terren;
- Në realizimin e planeve të inspektimit dhe marrjes së mostrave;
- Në proceset e notifikimit të etiketave;
- Në ndjekjen e procedurave për arkëtimin e gjobave të aplikuara;
- Në fushën e prokurimeve publike dhe administrimit të karburantit;
- Në përllogaritje e normave të amortizimit;
- Në fushën e aplikimit të tarifave për shërbimet në PIK;
- Në funksionimin e Komisionit të Ankimimit;
- Në monitorimin e realizimit të planeve të inspektimit dhe marrjes së mostrave nga DP;
- Në sistemin për ruajtjen, administrimin e aktiveve si dhe dokumentacionit dhe arkivimin e tij;
- Në fushën e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në të gjithë elementët e tij;
- Në marrjen dhe dorëzimin e detyrës;

- Në zbatimin e rekomandimeve.

Për periudhën raportuese gjetjet me dëm ekonomik arrijnë në shumën 690.611 lekë, e cila është e ndarë sipas fushave apo sistemeve si më poshtë:

- Në fushën e administrimit i karburantit: → 247.958 lekë
- Debitorë: → 216.808 lekë
- Në fushën e prokurimeve: → 119.345 lekë
- Në fushën e Pagave: → 30.000 lekë
- Në fushën e tarifave: → 6.700 lekë
- Në fushën e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta: → 43.850 lekë
- Të tjera (mosrakordime, magazinë dhe të ardhura): → 25.950 lekë

Grafiku. 15 Gjetjet në vlerë me dëm ekonomik, ndarë sipas fushave



➢ ***Si gjetje tjetër që evidentohet nga misionet e auditimeve janë konstatuar edhe gjetje, pa dëm ekonomik, respektivisht"***

a) Në përllogaritje të gabuara të amortizimit të aktiveve afat gjatë, respektivisht sipas DRAKU-ve;

b) Në shkeljen e disiplinës financiare, për rastet e mos paraqitjes në librat e kontabilitetit të aktiveve të marra në dorëzim, respektivisht sipas DRAKU-ve;

c) Gjetje për shkelje të disiplinës financiare që kanë të bëjnë me kontabilizim të gabuar të llogarive të aktiveve.

Tabela 48. Përllogaritje të gabuara amortizimi, shkelje e disiplinës financiare e kontabilizim i gabuar

Drejtoritë Rajonale	Llogari amortizimi	Shkelje displinës financiare	Kontabilizime të gabuara
DRAKU Shkodër	1,022,858	26,600	119,308
DRAKU Korçë	1,022,858		
DRAKU Gjirokastër	666,507		
DRAKU Durrës	29,908	165,600	
DRAKU Kukës		1,922,409	
DRAKU Dibër		509,760	
DRAKU Lezhë		108,300	
Totali	**2,742,131**	**2,732,669**	**119,308**

8.1.3 REKOMANDIME PËR PERMIRËSIM

Gjatë ushtrimit të funksionit dhe veprimtarisë së saj njësia e AB i ka kushtuar një rëndësi të veçantë momentit të dhënies së rekomandimeve me synimin përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe veprimtarisë së subjekteve të vartësisë për arritjen e objektivave. Në përgjithësi rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2022 do të klasifikoheshin sipas grupeve të mëposhtme:

- ✓ Rekomandime për përmirësimin e sistemeve;
- ✓ Rekomandime për masa organizative;
- ✓ Rekomandime për masa zhdëmtim dëmi.

Për vitin 2022 nga stafi auditues, për subjektet e audituara janë dhënë gjithsej **192** rekomandime.

Tabela 49. Rekomandimet e dhëna për ç'do subjekt të audituar

Drejtoritë e Audituara	Rekomandime për përmirësimin e sistemeve	Rekomandime për masa organizative	Rekomandime për masa zhdëmtim dëmi	Totali i Rekomandimeve
DPAKU	2	4	0	6
DRAKU Lezhë	0	24	2	26
DRAKU Shkodër	2	23	1	26
DRAKU Kukës	3	23	6	32
DRAKU Dibër	5	26	12	43
DRAKU Durrës	1	28	9	38
Shërbimet Laboratorike Korçë, Shkodër, Gjirokastër	0	21	0	21
Totali	**13**	**149**	**30**	**192**

9 NËNKOMITETET DHE PROJEKTET

9.1 NËNKOMITETI

Është zhvilluar në Tiranë, takimi i 10-të i Nënkomitetit MSA, Shqipëri-BE për bujqësinë dhe peshkimin. Në qendër të takimit diskutimi mbi zbatimin e MSA-së dhe përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me BE-në, në fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke përfshirë sektorë të ndryshëm prioritarë si siguria ushqimore, sektori veterinar dhe peshkimi.

Gjatë nënkomitetit u evidentua se Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në fushat e sigurisë ushqimore, veterinare, në rritjen e kontrollit të sëmundjeve të kafshëve dhe bimëve.

Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së prezantoi punën e bërë nga stafi AKU së, në bashkëpunim me Projektin Food Safe për rritjen e sigurisë ushqimore, identifikimin e riskut nëpërmjet një metodologjie europiane të hartuar me asistencë nga Projekti "Mbeshtetje për Sigurine Ushqimore, standartet veterinare dhe fitosanitare në Shqiperi", rritjen e subjekteve që implementojnë planin HACCP.

Vlerësimi i operatorëve të bisnesit ushqimor për Planin Zyrtar 2023 është kryer sipas një metodologjie të re të hartuar me asistencë nga Projekti "Mbështetje për sigurinë ushqimore,

standardet veterinare dhe fitosanitare në Shqipëri". Kjo metodologji konsiston në kategorizimin e riskut të OBU –ve me risk të ulët, të mesëm ose të lartë në varësi të riskut që lidhet me aktivitet e tyre dhe faktorëve të tjerë ndikues duke përdorur një sistem pikëzimi. Në ndryshim nga metodologjia e përdorur në vitet e mëparshme, në këtë metodologji frekuenca e inspektimit varion në varësi të llojit te stabilimentit, dhe për të njëjtën kategori/nënkategori/aktivitet specifik të biznesit ushqimor ka jo më një profilizim te unifikuar të riskut, por vlerësimi i riskut është individual për cdo OBU duke u bazuar në historikun e tij. Sipas metodologjisë së re është kryer vlerësimi individual për 21 292 operatorë biznesi ushqimorë, sipas kesaj metodologjie duhet të kryhen rishikime të vlerësimeve të riskut për të gjitha stabilimentet në bazë vjetore (ose më shpesh nëse nevojitet, p.sh., në rastin e konstatimit të mospërputhshmërisë së konsiderueshme, ndryshimit të aktiviteteve).

Gjithashtu, procedura e inspektimit kryhet nëpërmjet sistemit online "e-inspection" sipas akteve përkatëse të procedurës së inspektimit bazuar në kërkesat e ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" si më poshtë:

• Autorizimi i Inspektimit

• Lista kontrolluese përkatëse

• Të dhënat e inspektimit

• Vendimi përfundimtar

U raportua për: numrin e inspektimeve në terren dhe masave administrative, të cilat në vitin 2022 paraqiten me tregues më të lartë rritjen e numrit të eksporteve të peshkut, menaxhimin e sistemit RASSF.

Çdo person i pajisur me licencë tregtimi me shumicë, që kërkon të importojë PMB të klasifikuara "PMB të rrezikshme" dhe "PMB me rrezik të lartë", duhet të njoftojë me parë SPMB-në për çdo ngarkesë. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:

- Emrin tregtar të PMB-së;
- Numrin dhe datën e regjistrimit;
- Emrin e lëndës/ve vepruese;
- Emrin e mbajtësit të dokumentit të regjistrimit (aplikantit);
- Emrin e prodhuesit;
- Sasinë;
- Vendin e origjinës, ku është prodhuar;
- Vendin nga importohet.

- Njoftimi nga OB bëhet 1 deri në 3 ditë pune përpara datës së hyrjes së tyre në Republikën e Shqipërisë.

- Inspektori i mbrojtjes së bimëve në pikat e kalimit kufitar (PIK), në zbatim të këtij vendimi, ka për detyrë:

- Të kontrollojë e të verifikojë çdo parti PMB-je që hyn për t'u përdorur në Republikën e Shqipërisë dhe t'i evidentojë ato në një libër të veçantë, sipas shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- Të ndalojë hyrjen në Republikën e Shqipërisë të PMB-ve të paregjistruara dhe kur vëren shkelje në lidhje me etiketimin e ambalazhimin e tyre;
- Pasi PMB-të në PIK kontrollohen nga inspektorët dhe rezultojnë se plotësojnë kërkesat ligjore lejohen të kryhen procedurat doganore dhe nga OB, PMB-te magazinohen në njësitë e tregtimit me shumicë të tyre.

Në Repunblikën e Shqipërisë lejohet tregtimi me shumicë i PMB-ve të regjistruara.

Detyrat nga Nën Komiteti:

1. Përmirësime të të dhënave statistikore;
2. Rivitalizim i sistemit AKU net;
3. Analizimi i qumshtit lëndë e parë në fermë në bashkëpunim me AKVMB.

9.2 PROJEKTET

Projekti SAFIAL - Nisma ka si synim t'u mundësojë shqiptarëve përdorimin e produkteve ushqimore me nivel të përmirësuar sigurie, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Autoriteteve shqiptare që kryejnë kontrolle dhe inspektime mbi materialin me origjinë bimore në kufi dhe në sektorin veterinar. Projekti është realizuar bazuar në kërkesën e Ministrisë Shqiptare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Protokolli i Bashkëpunimit për Zhvillimin e Shqipërisë, kërkohet të mbështesë forcimin e standardeve të higjienës ushqimore në Shqipëri dhe forcimin e shërbimit veterinar.

Objektivat kryesore të projektit janë:

- Të mbështesë AKU-në me qëllim rritjen e kapaciteteve për kryerjen e inspektimeve efikase të produkteve ushqimore që hyjnë në portin e Durrësit përmes **rinovimit të pikës së kontrollit kufitar** duke zbatuar standardet e BE-së;
- Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve shqiptare (ISUV, AKU, AKVMB) për verifikimin e shkallës së sigurisë dhe kryerjen e ekspertizave laboratorike në ushqimet me origjinë bimore (mbetje pesticidesh, metalet e rënda, mykotoksinat) dhe për diagnostikimin e organizmave të mundshme karantinore;
- Trajnime dhe asistencë teknike për MBZHR, AKU në, AKVMB;

Aktivitetet kryesore të Projektit në AKU, gjatë vitit 2022 janë përqëndruar në:

- Ndërtimin e pikës kufitare Durrës me cilësi dhe standarde Evropiane. Po implementohet ndërtimi i një kapanoni të lëvizshëm, zyra për Inspektorët e Kontrollit në Pikën e Inspektimit Kufitar AKU Port Durrës. Punimet kanë filluar në fund të muajit nëntor 2022 dhe parashikohen të përfundojnë në muajin Mars 2023.

- Ka filluar furnizimi me pajisje në laboratorin e AKU-së në Durrës, të cilat do të instalohen brenda muajit janar dhe në muajin shkurt parashikohet trajnimi i stafit. Nga ky trajnim do të përfitojë i gjitha stafi i laboratorëve të AKU-së.

Projekti i Bnakës Botërore për Bujqësinë

Me inciativë të MBZHR-së po negociohet me Bankën Botërore një projekt për sigurinë ushqimore, i cili shpresohet të bëhet efektiv brenda vitit 2023.

AKU parashikohet të përfitoj fonde për rikonstruksionin dhe pajisje laboratorike. Për këtë qëllim Drejtoria e Menaxhimit (Sektori PIK) dhe Drejtoria e Vlerësimit (sektori i laboratorëve) ka qenë pjesë aktive e diskutimeve dhe materialeve të përgatitura. Nën asistencën e ekspertit të Bankës Botërore janë përgatitur nevojat e AKU-së për profilizimin e laboratorëve, pajisje laboratorike, metodat referuese dhe fonde për rikonstruksionin e 7 laboratorëve. Referuar përmbushjes së kushteve të përcaktuara në praktikat e mira laboratorike, sipas parimeve të përcaktuara nga OECD-ja dhe legjislacioni i BE-së, rëndësisë së zhvillimit që duhet të ndërmarrin laboratorët e AKU për të qenë eficentë dhe kompetentë, vendosjes në ndërtesa moderne që kërkojnë modifikim, hapësirave të mjaftueshme për të rritur kapacitetin e testimit dhe për të akomoduar më shumë pajisje dhe personel, investimi do të japë frutet e tij.

Me profilizimin e laboratorëve dhe me investimet synohet:

- Rritje e nivelit të kontrollit të sigurisë ushqimore, e kapaciteteve laboratorike dhe zgjerim të gamës së analizave për mostrat e marra gjatë kontrolleve zyrtare;
- Të jetë i akredituar sipas ISO 17025 për testet individuale ose grupin e testeve që do të përdorë për qëllime kontrolli zyrtar. Fushëveprimi i akreditimit duhet të jetë i përshtatshëm për funksionimin e tij si laborator zyrtar;
- Të përdorin metoda zyrtare të analizës në përputhje me direktivat e BE-së.

Të gjitha kontrollet zyrtare do të ofrohen gradualisht nga Sektorët e Shërbimeve Laboratorike të AKU, si dhe do të shërbehet në zbatim të praktikave të vetëkontrollit nga Operatorët e Biznesit Ushqimor.